Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2010

TETOR 2010

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569
Faks: 355-4-2223558
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 900 kopje
Shtypur në shtypshkronjën AdelPrint

P Ë R M B A J T J A

HYRJE		*7*
SQARIME		*8*
DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2010		*9*
PËRMBLEDHJE		*12*
1.	*ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE*	*25*
1.1.	*Zhvillimet e përgjithshme ekonomike në botë*	*25*
1.2.	*Zhvillimet kryesore në tregjet financiare në botë*	*31*
2.	*ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2010*	*38*
2.1.	*Ecuria e ekonomisë dhe e bizneseve*	*39*
2.2.	*Mirëqenia e ekonomive familjare*	*42*
2.3.	*Zhvillimet e bilancit të pagesave*	*44*
2.4.	*Zhvillimet fiskale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010*	*45*
3.	*TREGJET E BRENDSHME*	*49*
3.1.	*Tregu i pasurive të paluajtshme*	*49*
3.2.	*Tregjet financiare*	*49*
4.	*ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR*	*57*
4.1.	*Zhvillime të përgjithshme në sektorin bankar*	*62*
4.2.	*Vlerësim i qëndrueshmërisë së sektorit bankar sipas metodologjisë Stress-Testing*	*86*
4.3.	*Indeksi i Fortësisë Financiare*	*92*
ANEKSE		*95*
Aneks 1 .	*Tregues të situatës financiare të sektorit bankar*	*95*
Aneks 2.	*Metodologjia e ndërtimit të Indeksit të Fortësisë Financiare*	*98*
Aneks 3.	*Rezultatet përmbledhëse të IFF-së për sistemin bankar*	*100*

H A P Ë S I R A I N F O R M U E S E

Hapësirë Informuese 1.	*Programet e konsolidimit fiskal në disa vende të BE-së*	*30*
Hapësirë Informuese 2.	*Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri*	*34*
Hapësirë Informuese 3.	*Programet e konsolidimit fiskal në disa vende të BE-së*	*30*

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

1. Zhvillimet Ndërkombëtare

Tabelë 1.	*Ecuria e disa treguesve kryesorë makroekonomikë të SHBA-së.*	*26*
Tabelë 2.	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë në BE dhe në Eurozonë.*	*27*
Tabelë 3.	*Tregues makroekonomikë të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe vendeve të Baltikut.*	*29*

2. Zhvillimet makroekonomike gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010

Tabelë 4.	*Tregues kryesorë makroekonomikë.*	*39*
Tabelë 5.	*Produkti i Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik, ndryshimet vjetore në përqindje.*	*40*
Tabelë 6.	*Produkti i Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik, ndryshimet tremujore në përqindje.*	*40*
Tabelë 7.	*Indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit (2005=100).*	*40*
Tabelë 8.	*Tregues të punësimit.*	*42*
Tabelë 9.	*Treguesit kryesorë fiskalë.*	*46*
Tabelë 10.	*Rishikimi i buxhetit.*	*46*

4. Zhvillime të Sistemit Financiar

Tabelë 11.	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %).*	*57*
Tabelë 12.	*Tregues të aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit.*	*60*
Tabelë 13.	*Pesha e zërave të aktiveve (qershor '04 – qershor '10).*	*63*
Tabelë 14.	*Pesha e zërave të detyrimeve/pasiveve (qershor '04 – qershor '10).*	*64*
Tabelë 15.	*Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor '05 – qershor '10).*	*65*
Tabelë 16.	*Rritja vjetore e totalit të depozitave për sektorin bankar, gjatë viteve 2004-2009.*	*78*
Tabelë 17.	*Vlerësimi i rritjes së portofolit të kredisë me probleme sipas secilit skenar.*	*88*
Tabelë 18.	*Bankat e Nënkapitalizuara sipas Skenarit 1.*	*89*
Tabelë 19.	*Bankat e Nënkapitalizuara sipas Skenarit 2.*	*90*
Tabelë 20.	*Skenar 1 (Bazë).*	*90*
Tabelë 21.	*Skenar 2 (Bazë).*	*91*
Tabelë 22.	*Skenar 3.*	*91*
Tabelë 23.	*Skenar 4.*	*91*
Tabelë 24.	*Devijimet standarde të raportit të kredive me probleme për secilin skenar dhe vlerësimet intervalore.*	*92*

Aneks 1 . Tregues të situatës financiare të sektorit bankar

Tabelë 25.	*Sektori bankar.*	*95*
Tabelë 26.	*Grupet sipas madhësisë së aktiveve.*	*96*
Tabelë 27.	*Grupet sipas origjinës së kapitalit.*	*97*

Aneks 2. Metodologjia e ndërtimit të Indeksit të Fortësisë Financiare

Tabelë 28.	*Treguesit e Fortësisë Financiare.*	*98*

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

1. Zhvillimet Ndërkombëtare

Grafik 1. Balanca buxhetore dhe borxhi publik në Eurozonë. 28
Grafik 2. Normat kryesore të tregut të parasë. 31
Grafik 3. Ecuria e yield-eve të obligacioneve qeveritare 10-vjeçare. 31
Grafik 4. Ecuria e indekseve kryesore të tregut të aksioneve. 32
Grafik 5. Ecuria e kursit të këmbimit të euros kundrejt monedhave kryesore. 33
Grafik 6. Ecuria e indekseve të çmimeve të lëndëve të para kryesore. 33

2. Zhvillimet makroekonomike gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010

Grafik 7. Indeksi i shifrës së afarizmit. 41
Grafik 8. Treguesi i tendencës ekonomike. 41
Grafik 9 Treguesi i besimit të industrisë. 41
Grafik 10. Treguesi i besimit të shërbimeve. 42
Grafik 11. Treguesi i besimit të konsumatorëve. 42
Grafik 12. Treguesi i besimit të ndërtimit. 42
Grafik 13. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm, sektori i industrisë. 43
Grafik 14. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm, sektori i ndërtimit. 43
Grafik 15. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm, sektori i shërbimeve. 43
Grafik 16. Treguesit e kursimit aktual dhe të pritshëm. 44
Grafik 17. Eksportet sipas përbërjes. 44
Grafik 18. Përbërësit e borxhit publik. 47
Grafik 19. Indeksi i çmimeve të banesave për kryeqytetin. 49
Grafik 20. Pesha e kredisë për prona të patundshme ndaj tepricës së kredisë, në përqindje. 49

3. Tregjet e brendshme

Grafik 21. Volumi dhe yield-et në tregun ndërbankar në milionë ALL. 50
Grafik 22. Vëllimi i kërkesës dhe i ofertës së bonove në ankande. 50
Grafik 23. Raporti bid-to cover. 50
Grafik 24. Vëllimi dhe yield-et e bonove në tregun primar. 51
Grafik 25. Vëllimet dhe Yield-et e obligacioneve në tregun parësor. 51
Grafik 26. Kurba e Yield-eve. 52
Grafik 27. Vëllimi i tregtimit të bonove në tregun sekondar. 52
Grafik 28. Kursi i këmbimit të lekut ndaj monedhave kryesore. 53
Grafik 29. Ecuria e shportës së valutave. 53
Grafik 30. Indeksi i kursit nominal efektiv. 53
Grafik 31. Ecuria e normave të tregut të parasë. 54
Grafik 32. Spread-i Kredi/ Depozita me afat. 54
Grafik 33. Pesha e pagesave të klientëve në sistemin bankar sipas instrumentit të pagesave (në numër) për periudhën janar – qershor 2010. 55

4. Zhvillime të sistemit financiar

Grafik 34. Pesha e subjekteve të sistemit financiar në totalin e aktivit. 58
Grafik 35. Rritja e nivelit të aktiveve të institucioneve jobanka sipas tremujorëve. 58
Grafik 36. Llogaria kapitale ndaj totalit të aktiveve. 59
Grafik 37. Ecuria e kredisë. 59
Grafik 38. Kredia me probleme ndaj totalit të kredisë. 59
Grafik 39. Pesha e zërave të aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit. 61
Grafik 40. Pesha e grupeve të bankave në totalin e aktiveve. 64
Grafik 41. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 65
Grafik 42. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe i pasiveve në muaj. 66
Grafik 43. Maturimi mesatar i mbetur i kredisë. 67
Grafik 44. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave. 67
Grafik 45. Ecuria e zërave të aktivit. 68
Grafik 46. Kontributi në rritjen e aktiveve. 68
Grafik 47. Aktivet me rrezik dhe portofoli i kredisë ndaj totalit të aktiveve. 68
Grafik 48. Aktivet me rrezik dhe portofoli i kredisë ndaj totalit të aktiveve për grupet e bankave. 69
Grafik 49. Kredia e re dhe përdorimi i kredisë. 70

Grafik 50. Shpërndarja e kredisë së re sipas qëllimit të përdorimit për sektorin e biznesit (në %). 70
Grafik 51. Shpërndarja e kredisë së re sipas qëllimit të përdorimit për sektorin e individëve (në %). 71
Grafik 52. Shpërndarja e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë (në %). 71
Grafik 53. Shpërndarja e kredisë për sektorin publik dhe atë privat. 72
Grafik 54. Shpërndarja e tepricës së kredisë për biznesin. 73
Grafik 55. Shpërndarja e tepricës së kredisë për individët. 73
Grafik 56. Shpërndarja e tepricës së kredisë totale. 73
Grafik 57. Shpërndarja sipas rretheve. 74
Grafik 58. Pesha mesatare e kredisë sipas afateve. 74
Grafik 59. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve për rrethet kryesore. 74
Grafik 60. Huatë me probleme ndaj totalit të huave. 75
Grafik 61. Huatë me probleme ndaj totalit të huave sipas grupeve. 75
Grafik 62. Cilësia e portofolit sipas sektorëve. 76
Grafik 63. Huatë me probleme ndaj kapitalit rregullator. 76
Grafik 64. Huatë me probleme ndaj kapitalit rregullator sipas grupeve të bankave. 77
Grafik 65. Ecuria e raportit të mbulimit të kredive me probleme me provigjone. 77
Grafik 66. Kategoritë e kredisë të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme në %. 77
Grafik 67. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit. 79
Grafik 68. Vëllimi total i pranimeve të reja në lekë kundrejt normave mesatare të interesit për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në lekë. 79
Grafik 69. Vëllimi total i pranimeve të reja në valutë kundrejt normave mesatare të interesit për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në euro dhe dollarë. 80
Grafik 70. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik). 81
Grafik 71. Treguesi i levës financiare (totali i aktiveve ndaj kapitalit aksioner). 81
Grafik 72. Kthimi nga kapitali (RoE). 82
Grafik 73. Kthimi nga aktivet (RoA).Grafik 73. Kthimi nga aktivet (RoA). 83
Grafik 74. Pozicioni ndaj jorezidentëve. 84
Grafik 75. Aktivet me jorezidentët ndaj pasiveve ndaj jorezidentëve. 84
Grafik 76. Detyrimet ndaj jorezidentëve ndaj totalit të detyrimeve sipas grupeve. 84
Grafik 77. Totali i pasiveve ndaj jorezidentëve ndaj totalit të pasiveve në valutë. 85
Grafik 78. Totali i pasiveve ndaj jorezidentëve ndaj totalit të pasiveve në valutë sipas grupeve. 85
Grafik 79. Indeksi i Herfindalit për detyrimet ndaj jorezidentëve. 85
Grafik 80. Gapi i maturimit për "deri në 1 muaj" dhe "deri në 3 muaj". 86
Grafik 81. Shpërndarjet probabilitare të treguesit të raportit të kredive me probleme ndaj totalit të kredisë sipas katër skenarëve. 92
Grafik 82. Ecuria e IFF-së për sistemin dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 93
Grafik 83. Ecuria e IFF-së për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 93
Grafik 84. Nënindekset e Fortësisë Financiare për sektorin (dhjetor 2005=100). 93
Grafik 85. Nënindekset e fortësisë financiare për grupet (dhjetor 2005=100). 94

HYRJE

Ky është numri i katërt i Raportit të Stabilitetit Financiar, një dokument i Bankës së Shqipërisë që publikohet dy herë në vit duke filluar nga viti 2010. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Në hyrje të dokumentit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, publikimi i së cilës çdo gjashtë muaj është një kërkesë ligjore.

Për hartimin e raportit, janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Të dhënat dhe analizat përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen përgjithësisht deri në fund të vitit.

Stabiliteti i sistemit financiar është vlerësuar në bazë të performancës dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga vetë veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e zhvilluara e ato të rajonit, dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punëzënies, është vlerësuar situata e të ardhurave personale dhe efektet që ajo ka mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

SQARIME

Në fund të muajit qershor të vitit 2010, bankat sipas madhësisë së aktivitetit ndahen në:

a) bankat e Grupit 1 (secila nga 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit) ishin: Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Veneto Banka (ish-Banka Italiane e Zhvillimit), Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka e Parë e Investimeve, Banka e Kreditit të Shqipërisë, Banka Union;

b) bankat e Grupit 2 (secila nga 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit), ishin: Banka Procredit, Banka Emporiki, Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë, Banka Credins, Banka Popullore;

c) Bankat e Grupit 3 (secila mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit), ishin: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Intesa-Sanpaolo – Shqipëri, Banka Tirana, Banka Alfa-Shqipëri.

Në fund të muajit qershor të vitit 2010, sipas origjinës së kapitalit bankat kanë qenë:

a) banka me kapital[1] austriak: Banka Raiffeisen;

b) banka me kapital italian: Banka Intesa-Sanpaolo – Shqipëri, Veneto Banka (ish-Banka Italiane e Zhvillimit);

c) banka me kapital grek: Banka Alfa-Shqipëri, Banka Tirana, Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë;

d) banka me kapital francez: Banka Popullore (aktualisht Societe General – Albania), Banka Emporiki;

e) banka me kapital shqiptar: Banka Credins, Banka Union;

f) degë të bankave të huaja: Banka Alfa-Shqipëri, Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë.

[1] *Sipas origjinës të kapitalit, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë të kapitalit të paguar të bankës.*

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2010

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", për të informuar Këshillin e Ministrave, Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare si dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe mbi rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike, si pjesë të Raportit të Stabilitetit Financiar.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, gjendja financiare e sistemit financiar dhe e sektorit bankar ishte e qëndrueshme. Nevoja për të stabilizuar dhe për të përmirësuar cilësinë e kredisë, përfaqëson sfidën kryesore me të cilën ndeshet sektori bankar. Gjendja e kapitalizimit dhe e likuiditetit të veprimtarisë paraqitet e mirë. Në nivel sektori, rezultati neto i veprimtarisë është përmirësuar. Kryerja e testimit të qëndrueshmërisë të sektorit bankar ndaj zhvillimeve të pafavorshme ekonomike dhe financiare të supozuara, tregoi përballimin e mirë të tyre.

Lidhur me rreziqet që mund t'i vijnë sistemit financiar dhe sektorit bankar prej zhvillimeve të brendshme ekonomike, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, vlerësohet se ato janë ulur. Faktorët pozitivë kryesorë përfshijnë uljen e deficitit buxhetor dhe të atij tregtar, qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit presionet e moderuara inflacioniste dhe rënien e normave të interesit. Gjatë kësaj periudhe, likuiditeti në tregun ndërbankar ka qenë i përshtatshëm për plotësimin e kërkesave afatshkurtra të bankave tregtare dhe tregu financiar ka funksionuar normalisht. Por këto zhvillime pozitive do të kishin një ndikim më afatgjatë nëse do të nxisnin një përmirësim më të shpejtë të gjendjes financiare të bizneseve dhe të individëve/familjeve, duke stimuluar në këtë mënyrë kërkesën e brendshme.

Edhe zhvillimet ekonomike ndërkombëtare paraqesin një situatë më të përmirësuar. Gjatë kësaj periudhe, ekonomia botërore u rrit me 4.7% në terma vjetorë. Presionet inflacioniste kanë qenë të moderuara. Tregjet financiare ishin përgjithësisht më të stabilizuara dhe gjendja financiare e grupeve bankare ishte përgjithësisht më e mirë. Por nivelet e kreditimit nga sektori bankar mbeten të kufizuara dhe autoritetet publike kanë marrë masa për konsolidimin fiskal. Si rezultat, investimet e reja në ekonomi janë të dobëta dhe niveli i papunësisë, veçanërisht në vendet e jugut të Eurozonës, mbetet i lartë. Për këto arsye, qëndrueshmëria e ritmit të rritjes ekonomike për periudhën në vazhdim mbetet e diskutueshme.

Përsa i takon zhvillimeve në veprimtarinë e sistemit financiar, në mënyrë të përmbledhur, vlerësohet se ajo ka njohur rritje gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit duke rritur peshën e këtij sektori ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto në nivelin 84.5%. Sektori bankar vijon të mbetet segmenti mbizotërues i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri. Aktivet e sektorit bankar u ngritën në nivelin 934.7 miliardë lekë, duke zënë 94.4% të totalit të aktiveve të sistemit financiar.

Rritja e aktivitetit të sektorit bankar, është mbështetur edhe nga mirëfunksionimi i infrastrukturës të sistemeve të pagesave. Veprimtaria bankare ishte e mirëkapitalizuar dhe treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte i qëndrueshëm në nivelin 16.2%. Aktivet likuide përfaqësuan 27.8% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Raporti i kredive ndaj depozitave arriti në 63.2%. Rezultati financiar i sektorit bankar shënoi vlera pozitive, në shifrën 3.6 miliardë lekë, duke u rritur ndjeshëm në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja e rezultatit financiar është mbështetur prej rritjes së të ardhurave neto nga interesat dhe prej kontrollit më të mirë mbi kostot e veprimtarisë. Megjithatë, rezultati pozitiv financiar ka një përqendrim të lartë dhe do të preferohej që ai të shtrihej në një numër më të madh bankash për të qenë më i qëndrueshëm. Gjatë periudhës, sektori bankar vazhdoi të përballej me përkeqësimin e cilësisë së kredisë. Kreditë me probleme u rritën në 12.2% të totalit të kredisë. Si rezultat i perceptimit më të lartë të rrezikut të kreditit, sektori bankar ka ulur ritmin vjetor të rritjes së kredisë, ka shkurtuar afatin mesatar të maturimit të saj, dhe ka ulur më tej kredinë për konsum. Fondet rezervë për mbrojtjen nga rreziku i kreditit janë rritur me rreth 20%, dhe në fund të periudhës, përfaqësonin 52.5% të kredive me probleme.

Banka e Shqipërisë rithekson se bankat duhet të vazhdojnë monitorimin e kujdesshëm të ecurisë së cilësisë të kredive dhe të krijojnë në kohën e duhur fondet përkatëse rezervë. Strukturat përkatëse në banka duhet të vlerësojnë përqendrimin e kredive me probleme në sektorë dhe kredimarrës të caktuar si dhe të rrisin diversifikimin e portofolit të kredisë. Subjektet kredimarrëse që gjenden në vështirësi të përkohshme, por që kanë një projekt të vlefshëm, i cili garanton kthimin e kredisë, duhet të mbështeten duke respektuar kërkesat e kuadrit rregullativ. Në rastet kur kjo mundësi paraqitet e ulët, strukturat përkatëse në banka duhet të zbatojnë të drejtat kontraktuare për rikuperimin e vlerës së kredisë.

Në lidhje me vlerësimin e rreziqeve me të cilat ndeshet sektori bankar, Banka e Shqipërisë kryen në mënyrë të vazhdueshme simulime që testojnë rezistencën e sektorit bankar ndaj zhvillimeve të pafavorshme të supozuara në disa tregues makroekonomikë dhe financiarë, veç e veç dhe të kombinuar. Sipas analizës të skenarëve që kombinojnë ndikimin e disa treguesve makroekonomikë dhe financiarë, si edhe ecurinë e disa treguesve të veprimtarisë të sektorit bankar, rezulton se, në tërësi, gjendja financiare e sektorit bankar është e mirë dhe si e tillë e përballon një përkeqësim të mëtejshëm të situatës. Nga analiza e ndjeshmërisë të këtyre simulimeve, rezulton se sektori bankar shfaq një ndjeshmëri më të madhe ndaj rrezikut të kreditit dhe rrezikut të tërthortë të kredisë të shkaktuar prej lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit.

Pavarësisht nga këto rezultate, strukturat drejtuese të bankave duhet të testojnë qëndrueshmërinë e institucioneve që drejtojnë nëpërmjet ushtrimeve të ngjashme dhe të vlerësojnë paraprakisht dhe në vazhdimësi nevojat për kapital shtesë.

Në përputhje me sfidat me të cilat ndeshet veprimtaria bankare dhe në zbatim të objektivit ligjor për të siguruar një veprimtari të shëndetshme të sektorit bankar, Banka e Shqipërisë do të vlerësojë nevojën për plotësime dhe për përmirësime në kuadrin rregullativ dhe mbikëqyrës. Në vijimësi, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të monitorojë panoramën e rreziqeve të sistemit financiar në vend me qëllim marrjen e masave parandaluese në momentin e duhur.

PËRMBLEDHJE

ECURIA E EKONOMISË BOTËRORE DHE E TREGJEVE FINANCIARE

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ekonomia botërore është rritur me rreth 4.7% në nivel vjetor, duke përfituar nga vijueshmëria e politikave stimuluese të autoriteteve publike dhe nga përmirësimi gradual i funksionimit të tregjeve financiare. Në përputhje me stadin e zhvillimit, ritmi i rritjes ekonomike ka qenë më i lartë në vendet në zhvillim, të cilat shënuan një rritje vjetore prej rreth 7.25%. Në vendet e zhvilluara, rritja ekonomike vjetore në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ishte rreth 3%. Me gjithë zhvillimet e moderuara të inflacionit, vendet në zhvillim ndjenë një presion më të madh inflacionist.

Në tremujorin e parë të vitit 2010, zhvillimet ekonomike ishin më pozitive: prodhimi industrial dhe tregtia regjistruan rritje dyshifrore, niveli i papunësisë në vendet e zhvilluara nisi të stabilizohet dhe në përgjithësi treguesit e besimit të konsumatorëve u përmirësuan. Gjatë kësaj periudhe, ka patur një funksionim më të mirë të tregjeve financiare, i cili u shfaq prej rritjes së qëndrueshme të aktivitetit, prej kushteve më të mira të likuiditetit dhe prej prirjes rënëse të normave të interesit. Në tremujorin e dytë të vitit 2010, e nxitur prej shqetësimeve mbi qëndrueshmërinë fiskale të disa vendeve të Eurozonës, u rikthye pasiguria e tregjeve dhe e agjentëve ekonomikë. Në afat të shkurtër, kjo solli një tkurrje të veprimtarisë të tregjeve financiare dhe shtrëngim të kushteve të likuiditetit. Masat e forta të ndërmarra prej autoriteteve të Bashkimit Evropian (BE) dhe të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), ndihmuan në kapërcimin e situatës kritike dhe në rivendosjen e funksionimit më normal të tregjeve. Këto lëvizje, sidoqoftë mbështetën pritshmëritë për një rënie të ritmit të rritjes së ekonomisë botërore, në periudhën në vazhdim.

Gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2010, ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës vazhdoi të shënonte rritje pozitive, por me një ritëm më të ulët në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2009. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) shënoi një rritje reale vjetore prej 3.7% në tremujorin e parë dhe 2.4% në tremujorin e dytë të vitit 2010. Rritja e PBB-së u mbështet nga investimet e biznesit, ndërsa konsumi ishte përgjithësisht i dobët. Norma vjetore e papunësisë u zbut disi në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2010, krahasuar me tremujorin e fundit të vitit 2009, duke u stabilizuar në nivelin mesatar 9.7%. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, presionet inflacioniste mbetën të ulëta dhe norma vjetore e inflacionit në fund të këtij gjashtëmujori rezultoi në nivelin 1.8%. Për këtë arsye, Rezerva Federale e SHBA-së, mbajti të pandryshuar normën e interesit të politikës monetare, në nivelin 0.25%. Në sferën fiskale, për shkak të veprimit të kombinuar të

stimujve dhe paketave financiare të shpëtimit, dhe të ndikimit të stabilizuesve automatikë të buxhetit, është ruajtur gjendja e lartë e deficitit në balancat e sektorit publik.

Ecuria ekonomike e rajonit të Evropës ka vazhduar të përmirësohet gjatë dy tremujorëve të parë të vitit 2010, por me ritme më të ngadalta se ajo e SHBA-së dhe duke ruajtur diferenca të dukshme midis vendeve. Në terma vjetorë, rritja e PBB-së në tremujorin e parë ka rezultuar përkatësisht 0.5% për rajonin e BE-së dhe 0.6% për rajonin e Eurozonës. Në tremujorin e dytë rritja vlerësohet të jetë 1.7% në secilin rajon. Në tremujorin e parë, rritja erdhi kryesisht si rrjedhojë e kontributit pozitiv të inventarëve dhe të investimeve të sektorit privat, që kanë tejkaluar efektin negativ të kërkesës së brendshme dhe të eksporteve neto. Presionet inflacioniste në BE dhe Eurozonë, gjatë gjysmës së parë të vitit, në përgjithësi, kanë mbetur të moderuara. Në muajin qershor të vitit 2010, normat vjetore të inflacionit për BE-në dhe Eurozonën rezultuan përkatësisht 1.9% dhe 1.4%. Në tregun e punës në Eurozonë, kushtet duket se kanë ardhur duke u stabilizuar. Norma e papunësisë së këtij rajoni mbeti e pandryshuar në nivelin 10% për muajt e parë të vitit 2010. Treguesit e ecurisë së situatës fiskale në Eurozonë, vijuan të përkeqësohen gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010. Situata u bë dramatike në tremujorin e dytë të vitit, pas vështirësive akute që ndeshi Greqia dhe prej frikës për shtrirjen e tyre në vende të tjera të rajonit. Tregjet filluan të spekulojnë mbi qëndrueshmërinë e projektit të Eurozonës. Për këtë arsye, Bashkimi Evropian, mbeshtetur nga FMN-ja miratoi menjëherë, një fond prej 110 miliardë eurosh në ndihmë të Greqisë, në këmbim të angazhimeve të qeverisë greke për të vendosur nën kontroll deficitin e jashtëzakonshëm buxhetor nëpërmjet shkurtimeve të thella të shpenzimeve dhe rritjes të taksave. Pothuaj secili prej vendeve anëtare, nxitoi të shpallte objektivat për uljen e deficiteve buxhetore, si masë parandaluese për spekulimet e ndryshme në tregje. Në mënyrë më të formalizuar, në muajin maj vendet anëtare të Bashkimit Evropian vendosën të adoptojnë propozimet e Komisionit Evropian për ndërtimin e Mekanizmit të Stabilizimit Financiar Evropian, për t'iu përgjigjur me shpejtësi, në mënyrë të harmonizuar dhe me efektivitet, vështirësive akute në financimin e deficitit buxhetor të secilit vend anëtar, duke goditur në këtë mënyrë spekulimet negative në tregje. Njëkohësisht, Komisioni Evropian paraqiti propozimet për përshpejtimin e procesit të hartimit dhe të zbatimit të politikave më agresive për konsolidimin fiskal në përputhje me Paktin e Stabilizimit dhe të Rritjes (PSR). Në sferën monetare, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ndërmori veprimet e nevojshme për rikthimin e likuiditetit në tregjet e letrave me vlerë të borxhit të qeverive.

Në rajonin e Evropës Qendrore e Juglindore, situata makroekonomike është përmirësuar gradualisht. Në përgjithësi, treguesit e besimit dhe të prodhimit industrial, si dhe shifrat e tregtisë në vendet e këtij rajoni, tregojnë për një përmirësim të aktivitetit ekonomik. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e nivelit të papunësisë dhe kushtet e dobëta të financimit nga sektori bankar nxisin dobësinë e kërkesës së brendshme dhe e bëjnë të luhatshme rritjen ekonomike. Edhe në këtë rajon, zhvillimet inflacioniste kanë qenë të kontrolluara.

Për pjesën e mbetur të vitit, pritjet për rritjen ekonomike botërore janë pozitive, por më të ulëta se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010. Niveli i rritjes ekonomike do të varet nga mënyra e realizimit të konsolidimit fiskal nga ana e autoriteteve publike dhe prej performancës së tregjeve financiare në kushtet e nevojës për rigjallërim të qëndrueshëm të kreditimit. Ekonomia në vendet e zhvilluara pritet të rritet me 2.5% gjatë vitit 2010 dhe gjatë vitit 2011. Rritja disi më e fortë në SHBA do të kundërbalancohet nga një rritje pak më e dobët në vendet e Eurozonës, ku vendet anëtare pritet të shfaqin diferenca të theksuara në performancën ekonomike. Konsolidimi fiskal do të përfaqësojë sfidën më të madhe për këto vende, shoqëruar nga kontrolli mbi nivelin e papunësisë dhe nga nevoja për rigjallërimin e financimit të sektorit bankar. Presionet inflacioniste pritet të mbeten të buta në vendet e zhvilluara, kryesisht për shkak të niveleve ende të ulëta të shfrytëzimit të kapaciteteve nga bizneset dhe pritjet e mirankoruara inflacioniste. Për sa i përket grupit të vendeve në zhvillim, rritja ekonomike vjetore e tyre për vitin 2011 parashikohet të jetë 6.5%, ku do të vazhdojnë të kryesojnë vendet në zhvillim të rajoneve të Azisë dhe të Amerikës Latine. Në dallim nga vendet e zhvilluara, norma mesatare e inflacionit në vendet në zhvillim pritet të arrijë në nivelin 6.25% në vitin 2010 dhe të zbresë në 5% në vitin 2011. Edhe në vendet e rajonit të Evropës Juglindore, do të ketë dallime në ecurinë e rritjes ekonomike mes vendeve të ndryshme.

Tregjet financiare përshpejtuan fazën e stabilizimit dhe të rikuperimit të nisur që gjatë vitit të kaluar dhe të mbështetur gjerësisht nga autoritetet monetare. Normat e interesit vijuan rënien graduale pothuajse në të gjithë spektrin e maturimeve dhe vëllimi i aktivitetit u rrit ndjeshëm si në tregjet e parasë ashtu edhe në ato të letrave me vlerë të borxhit e të kapitalit. Kjo prirje ishte edhe më e dukshme në tregjet e vendeve në zhvillim. Ecuria e sektorit bankar në botë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2010, ishte përgjithësisht pozitive duke shënuar hapa të rëndësishëm drejt përtëritjes financiare. Për grupet e mëdha dhe komplekse bankare (GMKB), kthimi mbi kapitalin (ROE) dhe ai mbi aktivet (ROA), arritën përkatësisht në nivelet 12.5% dhe 0.9%, krahasuar me 6% dhe 0.3% në fund të vitit 2009. Megjithatë, në fillim të tremujorit të dytë, rritja e rrezikut të kreditit në titujt e borxhit sovran, pati ndikim të ndjeshëm negativ në tregun ndërbankar evropian ku transaksionet u pakësuan ndjeshëm për shkak të pasigurisë mbi ekspozimin e bankave në letrat me vlerë të borxhit të qeverive. BQE-ja vlerësoi se kjo situatë mund të ndikonte negativisht në funksionimin e segmenteve të tjera të tregut financiar dhe të dëmtonte efektivitetin e politikës së saj monetare. Ndaj ajo vendosi të përmirësonte likuiditetin si dhe funksionimin e këtyre tregjeve, nëpërmjet blerjes së drejtpërdrejtë të borxhit të qeverive të vendeve të Eurozonës dhe rivendosjes së operacioneve të injektimit të likuiditetit me normë interesi të fiksuar. Këto masa dhe ato që u morën nga Komisioni Evropian, ndikuan në rënien e tensionit në tregjet e parasë. Gjatë kësaj periudhe, edhe tregjet e aksioneve pësuan rënie të ndjeshme.

Në tregjet e kredisë, përmirësimi i situatës së përgjithshme ekonomike në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, u shoqërua me rënie të kostos të financimeve dhe me akses më të gjerë në financim. Në tregjet e shkëmbimit të valutave, euro është dobësuar në këmbimin e saj me dollarin amerikan

dhe me jenin japonez. Në tregjet e lëndëve të para, është vënë re një qëndrueshmëri në ecurinë e çmimeve, mbështetur në një ecuri më të mirë të ekonomisë botërore. Në kushtet e politikave mbështetëse eksportuese, kërkesa e qëndrueshme e vendeve në zhvillim, është përballuar me fleksibilitet më të lartë të ofertës.

ZHVILLIMET EKONOMIKE NË VEND

Pas një rritjeje ekonomike negative në tremujorin e katërt të vitit 2009, rritja prej 2% në tremujorin e parë të vitit 2010 dhe treguesit e sektorit real sugjerojnë se ekonomia shqiptare ka patur një ecuri pozitive gjatë gjysmës së parë të vitit. Gjatë kësaj periudhe është konstatuar një ecuri e moderuar e inflacionit, qëndrueshmëri e kursit të këmbimit, rritje e investimeve të huaja dhe një korrektim i rëndësishëm i pozicionit të tregtisë së jashtme. Rritja më e ngadaltë e pagave dhe e treguesve të punësimit, rënia e dërgesave të emigrantëve dhe kushtet ende të vështira të financimit, kanë ndikuar negativisht mbi ecurinë e konsumit privat. Politika fiskale ka qenë më e shtrënguar, në përputhje me objektivin për të ulur deficitin buxhetor të vitit.

Në rritjen ekonomike të tremujorit të parë të vitit, kërkesa e qëndrueshme për eksporte të lëndëve të para, mbështeti rritjen e lartë të sektorit të industrisë me 27.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sektori i ndërtimit u tkurr me 21.1% në terma vjetorë. Sektori i shërbimeve, i cili ka peshën më të madhe në prodhimin e brendshëm, u rrit me 3.4% në tremujorin e parë të vitit 2010, duke vijuar ngadalësimin e shfaqur në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009.

Përmirësimi i likuiditetit në sektorin bankar, i treguar nga rritja e depozitave, ka ofruar kushte më të mira për mbështetjen e investimeve private. Megjithatë, shfrytëzimi më i ulët i kapaciteteve nga ana e firmave për shkak të rënies së kërkesës, nuk ka mbështetur rritjen e investimeve private. Vrojtimi i besimit të konsumatorëve gjatë kësaj periudhe, tregon se tek ata po forcohet prirja për të rritur kursimet dhe për të shtyrë në kohë shpenzimet jo të domosdoshme. Nga ana tjetër, kostoja e financimeve të sektorit bankar mbetet relativisht e lartë. Megjithatë, disa sinjale që lidhen me rritjen e importit të mjeteve kapitale nga subjektet private dhe një interesim më i madh i bizneseve pranë bankave, ofrojnë optimizëm, një optimizëm të përmbajtur për një rigjallërim të kërkesës për kredi nga ana e sektorit privat.

Kontributi i sektorit publik në kërkesën agregate ka vijuar të jetë pozitiv, por shumë më pak i rëndësishëm sesa vitin e kaluar. Politika fiskale ka qenë më e kujdesshme ndaj treguesve të borxhit, gjë e cila vlerësohet pozitive për perceptimin e primit të rrezikut të borxhit publik. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, deficiti buxhetor u ul me 36% në krahasim me një vit më parë. Ndikimin më të madh në këtë ecuri e dha rënia e shpenzimeve buxhetore, pasi rritja e të ardhurave ishte në nivele më të ulëta sesa parashikimi. Në drejtim të financimit të deficitit buxhetor, ka patur një kërkesë të lartë të pjesëmarrësve të tregut për letra me vlerë të borxhit të qeverisë.

Në pozicionin e tregtisë me jashtë, gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 u vu re një korrektim i rëndësishëm i deficitit tregtar, ku në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë eksportet u rritën me 14% ndërsa importet ranë me 3%. Si rezultat, deficiti tregtar i gjashtëmujorit u ngushtua me 19% nga fundi i gjashtëmujorit të parë të vitit 2009 dhe me 12% në krahasim me fundin e vitit 2009. Sigurimi i qëndrueshmërisë në kohë të eksporteve, kërkon politika publike mbështetëse dhe fiton rëndësi në kushtet kur burimet e financimit të deficitit tregtar e të llogarisë korente janë relativisht të paqëndrueshme. Në fakt, dërgesat e emigrantëve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 rezultuan me një rënie prej 7.3% në terma vjetorë. Duke konsideruar treguesit e dobët të tregut të punës në vendet e Eurozonës dhe situatën kritike në Greqi, fluksi i dërgesave të emigrantëve në të ardhmen mund të mbetet i paqëndrueshëm. Nga ana tjetër, përmirësimi gradual i fluksit të investimeve të huaja direkte me 19% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar si edhe prirja pozitive e zhvillimit të turizmit, përfaqësojnë faktorë mbështetës për rritjen e burimeve të flukseve valutore në të ardhmen.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, presionet inflacioniste kanë qenë të kontrolluara dhe norma e inflacionit është luhatur brenda kufijve 2-4%, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

ZHVILLIMET NË TREGUN FINANCIAR

Ky treg u mbizotërua nga veprimet e tregut ndërbankar, të tregut të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë dhe të tregut të këmbimeve valutore.

Vlera e veprimeve në tregun ndërbankar ishte e qëndrueshme, ndërkohë që normat e interesit kanë shënuar një rënie të lehtë. Në tregun e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë, kërkesa e pjesëmarrësve në ankande ka qenë më e lartë sesa oferta. Norma e interesit (*yield*-it) të bonove të thesarit në tregun parësor vijoi prirjen rënëse të filluar në muajin nëntor të vitit 2009, si reagim ndaj lehtësimit të politikës monetare. Rënia ishte më e ndjeshme në emetimet e borxhit me maturim 12-mujor. Rënia e normave të interesit në tregun financiar për veprimet në lekë, reflektoi kushtet e bollshme të likuiditetit, kryesisht të sektorit bankar, si edhe rënien e ofertës të bonove të thesarit të qeverisë, në kushtet e nevojës më të ulët për financimin e deficitit të pakësuar buxhetor.

Prirja rënëse e normave të interesit në tregun ndërbankar dhe në atë të titujve të borxhit të qeverisë, është reflektuar në një masë më të ulët edhe në diferencën mes normës mesatare të interesit të kredive dhe asaj të depozitave. Gjatë periudhës, kjo diferencë është ngushtuar me 0.26 pikë përqindje për veprimet në lekë. Kontributin kryesor në ngushtimin e kësaj diference e dha ulja e normave të interesit të kredisë nga 13.2% në 12.7%. Normat e depozitave me afat në lekë janë paraqitur më të qëndrueshme, duke rënë gjatë periudhës nga 5.37% në 5.18%. Për valutat, kjo diferencë është ngushtuar me 0.76 pikë përqindje për veprimet në euro, por është zgjeruar me 0.51 pikë përqindje për veprimet në dollar amerikan. Në përgjithësi, ecuria e normave të interesit mes kredive dhe depozitave sipas valutave, ka reflektuar ndryshimet në normat

bazë të interesit, gjendjen e likuiditetit si edhe hezitimin e sektorit bankar për të kredituar me ritme më të larta për shkak të perceptimit të një niveli me të lartë rreziku në këtë veprimtari.

Në tregun e brendshëm, ngushtimi i deficitit tregtar dhe atij buxhetor ka ndikuar në zbutjen e presioneve nënçmuese të lekut. Treguesit e kursit nominal efektiv të këmbimit dhe të tregtimit ndaj shportës të valutave kryesore, konfirmojnë qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit të lekut gjatë kësaj periudhe. Në vlerë nominale, leku është mbiçmuar ndaj euros me 1% dhe është nënçmuar ndaj dollarit amerikan e paundit britanik përkatësisht me 16.6% dhe 9.4%. Shkëmbimi i lekut në raport me valutat e mësipërme ka reflektuar kryesisht ecurinë e tyre në tregjet ndërkombëtare, ku dollari amerikan dhe paundi britanik janë forcuar në këmbimin me euron.

Veprimtaria e tregut financiar është mbështetur nga mirëfunksionimi i sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH që administrohen nga Banka e Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe, është rritur numri i transaksioneve të procesuara në këto sisteme, dhe në sistemin AECH vlera e tyre ka qenë rreth 2.4 herë më e lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga statistikat që përpunohen për sektorin bankar, gjatë periudhës në shqyrtim rezulton se pranë bankave janë kryer rreth 3.5 milionë pagesa për klientët, me një vlerë të përgjithshme prej 1,570 miliardë lekësh. Gjatë kësaj periudhe u konstatua rritje e transaksioneve të pagesave në sektorin bankar që kryhen nëpërmjet infrastrukturës së internetit dhe mjeteve elektronike. Gjithashtu, vazhdoi rritja e numrit të kartave të debitit/kreditit dhe e veprimeve me to për tërheqje ose pagesa pranë makinave elektronike të parasë fizike (ATM) dhe pikave të shitjes në qendra tregtare e shërbimi (POS).

ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR

Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i vlerësuar si raport i aktiveve të sektorit financiar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) është vlerësuar në nivelin 84.5% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, nga 82% që llogaritej në fund të vitit 2009 dhe rreth 76.3% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimi i aktiveve të institucioneve financiare u rrit me rreth 5.8% krahasuar me fundin e vitit 2009 dhe 13.6% referuar periudhës së një viti më parë. Sektori bankar vijon të mbetet segmenti mbizotërues i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, ku në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, aktivet e tij përfaqësonin rreth 94.4% të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 79.7% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së).

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, u evidentua rritje e kontributit të sektorit financiar jobankar, edhe pse vazhdon të pasqyrojë peshë totale relativisht të vogël ndaj tërësisë së sistemit financiar. Në raport me totalin e aktiveve të sistemit financiar, totali i aktiveve të sektorit financiar jobankar zë rreth 5.6%, nga 5.3% dhe 4.6% që ishte përkatësisht në fund të vitit 2009 dhe në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009. Në raport me PBB-në, totali i aktiveve të sektorit financiar jobankar zë rreth 4.8%, nga rreth 4.4% dhe 3.5%

që ishte përkatësisht në fund të vitit 2009 dhe në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009.

ZHVILLIME TË SEKTORIT BANKAR

Në fund të muajit qershor të vitit 2010, totali i aktiveve të sektorit bankar arriti në 934.7 miliardë lekë, rreth 5.5% më i lartë se fundi i vitit 2009 dhe 12.4% më i lartë se një vit më parë[2]. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 72% të aktiveve të të gjithë sektorit.

Në përbërjen e aktiveve të sektorit bankar veçojmë:

- portofoli i kredive (pa përfshirë interesat e llogaritura[3]) u ngjit në vlerën 465.4 miliardë lekë, duke u rritur me 4.3% kundrejt fundit të vitit 2009 dhe me 11.1% ndaj një viti më parë. Bankat e Grupit 3, përfaqësonin 64.8% të të gjithë portofolit të huave të sektorit. Kredia në valutë zë rreth 70% të totalit të kredisë;
- veprimet e thesarit dhe ato ndërbankare shënuan vlerën 275.5 miliardë lekë, duke realizuar një rritje me 8.3% ndaj fundit të vitit 2009 dhe me 20.6% ndaj së njëjtës periudhë të vitit të kaluar;
- investimet e sektorit bankar në letrat me vlerë të borxhit publik dhe privat (pa përfshirë interesat e llogaritura), vendas dhe të huaj, kapën vlerën 190.4 miliardë lekë, duke qenë 7.1% më të larta se fundi i vitit 2009 dhe 11% më të larta se një vit më parë. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 90.8% të totalit të këtyre investimeve. Investimet në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me afat maturimi fillestar mbi 1 vit, përfaqësojnë 86.7% të vlerës së përgjithshme të investimeve;
- aktivet e sektorit bankar në valutë arritën nivelin 479.2 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 7.7% kundrejt fundit të vitit 2009, dhe me 19.1% kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 64.7% të totalit të aktiveve në valutë;
- investimet e sektorit bankar në mjete të subjekteve jorezidente, u ngjitën në nivelin 104.8 miliardë lekë, duke u rritur me 25.5% ndaj fundit të vitit 2009 dhe me 73.9% ndaj një viti më parë. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 71.2% të vlerës së përgjithshme të këtyre investimeve. Vendosjet e bankave pranë grupeve bankare zotëruese vlerësohen në masën 55.7 miliardë lekë, prej të cilave 49.8 miliardë lekë ishin në formën e llogarive rrjedhëse e të depozitave dhe 5.9 miliardë lekë ishin në formën e kredive.

---

[2] *Për të gjitha krahasimet e treguesve me një vit më parë, duhet patur parasysh nënçmimi i kursit të këmbimit të lekut i cili ndikon në rritjen e vlerës të raportuar në lekë të zërave në valutë. Keshtu, në datën 30.06.2009, kursi mesatar zyrtar i këmbimit për 1 euro ishte 130.76 lekë ndërsa për 1 dollar ishte 92.73 lekë. Në datën 30.06.2010, këto raporte ishin përkatësisht 136.45 lekë dhe 111.44 lekë.*

[3] *Vlerësohen në rreth 4.3 miliardë lekë.*

Në përbërjen e detyrimeve të sektorit bankar, veçojmë:

- depozitat (pa përfshirë interesat[4] e llogaritura) arritën vlerën rreth 730 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 6.8% kundrejt fundit të vitit 2009. Bankat e Grupit 3 përfaqësojnë 74.1% të vlerës së përgjithshme të depozitave;
- fondet e veta arritën në nivelin 100.8 miliardë lekë, duke qenë 4.9% më shumë se në fund të vitit 2009, dhe 15.9% më shumë se në fund të muajit qershor të vitit 2009. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 67.2% të totalit të fondeve të veta;
- detyrimet në valutë arritën në nivelin 461.7 miliardë lekë, duke u rritur me 6.5% kundrejt fundit të vitit 2009, dhe me 16.9% kundrejt një viti më parë. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 65.1% të vlerës së përgjithshme të detyrimeve në valutë;
- detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve, u vlerësuan në masën 61.5 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 4.4% me fundin e vitit 2009, dhe një rënie me rreth 8.9% në krahasim me një vit më parë. Vlera e linjave të kreditit të përfituara nga grupet bankare zotëruese dhe të përdorura, vlerësohet në rreth 34.6 miliardë lekë. Pjesa e angazhuar por e papërdorur[5] e linjave të kreditit nga grupet bankare zotëruese, vlerësohet në rreth 31.6 miliardë lekë.

Në fund të muajit qershor të vitit 2010, zërat jashtë bilancit përfaqësonin 97.4% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, duke shënuar një rritje me 3.4 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2009 dhe një rënie me 5 pikë përqindje kundrejt një viti më parë.

Për kapitalizimin e veprimtarisë së sektorit bankar veçojmë:

- kapitali i paguar u ngjit në nivelin 63.6 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 4.5% ndaj fundit të vitit 2009 dhe 12.2% ndaj një viti më parë. Kapitali i paguar përfaqësonte 6.8% të totalit të aktiveve, shifër e pandryshuar ndaj së njëjtës periudhë të një viti më parë;
- kapitali i aksionerëve arriti vlerën 89.7 miliardë lekë, duke u rritur me 5.8% kundrejt fundit të vitit 2009 dhe me 15.5% kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Kapitali i aksionerëve përfaqësonte 9.6% të totalit të aktiveve, krahasuar me 9.3% ndaj një viti më parë. Bankat e Grupit 3 përfaqësonin 70.6% të vlerës të kapitalit aksioner të sektorit;
- kapitali rregullator[6] u ngjit në nivelin 87.1 miliardë lekë, duke shënuar një rritje me 7.1% kundrejt fundit të vitit 2009 dhe me 14.4% kundrejt një viti më parë.

---

[4] *Llogariten në vlerën 13.1 miliardë lekë.*

[5] *E regjistruar si zë jashtë bilancit.*

[6] *Përfaqëson një koncept mbikëqyrës, që përbëhet nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë. Përfshin kapitalin e paguar, rezervat e ndryshme, rezultatin neto të pashpërndarë, rezultatin neto të periudhës ushtrimore, detyrimet e varura etj.*

Për situatën e likuiditetit të veprimtarisë së sektorit bankar veçojmë:

- në muajin qershor 2010, depozitat e sektorit bankar përfaqësojnë 79.5% të totalit të detyrimeve, duke qenë rreth 2.5 pikë përqindje më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- aktivet likuide të sektorit bankar, u ngjitën në nivelin 260.4 miliardë lekë, duke zënë rreth 27.8% të totalit të aktiveve të sektorit. Në krahasim me muajin qershor të vitit 2009, ky tregues ka rënë lehtësisht me rreth 0.03 pikë përqindje dhe me dhjetorin e vitit 2009, ky tregues është rritur me rreth 0.2 pikë përqindje;
- raporti kredi/depozita rezultoi në nivelin 63.2%, rreth 1.6 pikë përqindje më i ulët se në fund të vitit 2009, dhe rreth 2.7 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Rënia e këtij raporti, është diktuar prej ngadalësimit të ritmit të rritjes të kredive në krahasim me ritmin e rritjes të depozitave, veçanërisht për valutën. Raporti kredi/depozita, për veprimet në valutë ka rezultuar në nivelin 95.2%, duke qenë rreth 4.2 pikë përqindje më i ulët se në fund të vitit 2009 dhe rreth 12.3 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Raporti kredi/depozita në lekë rezultoi 35.4%, duke qenë përgjithësisht i qëndrueshëm me nivelin e fundit të vitit 2009 dhe rreth 1.4 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë. Sidoqoftë, raporti kredi/depozita pritet të rritet përsëri në momentin e rigjallërimit të veprimtarisë së kreditimit të sektorit bankar.

Për performancën financiare të sektorit bankar veçojmë:

- aktivet mesatare që sjellin të ardhura, në muajin qershor të vitit 2010, u ngjitën në nivelin 833.5 miliardë lekë duke përfaqësuar rreth 91.2% të vlerës së përgjithshme të aktiveve mesatare të sektorit bankar. Ky tregues ka qenë pothuaj në të njëjtat nivele, në fund të vitit 2009, si edhe një vit më parë. Raporti "Pasive mesatare që shkaktojnë shpenzime/Aktive mesatare që sjellin të ardhura" është ngjitur në nivelin 93%, duke qenë rreth 1.3 pikë përqindje më i lartë sesa në fund të vitit 2009 dhe 1.7 pikë përqindje me i lartë sesa një vit më parë;
- të ardhurat e veprimtarisë[7] të sektorit bankar, rezultuan 3.8 miliardë lekë ose 21.7% më të larta se një vit më parë. Kostot operative[8] të veprimtarisë rezultuan 11.4 miliardë lekë ose 10.9% më të larta se një vit më parë. Si rezultat, raporti i kostove operative ndaj të ardhurave rezultoi në nivelin 53.4%, kundrejt 57.2% në fund të vitit 2009 dhe 58.6% një vit më parë. Raporti i shpenzimeve të përgjithshme të veprimtarisë[9] ndaj të ardhurave rezultoi 80.9%, krahasuar me 94.5% në fund të vitit 2009 dhe 94% një vit më parë. Ecuria e raporteve konfirmon përpjekjet e bankave për të kompensuar rritjen e shpenzimeve për provigjone (dhe rezerva të tjera) me pakësimin e kostove operative të veprimtarisë;

[7] *Të ardhurat neto nga interesat plus të ardhurat e tjera neto.*
[8] *Pa përfshirë shpenzimet për provigjone.*
[9] *Kosto operative plus shpenzime për provigjone dhe rezerva të tjera.*

- rezultati neto ishte pozitiv, në masën 3.6 miliardë lekë, duke qenë rreth 5.5 herë më i lartë se fitimi i realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ose sa 37.2% e të gjithë fitimit të realizuar në vitin 2009. Bankat më të mëdha që përbëjnë Grupin 3, realizuan një fitim të akumuluar në masën 4.8 miliardë lekë. Humbjet financiare të akumuluara ishin në masën 1.8 miliardë lekë;
- kthimi mbi aktivet (RoA), i kthyer në bazë vjetore, ka rezultuar në masën 0.8%. Në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ai ishte rreth 0.2%;
- kthimi mbi kapitalin (RoE), i kthyer në bazë vjetore, ka rezultuar në masën 8.3%. Një vit më parë ky tregues ishte 1.8%.

Për sa i takon treguesve të vlerësimit dhe të administrimit të rreziqeve në veprimtarinë e sektorit bankar veçojmë:

a) në lidhje me rrezikun nga kursi i këmbimit:

- aktivet në valutë dhe detyrimet në valutë janë në vlerë të përafërt, duke përcaktuar në këtë mënyrë një strukturë të ekuilibruar të bilancit të sektorit bankar dhe duke kufizuar ndjeshëm ndikimin në bilancin e bankave të ndryshimeve të pafavorshme të kursit të këmbimit;
- pozicioni i hapur neto në valutë, në qershor të vitit 2010, ishte "në blerje", pranë nivelit 6.3 miliardë lekë, duke zënë rreth 7.3% të kapitalit rregullator të sektorit bankar. Për një tremujor, ky tregues relativ është më i larti që prej muajit shtator të vitit 2008, duke shfaqur një ekspozim më të lartë ndaj ndryshimeve të kursit të këmbimit;
- analiza "stress-test" që vlerëson ndjeshmërinë e sektorit bankar ndaj ndryshimeve të pafavorshme të kursit të këmbimit, paraqet një ndikim mjaft të moderuar.

b) në lidhje me rrezikun e normës së interesit:

- aktivet e ndjeshme ndaj normës së interesit dhe pasivet e ndjeshme ndaj normës së interesit, paraqiten në nivele të përafërta, sipas segmenteve të maturimit në qershor të vitit 2010. Diferenca mes tyre për periudhën deri në 1 muaj, deri në 3 muaj dhe deri në 12 muaj është negative. Në një arsyetim të përgjithshëm, në një afat kohor deri në 12 muaj, do të thotë që një rritje e normës së interesit do të shkaktojë kosto neto shtesë për sektorin bankar, duke ndikuar negativisht në rezultatin e tij financiar, e rrjedhimisht edhe në treguesit e kapitalit. Megjithatë, përmasat e këtij ndikimi rezultojnë të kufizuara dhe nuk kërcënojnë mjaftueshmërinë e kapitalizimit të sektorit bankar, sipas analizës së ndjeshmërisë që është pjesë e analizës stress-test;
- në qershor të vitit 2010, aktivet e sektorit bankar kishin një afat maturimi mesatar të mbetur prej 28.04 muaj, nga 29.5 muaj që llogaritej në fund të vitit 2009. Ndërkohë, referuar së njëjtës periudhë, maturimi mesatar i mbetur i pasiveve të sektorit bankar llogaritet rreth 11.4 muaj me luhatje të lehtë nga vlera e fundit të vitit 2009, prej 11.9 muaj. Ngushtimi i diferencës sipas maturimit të mbetur të aktiveve dhe të pasiveve të sektorit bankar ka ardhur kryesisht si rezultat i rënies së ritmit të kreditimit dhe rritjes së përqendrimit të portofolit të kredisë në afate më të shkurtra.

c) në lidhje me rrezikun e kreditit:

- aktivet me rrezik[10] të sektorit bankar, rezultojnë në nivelin 537.2 miliardë lekë, ndërsa aktivet pa rrezik rezultojnë në nivelin 399.4 miliardë lekë. Ndër aktivet me rrezik, ato me rrezik të lartë[11] kapin vlerën 417.7 miliardë lekë. Vlera e aktiveve me rrezik ishte 6.8% më e lartë kundrejt fundit të vitit 2009 dhe rreth 18.9% më e lartë ndaj një viti më parë. Aktivet me rrezik zënë 57.5% të totalit të aktiveve, shumë pranë vlerës së llogaritur në fund të vitit 2009 dhe rreth 3 pikë përqindje më shumë se niveli i një viti më parë. Rritja e tyre në krahasim me një vit më parë, i dedikohet rritjes të aktiveve që ponderohen me koeficientët më të lartë të rrezikut, si rezultat i përcaktimeve në kuadrin rregullativ;
- raporti i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë, mbi baza bruto, u ngjit në nivelin 12.2%, kundrejt 10.5% në fund të vitit 2009 dhe 8.73% një vit më parë. Kreditë me probleme të sektorit bankar u ngjitën në nivelin 57.3 miliardë lekë, duke shënuar rritje me rreth 10.2 miliardë lekë ose 21.6% krahasuar me fundin e vitit 2009, dhe me rreth 20.5 miliardë lekë ose rreth 55.5% krahasuar me një vit më parë. Sipas kategorive të klasifikimit të kredisë, rreth 72.7% e portofolit të kredisë konsiderohet "standard". Konstatohet zhvendosje e kredisë në klasat me cilësi më të ulët, si "hua nënstandard" ose "hua të humbura", pesha e të cilave është ngjitur përkatësisht në nivelet 5.4% dhe 3.6%, nga 4.7% dhe 3% në fund të vitit 2009;
- raporti kredi me probleme neto ndaj kapitalit rregullator, është ngjitur në nivelin 31.2%, krahasuar me 28.2% në fund të vitit 2009 dhe 24.6% një vit më parë;
- cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie si për bizneset, ashtu edhe për individët. Raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë për bizneset dhe për individët llogaritet përkatësisht 13.8% dhe 10.3%, nga 12.4% dhe 8.2% në fund të vitit 2009. Gjithashtu, cilësia e portofolit të kredisë sipas monedhës, është në rënie si për portofolin në lekë ashtu edhe për atë në valutë. Treguesit kredi me probleme në lekë ndaj tepricës së kredisë në lekë dhe "kredi me probleme në valutë/tepricës së kredisë në valutë" u llogaritën përkatësisht në nivelet 12.7% dhe 11.9%, krahasuar me 10.1% dhe 10.6%, që rezultuan në fund të vitit 2009;
- teprica e kredisë në valutë kur të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, rezultoi rreth 177.6 miliardë lekë, duke përbërë 37.7% të tepricës së kredisë në total dhe rreth 54% të tepricës së kredisë në valutë. Sipas monedhave, rreth 84% e kësaj kredie është në euro dhe rreth 15% është në dollarë. Kundrejt totalit të tepricës së kredisë në valutë, pjesa e kësaj kredie në euro zë 45.6% dhe ajo në dollarë zë 8.2%. Kjo pjesë e kredisë përfaqëson një kanal të mundshëm të ndikimit negativ mbi

[10] *Që për qëllim të llogaritjes së normës së mjaftueshmërisë të kapitalit, ponderohen me një koeficient të caktuar rreziku (20%, 50%, 100% ose 150%). Në përgjithësi, aktivet me rrezik mbizotërohen nga portofoli i kredisë dhe përfshijnë edhe investimet në letrat me vlerë të borxhit dhe vendosjet pranë institucioneve financiare.*

[11] *Që për qëllim të llogaritjes së normës të mjaftueshmërisë të kapitalit, ponderohen me koeficientët e rrezikut 100% dhe 150%. Përfaqësohen kryesisht nga kredia, duke përfshirë edhe kredinë në valutë për huamarrës që kanë të ardhura në lekë.*

sektorin bankar të ndryshimeve të pafavorshme të kursit të këmbimit, që mund të shoqërohen edhe me rritje të tërthortë të rrezikut të kreditit si rezultat i vështirësive të huamarrësve për pagesën e detyrimit të kredisë;

- fondet rezervë për përballimin e rrezikut të kreditit (provigjonet) nga huadhënia për rezidentët, u ngjitën në nivelin 30.1 miliardë lekë, rreth 24.6% më shumë se fundi i vitit 2009 dhe 66% më shumë se një vit më parë. Raporti i provigjoneve me kredinë me probleme rezultoi në nivelin 52.5%, duke mbetur pothuaj i pandryshuar në tre tremujorët e fundit. Raporti i provigjoneve ndaj totalit të tepricës të kredisë, u ngjit në nivelin 6.4%, krahasuar me 5.4% të fund të vitit 2009 dhe 4.3% një vit më parë. Gjithashtu, mbulimi me kolateral i portofolit të kredisë me probleme llogaritet në nivelin 78% dhe konsiderohet i kënaqshëm.

d) në lidhje me rrezikun e likuiditetit:

- raporti i aktiveve likuide me pasivet afatshkurtra (me maturim deri në një vit) rezultoi në nivelin 32.8%, kundrejt 32.6% në fund të vitit 2009. Vlera minimale e këtij raporti të përcaktuar në kuadrin rregullativ është 20%. Sipas monedhave, vlera e raportit paraqitet më e ulët për euron me rreth 13.7%, dhe më e lartë për lekun me rreth 46.5%;
- diferencat midis aktiveve dhe pasiveve sipas strukturave kohore të maturimit[12], si për zërat e bilancit ashtu edhe pas përfshirjes të zërave jashtë bilancit, rezultojnë në vlera negative. Megjithatë, këto diferenca mbulohen disa herë nga vlera e aktiveve likuide, duke paraqitur një aftësi të plotë për pagesën e detyrimeve në momentin e maturimit të tyre. Sidoqoftë, në këtë kuadër nevojitet të monitorohet me kujdes situata e likuiditetit në valutë dhe veçanërisht në euro;
- një formë tjetër e administrimit të nevojave afatshkurtra për likuiditet është huamarrja në tregun ndërbankar ose nga Banka e Shqipërisë. Përgjithësisht, kjo është një huamarrje e kolateralizuar dhe lloji e mjaftueshmëria e aktiveve që mund të shërbejnë si kolateral në këtë rast, është një tjetër element që duhet monitoruar për të vlerësuar aftësinë e bankave që të plotësojnë nevojat e tyre për likuiditet në afat të shkurtër.

e) në lidhje me aftësinë paguese:

- në fund të tremujorit të dytë të vitit 2010, sektori bankar shqiptar vlerësohet i mirëkapitalizuar. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, rezultoi në nivelin 16.2% ashtu si në fundin e vitit 2009, por duke qenë 0.6 pikë përqindje më e ulët se një vit më parë. Niveli minimal i këtij treguesi, i përcaktuar nga kuadri rregullativ është 12%. Sipas grupeve të bankave, bankat e Grupit 2 paraqesin nivelin më të ulët të treguesit me 14%;

Për të vlerësuar gjendjen e sektorit bankar nëpërmjet një treguesi të vetëm, kemi ndërtuar dhe kemi llogaritur, me frekuencë tremujore, vlerën e Indeksit të Fortësisë Financiare. Ky indeks mbështetet në ecurinë e disa nënindekseve që përfshijnë: cilësinë e aktiveve, likuiditetin, rrezikun e kursit të këmbimit,

[12] *Duke supozuar mbajtjen deri në maturim të aktiveve dhe të pasiveve.*

përfitueshmërinë, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rrezikun e normës së interesit. Vlerësohet se në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, vlera e indeksit të fortësisë financiare ka arritur në rreth 85.2, duke shënuar një rënie të lehtë prej 0.3%, krahasuar me fundin e vitit 2009. Në tremujorin e fundit, ecuria e indeksit është përcaktuar nga rënia e cilësisë të aktiveve, e kursit të këmbimit (për shkak të një rreziku më të lartë, si rezultat i rritjes së pozicionit të hapur valutor) dhe e likuiditetit. Performancë pozitive në rritje kanë patur nënindeksi i përfitueshmërisë dhe ai i normës së interesit. Nënindeksi i mjaftueshmërisë të kapitalit ka qenë i qëndrueshëm. Sipas indeksit, rënia e vlerave të tij nën vlerën mesatare ka ndaluar dhe është stabilizuar në katër tremujorët e fundit.

Për të testuar rezistencën e sektorit bankar ndaj zhvillimeve të pafavorshme të supozuara të treguesve ekonomikë dhe nevojat e tij për kapital shtesë, përdorim "stress-testin" i cili përmban "analizën e ndjeshmërisë" dhe atë të "skenarëve". Sipas analizës së ndjeshmërisë, sektori bankar paraqitet përgjithësisht i mbrojtur prej rrezikut të kursit të këmbimit dhe rrezikut të normës së interesit. Sektori bankar paraqitet më i ndjeshëm prej rrezikut të kreditit, nëse supozohet një dyfishim i vlerës së kredisë me probleme. Sipas analizës të skenarëve, nevojat për kapital shtesë të sektorit bankar vlerësohen në funksion të ndikimit të kombinuar të disa faktorëve makroekonomikë dhe të zhvillimeve të brendshme të treguesve financiarë të sektorit bankar, të cilët përfshijnë lëvizjet e pafavorshme në kursin e këmbimit, në normat e interesit, në ecurinë ekonomike, në ecurinë e ritmit të rritjes së kredisë dhe në reflektimin e tyre në ecurinë e kredisë me probleme. Nga analiza rezulton që sektori bankar mund të përballojë një përkeqësim të mëtejshëm të portofolit të kredisë me probleme, i cili shtrihet në një hark kohor prej një viti. Edhe sipas kësaj analize, kërkesat për kapital për sektorin bankar në përgjithësi shfaqen në rastin e përkeqësimit të ndjeshëm të situatës ekonomike. Në përgjithësi, analiza e skenarëve, si pjesë e ushtrimit "stress-test", konfirmon që për skenarët bazë, të cilët përmbajnë supozime të mundshme të zhvillimeve në periudhën 2010-2011, sektori bankar është i aftë të përballojë goditje të ndjeshme që rezultojnë prej lëvizjeve të pafavorshme të faktorëve ekonomikë dhe që përkeqësojnë cilësinë e kredisë. Megjithatë, për banka të veçanta mund të jenë të nevojshme shtesa të kapitalit në varësi të situatave të paraqitura. Për një skenar ngjarjesh më ekstrem, sektori bankar paraqet probleme në treguesit e kapitalit dhe kërkesat për kapital të bankave të veçanta janë të ndjeshme. Pavarësisht se ky mbetet një ushtrim, supozimet e të cilit ka shumë të ngjarë të mos materializohen në realitet, bankat duhet të testojnë rezistencën e tyre në ushtrime të ngjashme dhe të vlerësojnë në vazhdimësi, pra në mënyrë paraprake, nevojat për kapital shtesë.

1. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE

1.1. ZHVILLIMET E PËRGJITHSHME EKONOMIKE NË BOTË

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ekonomia botërore është rritur me rreth 4.7%, në nivel vjetor, duke përfituar nga vijueshmëria e politikave stimuluese të autoriteteve publike dhe prej përmirësimit të funksionimit të tregjeve financiare. Sipas stadit të zhvillimit, ritmi i rritjes ekonomike ka qenë më i lartë në vendet në zhvillim, të cilat shënuan një rritje vjetore prej rreth 7.25%. Vendet e Azisë dhanë ndikimin kryesor në rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim, ku veçohen Kina, India dhe Indonezia. Në Amerikën Latine, Brazili dha kontributin kryesor në rritjen ekonomike. Faktorë mbështetës të rritjes ekonomike në vendet në zhvillim, ishin qëndrueshmëria e kërkesës së brendshme dhe rigjallërimi i dukshëm i tregtisë ndërkombëtare. Në vendet e zhvilluara, rritja ekonomike vjetore në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ishte rreth 3%.

Zhvillimet ekonomike ishin më pozitive në tremujorin e parë të vitit 2010, ku prodhimi industrial dhe tregtia regjistruan rritje dyshifrore, niveli i papunësisë në vendet e zhvilluara nisi të stabilizohet dhe në përgjithësi treguesit e besimit të konsumatorëve u përmirësuan. Në rang botëror, zhvillimet e inflacionit ishin të moderuara, por presioni inflacionist u bë më i ndjeshëm në vendet në zhvillim, ku rritja ekonomike ishte më e shpejtë. Gjatë kësaj periudhe, ka patur një funksionim më të mirë të tregjeve financiare, i shfaqur nëpërmjet rritjes së qëndrueshme të aktivitetit dhe prirjes rënëse të normave të interesit. Besimi i investitorëve u përmirësua, duke sjellë një zhvendosje graduale të investimeve nga aktivet e sigurta drejt atyre me rrezik më të lartë dhe veçanërisht drejt tregjeve në zhvillim. Si rezultat, edhe likuiditeti në tregje u përmirësua dukshëm, duke i dhënë mundësinë bankave qendrore të fillojnë tërheqjen graduale të disa prej masave mbështetëse të aktivizuara gjatë krizës financiare.

Pasiguria e tregjeve dhe e agjentëve ekonomikë, u rikthye në tremujorin e dytë të vitit 2010, e nxitur prej shqetësimeve mbi qëndrueshmërinë fiskale të disa vendeve të Eurozonës. Në afat të shkurtër, kjo solli një tkurrje të veprimtarisë së tregjeve financiare dhe shtrëngim të kushteve të likuiditetit. Veprimet e vendosura të autoriteteve të Bashkimit Evropian (BE) dhe të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), ndihmuan në kapërcimin e një situate kritike dhe rivendosjen e tregjeve në një funksionim më normal. Megjithatë, tronditjet në tregjet financiare evropiane u përcollën dhe në tregjet në zhvillim përmes rënies së kërkesës të investitorëve për asete të sektorit publik dhe privat. Si rezultat, pati luhatshmëri të dukshme por afatshkurtra në tregjet e monedhave, të letrave me vlerë të kapitalit e të borxhit, si edhe të lëndëve të para të

prodhimit. Këto lëvizje, sidoqoftë mbështetën pritshmëritë për një rënie të ritmit të rritjes së ekonomisë botërore, në periudhën në vazhdim.

Ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka vazhduar të shënojë rritje pozitive gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2010 por me një ritëm më të ulët në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2009. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) shënoi një rritje reale vjetore prej 3.7% në tremujorin e parë dhe 2.4% në tremujorin e dytë të vitit 2010[13]. Në të dy tremujorët, rritja e PPB-së ka reflektuar kontributin pozitiv të investimeve të biznesit, ndërkohë që është frenuar nga kontributi negativ i balancës së tregtisë së jashtme. Gjithashtu, konsumi mbetet përgjithësisht i dobët për shkak të persistencës së nivelit të papunësisë dhe paqëndrueshmërisë së vlerës së pasurive të patundshme. Norma vjetore e papunësisë është zbutur disi në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2010, krahasuar me tremujorin e fundit të 2009, duke u stabilizuar në nivelin mesatar 9.7%. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, presionet inflacioniste mbetën të ulëta dhe norma vjetore e inflacionit në fund të saj rezultoi në nivelin 1.8%. Për këtë arsye, Rezerva Federale e SHBA-së, mbajti të pandryshuar normën e interesit të politikës monetare, në nivelin 0.25%. Në tregtinë e jashtme, deficiti i llogarisë korente u ngjit në rreth 3% të PBB-së në tremujorin e parë të vitit 2010, krahasuar me nivelin 2.8% të PPB-së në tremujorin e fundit të vitit 2009[14].

Në sferën fiskale, për shkak të veprimit të kombinuar mes stimujve e paketave financiare të shpëtimit dhe ndikimit të stabilizuesve automatikë të buxhetit, është ruajtur gjendja e lartë e deficitit në balancat e sektorit publik. Projeksionet e autoriteteve[15] tregojnë për një përmirësim gradual të deficitit buxhetor, por vlerat e borxhit publik pritet të mbeten të theksuara edhe për disa vite në të ardhmen.

Tabelë 1. Ecuria e disa treguesve kryesorë makroekonomikë të SHBA-së.

	T3 '09	T4'09	T1'10	T2'10
Rritja reale e PBB-së (% vjetore)	1.6	5.0	3.7	2.4
Norma vjetore e inflacionit (% vjetore)	-1.6	1.4	2.4	1.8
Norma vjetore e papunësisë (% vjetore)	9.6	10	9.7	9.7
Deficiti buxhetor (në % ndaj PBB-së)	-11.6	-11.1	-10.9	..
Borxhi bruto i qeverisë (në % ndaj PBB-së)	65.8	67.6	70.7	..

Burimi: Databaza e BQE, Buletini mujor i BQE, Zyra e Analizave Ekonomike (BEA).

Rritja e nevojave për financim të qeverisë amerikane dhe në përgjithësi pamjaftueshmëria e financimit të nevojave të sektorit privat, kanë vënë në dyshim zbatimin e objektivit për tërheqjen graduale të masave mbështetëse për likuiditetin e tregut nga ana e Rezervës Federale të SHBA-së. Njëkohësisht, qëndrueshmëria e normës së papunësisë dhe e deficitit tregtar, si edhe norma e moderuar e inflacionit, janë elemente të cilat do të ndikojnë në zbatimin e një politike monetare akomoduese për periudhën e ardhshme të parashikueshme.

[13] *Sipas Zyrës së Analizave Ekonomike.*
[14] *Shifra të publikuara nga BEA-ja në botimin e datës 17 korrik 2010.*
[15] *Congressional Budget Office (CBO).*

Ecuria ekonomike e rajonit të Evropës ka vazhduar të përmirësohet gjatë dy tremujorëve të parë të vitit 2010, por me ritme më të ngadalta sesa ajo e SHBA-së dhe duke ruajtur diferenca të dukshme midis vendeve. Gjermania dhe Suedia kanë kryesuar rritjen ekonomike të vendeve të BE-së, ndërsa Greqia dhe Spanja kanë vazhduar të përjetojnë rënie ekonomike. Vlerësohet[16] që PBB-ja e BE-së dhe e Eurozonës u rrit me 0.2% gjatë tremujorit të parë të vitit 2010 dhe 1% gjatë tremujorit të dytë. Në terma vjetorë[17], rritja e PBB-së në tremujorin e parë ka rezultuar përkatësisht 0.5% për rajonin e BE-së dhe 0.6% për rajonin e Eurozonës. Në tremujorin e dytë, rritja vlerësohet të jetë 1.7% në secilin rajon (Tabela 2). Në tremujorin e parë, rritja erdhi kryesisht si rrjedhojë e kontributit pozitiv të inventarëve dhe të investimeve të sektorit privat, që kanë tejkaluar efektin negativ të kërkesës së brendshme dhe të eksporteve neto. Presionet inflacioniste në BE dhe në Eurozonë në përgjithësi, kanë mbetur të moderuara gjatë gjysmës së parë të vitit. Në muajin qershor të vitit 2010, normat vjetore të inflacionit për BE-në dhe Eurozonën rezultuan përkatësisht 1.9% dhe 1.4%. Norma më e ulët e inflacionit u regjistrua në Irlandë (-2.0%) dhe Letoni (-1.6%), dhe normat më të larta u regjistruan në Greqi (5.2%) dhe Hungari (5.0%).

Për sa i përket zhvillimeve të sektorit të tregtisë në rajonin e Eurozonës, gjatë tremujorit të parë të vitit 2010 pati një rritje të importeve dhe të eksporteve, por efekti neto në rritjen ekonomike ishte negativ. Normat e larta të rritjes së tregtisë gjatë kësaj periudhe, mund të shihen si një korrektim i rënies së theksuar të saj gjatë vitit 2008 dhe gjysmës së parë të vitit 2009. Të dhënat më të fundit tregojnë së niveli i tregtisë së Eurozonës ka vazhduar të rritet dhe pas tremujorit të parë, por me një ritëm disi më të ngadaltë. Në tregun e punës në Eurozonë, kushtet duket se kanë ardhur duke u stabilizuar. Në tremujorin e parë të vitit 2010, niveli mesatar i punëzënies në Eurozonë mbeti i pandryshuar, që konsiderohet pozitive krahasuar me rënien e theksuar gjatë periudhave të mëparshme. Norma e papunësisë së këtij rajoni mbeti e pandryshuar në nivelin 10% për disa muaj me radhë deri në korrik të vitit 2010, gjë që sugjeron një stabilizim të tregut të punës edhe për muajt në vazhdim.

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë në BE dhe në Eurozonë.

	Rritja e PBB-së			Inflacioni		Papunësia mujore	
	(në %)			(normë vjetore)		(në %)	
	T4-09/ T4-08	T1-10/ T1-09	T2-10/ T2-09	Qershor 10/ Qershor 09	Korrik 10/ Korrik 09	Qeshor '10	Korrik'10
BE	-2.3	0.5	1.7	1.9	2.1	9.6	9.6
Eurozonë	-2.1	0.6	1.7	1.4	1.7	10.0	10.0
Gjermani	-2.0	2.0	3.7	0.8	1.2	7.0	7.0
Francë	-0.5	1.2	1.7	1.7	1.9	9.9	10.0
Itali	-0.8	0.5	1.1	1.5	1.8	8.6	8.5
Greqi	-2.6	-2.3	-3.5	5.2	5.5	..	11*
Jo-Eurozonë							
Mbretëri e Bashkuar	-2.9	-0.2	1.6	3.2	..	..	7.9*

Burimi: Eurostat, BQE database.

[16] *Eurostat, Botim i datës 13 gusht 2010.*

[17] *Diferencë në përqindje e tremujorit aktual krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë.*

Grafik 1. Balanca buxhetore dhe borxhi publik në Eurozonë.



Burimi: Eurostat.

Treguesit e ecurisë së situatës fiskale në Eurozonë vijuan të përkeqësohen gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010.

Situata u bë dramatike në tremujorin e dytë të vitit, pas vështirësive akute që ndeshi Greqia dhe prej frikës për shtrirjen e tyre në vende të tjera si Spanja, Irlanda dhe Portugalia. Tregjet filluan të spekulojnë mbi qëndrueshmërinë e projektit të Eurozonës. Për këtë arsye, në mënyrë të përshpejtuar dhe me mbështetjen e FMN-së, Bashkimi Evropian miratoi një fond prej 110 miliardë eurosh në ndihmë të Greqisë, në këmbim të angazhimeve të qeverisë greke për të vendosur nën kontroll deficitin e jashtëzakonshëm buxhetor nëpërmjet shkurtimeve të thella të shpenzimeve dhe nëpërmjet rritjes të taksave. Në mënyrë individuale, pothuaj të gjitha vendet anëtare nxituan të shpallin objektivat për uljen e deficiteve buxhetore[18], si masë parandaluese për spekulimet e ndryshme në tregje. Në mënyrë më të formalizuar, në muajin maj vendet anëtare të Bashkimit Evropian vendosën të adoptojnë propozimet e Komisionit Evropian për të ndërtuar Mekanizmin e Stabilizimit Financiar Evropian, për t'iu përgjigjur me shpejtësi, në mënyrë të harmonizuar dhe me efektivitet, vështirësive akute në financimin e deficitit buxhetor të secilit vend anëtar, duke ulur në këtë mënyrë spekulimet negative në tregje. Njëkohësisht, Komisioni Evropian paraqiti propozimet për përshpejtimin e procesit të hartimit dhe të zbatimit të politikave më agresive për konsolidimin fiskal në kuadër të përputhshmërisë me Paktin e Stabilizimit dhe të Rritjes (PSR). Sipas propozimeve, buxhetet kombëtare të secilit vend anëtar do t'i nënshtrohen një procesi paraprak rishikimi, për t'u siguruar që ato mbeten në përputhje me objektivat e përcaktuar në PSR dhe janë të qëndrueshme përgjatë kohës. Në ato raste kur përcaktimet në buxhetet e paraqitura devijojnë nga objektivat e përcaktuar në PSR, parashikohet që vendi përkatës t'i nënshtrohet një procedure të posaçme për përmirësimin e situatës që përfshin edhe sanksionet financiare. Në sferën monetare, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ndërmori veprimet e nevojshme për të rikthyer likuiditetin në tregjet e letrave me vlerë të borxhit të qeverive.

Situata e financave të sektorit publik në Eurozonë parashikohet që të vazhdojë të jetë e vështirë gjatë pjesës së mbetur të vitit 2010, kur vlera mesatare e deficitit buxhetor pritet të rezultojë rreth 6.6% të PPB-së. Një përmirësim gradual pritet[19] gjatë vitit të ardhshëm, kur vlera mesatare e deficitit buxhetor të Eurozonës pritet të bjerë në nivelin 6.1% e PBB-së. Në përgjithësi, gjatë vitit të ardhshëm, deficitet buxhetore të shumicës së vendeve anëtare pritet të stabilizohen dhe në disa raste të shënojnë rënie.

Në rajonin e Evropës Qendrore e Juglindore, situata makroekonomike ka ardhur duke u përmirësuar gradualisht. Mes vendeve më të mëdha

[18] *Shiko "Hapësirë informuese në faqen 30".*
[19] *Sipas Komisionit Evropian, Parashikimi Pranverë 2010.*

anëtare të BE-së, vetëm Rumania regjistroi një rënie ekonomike prej 0.3% gjatë tremujorit të parë të vitit 2010, krahasuar me tremujorin e fundit të vitit 2009. Në përgjithësi, treguesit e besimit dhe të prodhimit industrial, si dhe shifrat e tregtisë në vendet e këtij rajoni, tregojnë për një përmirësim të aktivitetit ekonomik. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e nivelit të papunësisë dhe kushtet e dobëta të financimit nga sektori bankar (veçanërisht në Hungari dhe në Rumani), ndikojnë në dobësimin e kërkesës së brendshme dhe e bëjnë të luhatshme rritjen ekonomike. Edhe në këtë rajon, zhvillimet inflacioniste kanë qenë të kontrolluara.

Tabelë 3. Tregues makroekonomikë të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe vendeve të Baltikut.

	Rritja reale e PBB-së (në %)			Inflacioni (normë vjetore)		Papunësia mujore (në %)	
	T4-09/ T4-08	T1-10/ T1-09	T2-10/ T2-09	Qershor 10/ Qershor 09	Korrik 10/ Korrik 09	Maj '10	Qershor '10
Hungari	-4.8	-1.2	0.1	5.0	3.6	10.4	10.4
Çeki	-3.2	0.9	2.2	1.0	10.0	7.5	7.4
Poloni	2.8	2.8	..	2.3	2.4	9.7	9.6
Rajoni i Ballkanit							
Bullgari	-5.9	-3.6	-1.5	2.5	3.2	9.7	9.7
Rumani	-6.9	-3.2	..	4.3	7.1	..	..
Serbi		0.6	..	4.2			
FYROM	1.2	-0.9	..	1.8	..	33.5*	
Vendet e Balltikut							
Estoni	-9.5	-2	3.5	3.4	2.8	..	..
Letoni	-16.8	-5.1	-3.9	-1.6	-0.7	..	..
Lituani	-12.5	-2.7	1.1	0.9	1.7	..	..

Burimi: Eurostat database, Eurostat Newsrelease, bankat qendrore përkatëse.
** të dhëna për T1 2010.*

Për pjesën e mbetur të vitit, pritjet për rritjen ekonomike botërore janë pozitive, por më të ulëta se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010. Niveli i rritjes ekonomike do të varet prej mënyrës së realizimit të konsolidimit fiskal nga ana e autoriteteve publike dhe prej performancës së tregjeve financiare në kushtet e nevojës për rigjallërim të qëndrueshëm të kreditimit. Ekonomia në vendet e zhvilluara pritet të rritet me 2.5% gjatë vitit 2010 dhe gjatë vitit 2011[20]. Rritja disi më e fortë në SHBA do të kundërbalancohet nga një rritje pak më e dobët në vendet e Eurozonës, ku vendet anëtare pritet të shfaqin diferenca të theksuara në performancën ekonomike. Konsolidimi fiskal do të përfaqësojë sfidën më të madhe për këto vende, shoqëruar nga kontrolli mbi nivelin e papunësisë dhe nga nevoja për rigjallërimin e financimit të sektorit bankar. Presionet inflacioniste pritet të mbeten të buta në vendet e zhvilluara, kryesisht për shkak të niveleve ende të ulëta të shfrytëzimit të kapaciteteve nga bizneset dhe prej pritjeve të mirankoruara inflacioniste. Madje, në disa prej ekonomive të zhvilluara vazhdon të ekzistojë rreziku i deflacionit për shkak të ecurisë së ngadaltë ekonomike dhe treguesve të dobët të besimit. Për sa i përket grupit të vendeve në zhvillim, rritja ekonomike vjetore e tyre për vitin 2011 parashikohet të jetë 6.5%, ku do të vazhdojnë të kryesojnë vendet në zhvillim të rajoneve të Azisë dhe të Amerikës Latine. Në dallim nga vendet e zhvilluara, norma mesatare e inflacionit në vendet në zhvillim pritet të arrijë

[20] *FMN: "Parashikimi Ekonomik Global", korrik 2010.*

në nivelin 6.25% në vitin 2010 dhe të zbresë në 5% në vitin 2011. Edhe në vendet e rajonit të Evropës Juglindore, do të ketë dallime në performancën ekonomike. Ekonomitë të cilat e përballuan relativisht mirë krizën financiare, si Polonia, dhe që kanë përballuar me sukses goditjet e jashtme si Turqia, pritet të kenë një rritje të kënaqshme ekonomike, të mbështetur nga rikthimi i flukseve hyrëse të kapitalit dhe përmirësimi i mëtejshëm i tregtisë botërore. Nga ana tjetër, vendet që u përballën me krizën në kushtet e balancave të theksuara negative të llogarisë korente si Bullgaria, Letonia, Lituania ose që kishin një pozicion të dobët fiskal si Hungaria e Rumania, pritet të ndeshen me një rigjallërim më të ngadaltë të ekonomisë.

Hapësirë Informuese 1. Programet e konsolidimit fiskal në disa vende të BE-së.

GREQIA
Qeveria greke është e angazhuar të ngushtojë deficitin buxhetor nga niveli aktual 13.6% e PBB-së në nivelin e caktuar nga Pakti i Stabilitetit 3% e PBB-së deri në vitin 2014, çka do të thotë një shkurtim i shpenzimeve të buxhetit prej 30 miliardë euro. Disa nga masat e parashikuara janë: riorganizimi i skemës së pensioneve dhe rritja e moshës së pensionit; heqja e shpërblimeve për punonjësit e sektorit publik; ngrirje e pagave të sektorit publik dhe pensioneve për të paktën 3 vjet; rritja e TVSH-së nga 19% në 23%; rritja e taksave mbi naftën, mbi alkoolin dhe mbi duhanin me 10%.

ITALIA
Qeveria italiane ka aprovuar masat për të realizuar një ulje të deficitit buxhetor në vlerën 24 miliardë euro (ose 1.6% e PBB-së) gjatë harkut kohor 2011-2012, me qëllim uljen e deficitit nën tavanin prej 3% të PBB-së. Masat kryesore përfshijnë: ulje të pagesave të sektorit publik dhe ngrirje të rekrutimeve të reja për tri vitet e ardhshme; ulje progresive deri në 10% në pagesat më të larta të sektorit publik; shtyrje e moshës së pensionit etj.

SPANJA
Recesioni i zgjatur ekonomik i Spanjës ka thelluar deficitin buxhetor në më shumë se 11% të PBB-së, shumë më lart se kufiri i caktuar nga BE-ja. Në 12 maj, qeveria spanjolle njoftoi një ulje të shpenzimeve buxhetore deri në shumën 15 miliardë euro gjatë periudhës 2010- 2011, ku disa nga masat janë: ulje e pagesave të sektorit publik me 5% duke filluar nga muaji qershor dhe mbajtja e tyre e pandryshuar për vitin 2011; ulje e investimeve publike me më shumë se 6 miliardë euro; ngrirje e disa kategori pensionesh (nuk do të pësojnë rritje).

REPUBLIKA E IRLANDËS
Qeveria irlandeze ka prezantuar tri paketa për shkurtime buxhetore brenda një viti. Aktualisht deficiti fiskal i Irlandës është në nivelin 12% të PBB-së dhe qeveria synon ta ulë në nivelin 2.9% të PBB-së deri në vitin 2014. Masat që do të merren përfshijnë: 760 milionë euro shkurtime në përfitimet sociale dhe 960 milionë euro shkurtime në projekte investimi; ulje e përfitimeve për familjet me shumë fëmijë; vendosja e një takse të re karboni që parashikon 15 euro për çdo ton CO2 të emetuar etj.

GJERMANIA
Qeveria gjermane ka propozuar një plan për të realizuar një ulje të theksuar të deficitit buxhetor me 80 miliardë euro ose 3% të PBB-së deri në vitin 2014. Deficiti i përgjithshëm i buxhetit total të Gjermanisë parashikohet të arrijë më shumë se 5% gjatë vitit 2010. Ky plan përfshin: heqjen e subvencioneve të prindërve; shkurtimin e 10.000 vendeve të punës në sektorin publik për katër vjet; shtyrjen në kohë të disa investimeve publike etj.

MBRETËRIA E BASHKUAR
Qeveria ka njoftuar një pakësim të shpenzimeve buxhetore me 6.2 miliardë £ (7.2 miliardë euro) për periudhën 2010-2011, por duke bërë të qartë që ky është vetëm hapi i parë drejt uljes së deficit të madh buxhetor të vendit prej 156 miliardë £ ose mbi 11% të PBB-së.

PORTUGALI
Qeveria portugeze ka njoftuar një sërë masash shtrënguese që synojnë uljen e deficitit buxhetor në nivelin 7.3% të PBB-së në 2010 dhe në nivelin 4.6% në 2011. Në vitin 2009, deficiti buxhetor i Portugalisë arriti në 9.4% të PBB-së, çka shkaktoi një shitje masive të aseteve portugeze nga investitorët. Masat përfshijnë: ulje të pagave deri në 5% për nëpunësit me paga më të larta në sektorin publik; rritjen e TVSH-së me 1%; rritjen e tatimit mbi të ardhurat për personat me të ardhura më të larta se 150.000 euro; uljen e shpenzimeve ushtarake me rreth 40% deri në vitin 2013 etj.

1.2. ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET FINANCIARE NË BOTË

Stabilizimi dhe rikuperimi i tregjeve financiare ndërkombëtare, i nisur që gjatë vitit të kaluar dhe i mbështetur gjerësisht nga autoritetet monetare, vazhdoi më ritme të qëndrueshme në muajt e parë të vitit 2010. Normat e interesit vijuan rënien graduale pothuaj në të gjithë spektrin e maturimeve dhe vëllimi i aktivitetit u rrit ndjeshëm si në tregjet e parasë ashtu edhe në ato të letrave me vlerë të borxhit e të kapitalit. Kjo prirje ishte edhe më e dukshme në tregjet e vendeve në zhvillim.

Ecuria e sektorit bankar në botë gjatë tremujorit të parë të vitit 2010, ishte përgjithësisht pozitive duke shënuar hapa të rëndësishëm drejt përtëritjes financiare. Kthimi mbi kapitalin (ROE) dhe ai mbi aktivet (ROA) për grupet e mëdha dhe komplekse bankare (GMKB), arritën përkatësisht në nivelet 12.5% dhe 0.9%, krahasuar me 6% dhe 0.3% në fund të vitit 2009[21].

Kjo ecuri reflektoi përmirësimin e përgjithshëm të klimës ekonomike si edhe zbatimin e politikave monetare tepër akomoduese në ekonomitë kryesore të botës[22]. Nxitur nga këto zhvillime pozitive, Rezerva Federale në SHBA dhe Banka Qendrore Evropiane komunikuan gatishmërinë për të filluar tërheqjen e masave mbështetëse të ndërmarra në momentet e krizës.

Grafik 2. Normat kryesore të tregut të parasë.



Burimi: BQE, Eurostat.

Grafik 3. Ecuria e *yield*-eve të obligacioneve qeveritare 10-vjeçare.



Burimi: Databaza e BQE.

[21] *Raporti i Stabilitetit Financiar të BQE-së, qershor 2010.*
[22] *Banka Qendrore Evropiane e mbajti normën bazë në nivelin 1%, Rezerva Federale në nivelin 0-0.25%, Banka e Anglisë në nivelin 0.5% dhe Banka Qendrore e Japonisë në 0.1%.*

Megjithatë, në fillim të tremujorit të dytë, qetësia relative në tregjet financiare u godit prej përkeqësimit të ndjeshëm të situatës fiskale në disa vende të Eurozonës, veçanërisht në Greqi. Rritja e rrezikut të kreditit në titujt e borxhit sovran, pati ndikim më të madh në tregun ndërbankar evropian ku transaksionet u pakësuan ndjeshëm për shkak të pasigurisë mbi ekspozimin e bankave në letrat me vlerë të borxhit të qeverive. Dyshimet mbi përmasat reale të këtij ekspozimi, u rritën në tregjet financiare dhe u shoqëruan me rënien dhe luhatshmërinë e vlerës së aksioneve të bankave evropiane dhe rritje të konsiderueshme të primeve për mbrojtjen ndaj rrezikut të kreditit të tyre (*Collateralized Debt Securities - CDS*). BQE-ja vlerësoi se kjo situatë mund të ndikonte negativisht në funksionimin e segmenteve të tjera të tregut financiar dhe të dëmtonte efektivitetin e politikës së saj monetare. Ndaj në datën 10 maj të vitit 2010, ajo ritheksoi vlefshmërinë e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë së Greqisë si kolateral në transaksionet e injektimit të likuiditetit në treg, pavarësisht rënies së cilësisë së tyre poshtë nivelit minimal, të pranuar më parë nga BQE-ja. Madje, BQE-ja ndërmori një hap të paprecedent duke vendosur të blejë drejtpërdrejt borxhin e qeverive të vendeve të Eurozonës, për të rivendosur në funksionim segmente të caktuara të tregjeve të tyre financiare. Për sa i takon operacioneve të tregut të hapur, BQE-ja iu rikthye injektimit të likuiditetit me normë interesi të fiksuar në ankandet e radhës, si edhe vendosi të riaktivizojë linjat e shkëmbimit të monedhave me Rezervën Federale të SHBA-së. Këto masa shoqëruan masat e marra nga Komisioni Evropian dhe FMN-ja për të ndihmuar Greqinë dhe ndikuan në rënien e tensionit në tregjet e parasë. Megjithatë, bankat e Eurozonës vazhdojnë të kenë kërkesa të larta për likuiditet dhe të vendosin fondet në instrumentet lehtësuese të BQE-së. Njëkohësisht besimi i investitorëve vijoi të ishte i lëkundur. Preferenca e tyre për aktive me nivel të lartë të sigurisë, solli rritjen e kërkesës për ar dhe për letra me vlerë të borxhit të qeverive të SHBA-së e të Gjermanisë. Në të njëjtën kohë, tregjet e aksioneve pësuan rënie të ndjeshme gjatë kësaj periudhe.

Grafik 4. Ecuria e indekseve kryesore të tregut të aksioneve.



Burimi: Databaza e BQE.

Shtrëngimi i kushteve në tregun ndërbankar dhe në atë të titujve të borxhit shtetëror, si edhe rritja e pamjaftueshme ekonomike, kanë vënë në dyshim dobinë e tërheqjes të masave stimuluese monetare e fiskale, të vëna në përdorim nga autoritetet publike disa muaj më parë. Tregjet financiare presin nga bankat kryesore qendrore të mbajnë një politikë monetare tepër akomoduese për një kohë më të gjatë.

Në tregjet e kredisë, përmirësimi i situatës së përgjithshme ekonomike në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, u shoqërua me një rënie të kostos të financimeve dhe akses më të gjerë në financim. Në tregun amerikan, vëllimi i emetimeve të reja të sektorit privat u rrit dhe kostoja shtesë e borxhit të korporatave ndaj borxhit sovran, u ngushtua. Edhe në tregun evropian, kushtet më të mira të likuiditetit dhe rënia e kostos së financimit, krijuan

kushte më të mira për zgjatjen e afatit të emetimit të borxhit për korporatat. Megjithatë, ritmi i rritjes të emetimeve ka ardhur në rënie, veçanërisht për korporatat financiare. Në tregjet e obligacioneve të mbuluara me kolateral, të Eurozonës, niveli i emetimit ishte mjaft i lartë, veçanërisht në katër muajt e parë të vitit, duke tejkaluar ndjeshëm vëllimet e një viti më parë. Maturimi i obligacioneve të reja të emetuara, gjithashtu erdhi duke u rritur, duke reflektuar përmirësimin e kushteve të financimit në tregjet financiare. Gjithsesi, këto zhvillime pozitive u mbështetën gjerësisht dhe nga programi i Eurosistemit për blerjen e obligacioneve të mbuluara. Për sa i përket tregjeve të produkteve të strukturuara, pavarësisht një përmirësimi të lehtë gjatë tremujorit të parë të vitit 2010, aktiviteti i tyre mbeti i ndrydhur si në SHBA dhe në Evropë. Në tregjet amerikane të produkteve të mbështetura në kredi hipotekare, aktiviteti ishte i dobët për shkak të çmimeve ende të ulëta në tregun e shtëpive dhe të normës së lartë të mosshlyerjes të detyrimeve lidhur me këto produkte. Rezerva Federale ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm në funksionimin e tregjeve amerikane të kredisë, veçanërisht në atë të letrave me vlerë të borxhit të mbështetura mbi huatë hipotekare.

Grafik 5. Ecuria e kursit të këmbimit të euros kundrejt monedhave kryesore.



Burimi: Eurostat.

Në tregjet e shkëmbimit të valutave, euro është dobësuar në këmbimin e saj me dollarin amerikan dhe me jenin japonez. Në mes të muajit maj të vitit 2010, shqetësimet për situatën fiskale në Eurozonë, e zbritën kursin e këmbimit euro/dollar në nivelin më të ulët të 4 viteve të fundit, pranë nivelit 1.20 dollarë për euro, me një zhvlerësim prej rreth 14% ndaj mesatares së vitit 2009. Nga ana tjetër, është dobësuar në mënyrë graduale por të qëndrueshme në këmbimin me jenin japonez. Rritja e shpejtë e ekonomisë kineze, ka rritur shqetësimin e autoriteteve për efektet inflacioniste në vend dhe ka bërë të nevojshme një politikë më aktive në kontrollin e kërkesës së brendshme. Për këtë arsye, në qershor të vitit 2010, autoritetet kineze deklaruan se do të lejojnë lëvizjen e lirë të monedhës së tyre, pas "lidhjes" së saj në nivelin 1 dollar = 6.83 huan, gjatë 23 muajve pararendës. Sidoqoftë, autoritetet kineze kanë bërë të qartë se çdo vlerësim i mundshëm i monedhës kineze do të jetë tepër gradual.

Grafik 6. Ecuria e indekseve të çmimeve të lëndëve të para kryesore.



Burimi: Databaza e FMN.

Në tregjet e lëndëve të para, është vënë re një qëndrueshmëri në ecurinë e çmimeve, mbështetur në një ecuri më të mirë të ekonomisë botërore. Kërkesa e qëndrueshme e vendeve në zhvillim, është përballur me një fleksibilitet më të lartë të ofertës, në kushtet e politikave mbështetëse eksportuese.

Parashikimi afatshkurtër për ecurinë e tregjeve të lëndëve të para do të varet shumë nga shpejtësia

dhe qëndrueshmëria e rigjallërimit të ekonomisë globale. Rritja e aktivitetit ekonomik global pritet të mbajë kërkesën në nivele të larta, çka do të ndikojë pozitivisht çmimet e naftës dhe të lëndëve të tjera të para. Gjithsesi, këto presione pritet të zbuten nga niveli i lartë i kapaciteteve të pashfrytëzuara dhe nga rritja e ofertës në përshtatje me kërkesën dhe rritjen e çmimeve.

Hapësirë informuese 2. Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri

1. RAIFFEISEN INTERNATIONAL (AUSTRI)[1]

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Raiffeisen International kishte një total aktivesh prej 78.1 miliardë eurosh, në rritje me 2.4% kundrejt fundit të vitit 2009. Depozitat e klientëve, në vlerën 43.26 miliardë euro, u rritën me 1.6% krahasuar me nivelin e fundvitit të kaluar. Kreditë për klientët u rritën me 4% ose 1.9 miliardë euro. Raporti kredi/depozita u rrit me 2 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2009, duke arritur në 121%. Raporti i kredive me probleme ndaj kredidhënies totale (kredi dhe paradhënie, letra me vlerë dhe zëra jashtë bilancit) ishte 6.0% (nga 5.1% në fund të vitit 2009).

Fitimi neto i konsoliduar, i raportuar për gjashtëmujorin e parë, ishte 171 milionë euro ose 118.6% më i lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shpenzimet për provigjone u pakësuan me 42% ose 409 milionë euro, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, duke arritur në 560 milionë euro.

Kthimi nga kapitali aksioner, përpara taksave, u rrit me 3.7 pikë përqindje kundrejt së njëjtës periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 8.6%. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të Raiffeisen International, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ishte 16.1%, kundrejt 16.3% në fund të vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Raiffeisen në Shqipëri përbënte rreth 2.5% të totalit të aktiveve të Raiffeisen International.

Të gjitha informacionet e mëposhtme janë marrë nga faqet e internetit të grupeve përkatëse bankare.

[1] *Burimi: www.ri.co.at "Raporti i gjashtëmujorit të parë, 30 qershor 2010".*

2. INTESA SANPAOLO (ITALI)[2]

Intesa Sanpaolo e mbylli gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 me një total aktivesh prej rreth 655 miliardë euro, në rritje me 4.6% kundrejt fundit të vitit 2009. Kreditë për klientët regjistruan vlerën 374.8 miliardë euro, në rënie me 0.2% kundrejt fundit të vitit 2009, ndërsa depozitat e klientëve shënuan vlerën 436.5 miliardë euro, në rritje me 3.3% në krahasim me fundin e vitit 2009.

Fitimi neto në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 ishte rreth 1.69 miliardë euro, krahasuar me 1.59 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2009 (+6.4%). Provigjonet dhe shpenzimet për zhvlerësime arritën në rreth 1.47 miliardë euro, duke qenë 17.9% më të ulëta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, kthimi nga kapitali aksioner mesatar ishte 4.9% (kundrejt 5.2% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009).

Ndërkohë, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit u llogarit në 12.2% nga 11.8% në fund të vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri përbënte 0.1% të totalit të aktiveve të grupit Intesa Sanpaolo.

[2] *Burimi:www.group.intesasanpaolo.com "Informacioni për shtyp – Intesa Sanpaolo, Rezultatet e konsoliduara në muajin qershor të vitit 2010".*

3. BANKA ALFA (GREQI)[3]

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Alfa raportoi një total aktivesh prej 68.0 miliardë euro ose 8.1% më pak se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Depozitat pranë kësaj banke u pakësuan me 7.4% kundrejt një viti më parë, duke arritur në rreth 39.7 miliardë euro në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010. Depozitat në Greqi u pakësuan me 8.9%, ndërsa ato në Evropën Juglindore patën rritje prej 1.0% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Kreditë e akorduara ishin 53.3 miliardë euro (në rritje me 2.0% kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë). Kreditë në Greqi shënuan rritje vjetore prej 2.6%, ndërsa ato në Evropën Juglindore një rritje vjetore prej 3.7%.

Humbjet nga kreditë ishin 421.3 milionë euro (me një rritje vjetore 28.9%), nga të cilat 95.6 milionë i takonin aktivitetit në Evropën Juglindore (shifër kjo 53.0% më e lartë se në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar). Në fund të gjashtëmujorit të parë, kreditë me probleme arritën në 6.9% të totalit të portofolit. Në rajonin e Ballkanit, ky raport ishte në nivelin 7.2%.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Alfa raportoi një fitim neto prej 38.2 milionë euro[6] (në rënie me 82.2% kundrejt së njëjtës periudhë të vitit të kaluar), si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në Greqi dhe në rajon, dhe të një tatimi të jashtëzakonshëm, që qeveria greke i vuri bankave, për fitimet e vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Alfa e kishte normën e mjaftueshmërisë së kapitalit 13.0%, kundrejt 13.3% në fund të vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Alfa, Shqipëri (degë), përbënte rreth 0.7% të totalit të aktiveve të Bankës Alfa (Greqi).

[3] *www.alpha.gr/page/ "Deklarata për shtyp mbi rezultatet e tremujorit të dytë të vitit 2010".*

[6] *Në rast se nuk do të merrej parasysh një tatim i jashtëzakonshëm, që qeveria greke i vuri bankave mbi fitimet e vitit 2009, gjashtëmujori i parë do të ishte mbyllur me një fitim neto prej 100.2 milionë eurosh.*

4. PIRAEUS BANK (GREQI)[4]

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Piraeus kishte aktive prej rreth 56.6 miliardë eurosh, në rritje me 5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009. Kreditë neto ishin rreth 38.5 miliardë euro, në rritje me 3% kundrejt një viti më parë, ndërsa depozitat ishin 29.7 miliardë euro, në rënie me 7% kundrejt një viti më parë.

Fitimi neto për gjashtëmujorin, 10 milionë euro, shënoi rënie të ndjeshme me rreth 92% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, si pasojë e rritjes së konsiderueshme vjetore të provigjoneve me rreth 30%. Treguesi i kthimit nga kapitali

aksioner mesatar, në tremujorin e dytë të vitit, ishte rreth 0.4%, në rënie nga shifra 0.9%, e tremujorit të parë. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit vlerësohet 9.7%, e qëndrueshme që nga fundi i vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, totali i aktiveve të Bankës Tirana përbënte rreth 1.1% të atyre të Bankës Piraeus.[7]

[7] *Burimi: www.piraeusbank.gr/. "Rezultatet e gjashtëmujorit të parë të vitit 2010".*

5. BANKA KOMBËTARE E GREQISË (GREQI)[5]

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, totali i aktiveve të grupit BKG ishte rreth 122.1 miliardë euro, me një rritje prej 10% kundrejt së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Kredidhënia totale në Evropën Juglindore arriti në 7.8 miliardë euro, duke shfaqur një rënie të vogël, 4%, kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2009. Në këtë rajon, depozitat u rritën me 4%, në nivelin 4.5 miliardë euro.

Fitimi neto i grupit për këtë gjashtëmujor arriti në 146 milionë euro, në rënie me 79% kundrejt një viti më parë. Greqia kontribuoi me humbje (-159 milionë euro) në këtë rezultat, ndërsa ndikoi pozitivisht Evropa Juglindore e Qipro (fitim prej 54 milionë euro, në rënie me 16% kundrejt gjashtëmujorit të parë 2009). Mbi fitimin ndikuan negativisht tatimi i jashtëzakonshëm, humbjet nga vlerësimi sipas tregut i portofolit të obligacioneve qeveritare greke si dhe provigjonet e larta. Ndërkohë, të ardhurat kryesore të grupit (përpara taksave, provigjoneve dhe aktivitetit tregtues të letrave me vlerë) shfaqën rritje vjetore me 4%. Me gjithë provigjonet e larta dhe efektet e krizës, grupi vazhdoi të raportonte fitim në të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Fitimi neto në këtë rajon arriti në 50 milionë euro, me një rënie vjetore 11%.

Norma e mjaftueshmërisë së grupit BKG, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ishte 10.5%, kundrejt 11.3% në fund të vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Kombëtare e Greqisë – Shqipëri, (degë), përbënte rreth 0.3% të totalit të aktiveve të grupit BKG.

[5] *Burimi: www.nbg.gr/ Deklarata për shtyp "Rezultatet e tremujorit të dytë të vitit 2010 për grupin NBG" si dhe të dhëna të tjera financiare të publikuara.*

6. SOCIÉTÉ GÉNÉRALE (FRANCË)[6]

Në fund të gjashtëmujorit të parë 2010, Société Générale kishte një total aktivesh prej 1 133.7 miliardë euro, në rritje me 11% nga fundi i vitit. Kreditë për klientët ishin 362.7 miliardë euro, në rritje me 5% nga fundi i vitit. Gjithashtu edhe depozitat e klientëve regjistruan rritje me 5% kundrejt fundit të vitit 2009, duke arritur në nivelin 316.4 miliardë euro në fund të gjashtëmujorit.

Grupi Société Générale e mbylli gjashtëmujorin e parë të vitit me një fitim neto prej rreth 2.15 miliardë euro (nga 31 milionë euro për gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar). Treguesi i kthimit nga kapitali aksioner pas taksave për grupin ishte 11.0%.

Kontributi i rrjetit ndërkombëtar në fitimin neto të grupit ishte 239 milionë euro në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 (në rënie me 3.2% kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2009), me një RoE 13.2%.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, norma e modifikuar e mjaftueshmërisë së grupit ishte 10.7%, e pandryshuar, krahasuar me fundin e vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Popullore (aktualisht Société Générale – Albania), përbënte rreth 0.03% të totalit të aktiveve të grupit Société Générale.

[6] *Burimi www.societegenerale.com/ Deklarata për shtyp "Informacioni financiar për tremujorin e dytë të vitit 2010".*

7. CREDIT AGRICOLE (FRANCË) dhe EMPORIKI (GREQI)[7]
Grupi Crédit Agricole kishte në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 një total aktivesh prej 1,900.6 miliardë euro, në rritje me 12.2% kundrejt fundit të vitit 2009. Në fund të gjashtëmujorit të parë, kreditë ishin në vlerën 877.2 miliardë euro (me një rritje prej 8.3% kundrejt fundit të vitit të kaluar), ndërsa depozitat 748.9 miliardë euro (me një rritje prej 8.6% kundrejt fundit të vitit të kaluar).

Fitimi neto i grupit, për gjashtëmujorin e parë, ishte 849 milionë euro, rreth 2 herë më shumë krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit, shpenzimet e lidhura me rrezikun arritën në 569 milionë euro, me një rritje prej 58.1% në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, si reflektim i zhvillimeve në ekonominë greke. Ndërkohë, të ardhurat neto nga aktiviteti bankar u rritën me 8.7% kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, duke dhënë një kontribut me 364 milionë euro.

Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të grupit Credit Agricole, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ishte 13.1%, kundrejt 12.8% në fund të vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, Banka Emporiki në Shqipëri përbënte rreth 0.01% të totalit të aktiveve të grupit Crédit Agricole.

[7] *Burimi: www.credit-agricole.fr "Raporti Financiar më 30 qershor të vitit 2010".*

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2010

Pas një rritjeje ekonomike negative në tremujorin e katërt të vitit 2009, rritja prej 2% në tremujorin e parë të vitit 2010 dhe treguesit e sektorit real sugjerojnë se ekonomia shqiptare ka patur një ecuri pozitive gjatë gjysmës së parë të vitit. Gatë kësaj periudhe është konstatuar një ecuri e moderuar e inflacionit, qëndrueshmëri e kursit të këmbimit, rritje e investimeve të huaja dhe një korrektim i rëndësishëm i pozicionit të tregtisë me jashtë. Rritja më e ngadaltë e pagave dhe e treguesve të punësimit, rënia e remitancave dhe kushtet ende të vështira të financimit kanë ndikuar negativisht mbi ecurinë e konsumit privat. Politika fiskale ka qenë më e shtrënguar, në përputhje me objektivin për të ulur deficitin buxhetor të vitit.

Përmirësimi i likuiditetit në sektorin bankar, i treguar nga rritja e depozitave, ka ofruar kushte më të mira për mbështetjen e investimeve private. Megjithatë, shfrytëzimi i ulët i kapaciteteve nga ana e firmave, nuk ka mbështetur rritjen e kërkesës për investime nga sektori privat. Nga ana tjetër, kosto e financimit të sektorit bankar mbetet relativisht e lartë. Rritja e importit të mjeteve kapitale nga subjektet private si edhe një interesim më i madh i bizneseve pranë bankave, mbështesin pritshmëritë për një rigjallërim gradual të kërkesës për kredi nga ana e sektorit privat.

Kontributi i sektorit publik në kërkesën agregate ka vijuar të jetë pozitiv, por shumë më pak i rëndësishëm se vitin e kaluar. Politika fiskale ka qenë më e kujdesshme ndaj treguesve të borxhit, gjë e cila vlerësohet pozitive për perceptimin e primit të rrezikut në vend. Deficiti buxhetor në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 u ul me 36% në krahasim me një vit më parë. Ndikimin më të madh në këtë ecuri e dha rënia e shpenzimeve buxhetore, pasi rritja e të ardhurave ishte në nivele më të ulëta sesa parashikimi. Në drejtim të financimit të deficitit buxhetor, ka patur një kërkesë të lartë të pjesëmarrësve të tregut për letra me vlerë të borxhit të qeverisë.

Në pozicionin e tregtisë me jashtë, gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 u vu re një korrektim i rëndësishëm i deficitit tregtar, ku në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë eksportet u rritën me 14%, ndërsa importet ranë me 3%. Si rezultat, deficiti tregtar i gjashtëmujorit u ngushtua me 19% nga fundi i gjashtëmujorit të parë të vitit 2009 dhe me 12% në krahasim me fundin e vitit 2009.

Sigurimi i qëndrueshmërisë në kohë të përmirësimit të eksporteve, kërkon politika publike mbështetëse dhe fiton rëndësi në kushtet kur burimet e financimit të deficitit tregtar dhe të llogarisë korente janë relativisht të paqëndrueshme. Në fakt, dërgesat e emigrantëve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 rezultuan

me një rënie prej 7.3% në terma vjetorë. Duke i konsideruar treguesit e dobët të tregut të punës në vendet e Eurozonës dhe situatën kritike në Greqi, fluksi i dërgesave të emigrantëve në të ardhmen mund të jetë i paqëndrueshëm. Nga ana tjetër, pririja pozitive e zhvillimit të turizmit, përfaqëson një faktor mbështetës për rritjen e burimeve të flukseve valutore në të ardhmen.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, presionet inflacioniste kanë qenë të kontrolluara dhe norma e inflacionit është luhatur brenda kufijve 2-4% të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Tregues kryesorë makroekonomikë.

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	G1_2010
Rritja reale vjetore e PBB në %	4.23	5.77	5.71	5.72	5.4	6	7.7	3.3	2*
PBB me çmime korente në milionë lekë	622,711	694,098	750,785	814,797	882,209	966,651	1,087,867	1,153,000	1,217,000**
Numri i të punësuarve (në mijë)	921	928	917	932	934	935	970	899	900***
Përqindja e papunësisë	15.8	15	14.6	14.2	13.8	13.4	12.6	13.75	13.83***
Përqindja e inflacionit (v/v)	1.7	3.3	2.2	2	2.5	2.9	3.4	3.5	3.2
Deficiti i buxhetit (me grantet, në % të PBB-së)	-6.6	-4.5	-5.1	-3.6	-3.1	-3.5	-5.7	-7	-1.7****
Borxhi publik (në % të PBB-së)	65.3	61.7	56.6	56.7	55.9	52.2	55.9	59.6**	57.8**
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së)	23.5	20.6	18	17.5	17.2	14.4	18.3	23.38**	23. 6**
Kursi mesatar i këmbimit, lekë/dollarë	140.1	121.9	102.8	99.8	98.1	90.4	83.9	95.0	104.25
Kursi mesatar i këmbimit, lekë/euro	132.4	137.5	127.7	124.2	123.1	123.6	122.8	132.1	137.99

** Rritja e tremujorit të parë të vitit 2010*
*** FMN, korrik 2010*
****Tremujori i parë 2010*
*****Deficiti kumulativ i gjashtëmujorit ndaj PBB vjetore*
Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, FMN.

2.1. ECURIA E EKONOMISË DHE E BIZNESEVE

Rritja reale vjetore e ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2010 arriti në 2%, ndërsa krahasuar me një tremujor më parë rritja ishte 1.8%. Për shkak të kërkesës së lartë për eksporte të lëndëve të para, sektori i industrisë pati rritjen më të lartë prej 27.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sektori i ndërtimit u tkurr me 21.1% në terma vjetorë. Rënia e kontributit të këtij sektori krahas uljes së investimeve në pasuri të patundshme nga ana e familjeve dhe firmave, dhe rënies së kredisë për këtë qëllim reflekton dhe tkurrjen e shpenzimeve publike në këtë sektor. Sektori i shërbimeve, i cili ka peshën më të madhe në prodhimin e brendshëm, u rrit me 3.4% në tremujorin e parë të vitit 2010, duke vijuar ngadalësimin e shfaqur në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009.

Tabelë 5. Produkti i Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik, ndryshimet vjetore në përqindje.

	T1-08	T2-08	T3-08	T4-08	T1-09	T2-09	T3-09	T4-09	T1-10
Bujqësia, blegtoria, gjuetia dhe pyjet	8.2	7.2	6.6	7.4	2.8	2.9	2.7	1.7	2.3
Industria	-12	2.4	14.3	20.8	3.2	-0.7	-7.1	-3.6	27.5
Ndërtimi	9.3	22.6	18.6	-1.4	0.3	19.2	0.7	-15	-21.1
Tregti, hotele dhe restorante	13	7.4	8.7	3	2.1	3.6	6.7	6.9	4.8
Transporti	2	-10.6	-10	5.1	-1	12.8	19	2.9	11.4
Posta dhe komunikacioni	6.5	18.4	17.3	31.5	54.4	26	36.6	10.6	1
Shërbime të tjera	18.5	8.3	4.9	-4.7	0.8	3.3	-0.2	1.4	1.7
Totali i vlerës së shtuar	9.3	8.4	8.6	3.6	3.9	6.7	4.2	-0.3	2
FISIM	9.4	1.5	1.5	6.7	10.5	14.8	14	10.6	0.1
Vlera e shtuar bruto me çmimet bazë	9.3	8.7	8.9	3.5	3.6	6.4	3.8	-0.7	2

Burimi: INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto Tremujor, Korrik 2010.

Tabelë 6. Produkti i Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik, ndryshimet tremujore në përqindje.

	T1-08	T2-08	T3-08	T4-08	T1-09	T2-09	T3-09	T4-09	T1-10
Bujqësia, blegtoria, gjuetia dhe pyjet	2.3	1.9	0.8	2	0.4	-0.2	0.6	0.8	0.9
Industria	6.8	11.6	3	-1.5	-8.3	6.5	-3.6	2.6	19.9
Ndërtimi	2.3	-7.3	3.2	1.7	3.4	8.6	-12	-13.4	-4.3
Tregti, hotele dhe restorante	2.8	0.3	1.3	0	1.7	1.4	1.9	1.1	0.4
Transporti	6	-8.2	-1.1	9.3	-2.2	6.6	4.2	-4.2	3.5
Posta dhe komunikacioni	-15.2	19	10.2	18.2	-0.4	-2.9	19.5	-4.3	-9
Shërbime të tjera	2.7	-4.8	1.3	-2.9	4.1	-0.6	0.9	-0.1	1.4
Totali i vlerës së shtuar	2.2	-0.7	2	1.2	1	2.2	-0.3	-1.9	1.4
FISIM	-0.9	-2.1	2.9	6.9	2.6	1.7	2.2	3.8	-7.2
Vlera e shtuar bruto me çmimet bazë	2.3	-0.6	1.9	0.9	1	2.2	-0.4	-2.2	1.8

Burimi: INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto Tremujor, Korrik 2010.

Gjithashtu, indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit për tremujorin e parë të vitit 2010, shënoi vlerën 153.2%, kundrejt tremujorit bazë (2005=100), duke patur një rritje prej 7.7% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2009 dhe një ulje prej 3.0% krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Sipas përbërësve të indeksit, konfirmohet një ecuri e mirë në sektorët e industrisë nxjerrëse, të energjisë, dhe të tregtisë dhe një ecuri e dobët në sektorin e ndërtimit.

Tabelë 7. Indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit (2005=100).

Indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit	I-08	II-08	III-08	IV-08	I-09	II-09	III-09	IV-09	I-10
Prodhim dhe shërbime	111.8	119.1	136.2	146	142.2	145.9	157.9	157.9	153.2
Prodhim (industri dhe ndërtim)	113.5	137.4	146	158.9	157.1	179.6	180.6	186.4	172.3
Industria	112.4	130.3	133.3	127.5	132.9	135.5	144.7	153.6	165.2
Industria nxjerrëse	117.6	177.3	147.3	109.5	87.5	128	154.7	143.8	170.1
Industria përpunuese	109.7	132.1	138.8	131	131.4	140.3	144.7	151.4	149.2
Energji elektrike, gaz, ujë	115.1	109	110.7	119.1	148.7	121.4	132.9		
Ndërtimi	114.8	146.8	162.8	201	193.8	250.6	237.1	237.2	163.2
Shërbime	110.1	109.1	130.8	138.9	134.1	128.3	145.8	142.9	142.6
-Tregti	110.6	108.5	129.2	141.5	129.8	121.8	138.4	137.7	137.6
-Transport,Komunikacion	111.1	110.7	138.8	126.5	143.6	144.4	171.7	163.6	157.4
-Hotele	103.1	114.1	142.9	108.6	82.3	110.8	131.5	104.6	80.8

Burimi: INSTAT, Koniuktura janar – mars 2010.

Grafik 7. Indeksi i shifrës së afarizmit.



Burimi: INSTAT, Koniuktura Janar – Mars 2010.

Për ecurinë e sektorit real të ekonomisë në tremujorin e dytë të vitit 2010, përdorim si përafrues treguesit e besimit dhe përbërësit e tij. Rezulton që treguesi i tendencës ekonomike shfaq shenja përmirësimi në tremujorin e dytë të vitit 2010, duke arritur nivelin 102.3 (rritje me 8.4 pikë përqindjeje në krahasim me tremujorin e kaluar). Treguesi është ngjitur mbi mesataren e tij afatgjatë për herë të parë që prej tremujorit të katërt të vitit 2008. Në secilin prej sektorëve të konsideruar, përkatësisht të industrisë, të ndërtimit, të shërbimeve dhe të konsumatorit, është konstatuar rritje e besimit të të anketuarve. Përbërësi i besimit të industrisë u rrit me rreth 1 pikë përqindje mbështetur nga vlerësimi më i mirë për punësimin dhe prodhimin industrial. Përbërësi i besimit të ndërtimit u rrit me 3.7 pikë përqindjeje, mbështetur nga një përmirësim relativ i kërkesës, prodhimit dhe punësimit. Përbërësi i besimit të shërbimeve u rrit me rreth 3.7 pikë përqindjeje, si rezultat i një vlerësimi më të mirë për ecurinë e ekonomisë, për situatën e punësimit dhe për atë financiare për bizneset e këtij sektori. Treguesi i besimit të konsumatorit, ndërpreu prirjen rënëse të nisur që prej tremujorit të dytë të vitit 2009, duke u rritur me rreth 6.3 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin paraardhës. Ndryshe nga dy përbërësit e tjerë të treguesit, përbërësi i besimit të shërbimeve dhe ai i besimit të konsumatorit, janë ngjitur mbi mesataren afatgjatë përkatëse. Në përgjigjet e tyre, të anketuarit kanë vlerësuar një gjendje më të mirë financiare në tremujorin e dytë të vitit. Për sa i takon vlerësimit të të anketuarve në sektorët e mësipërm, rreth pritjeve të zhvillimeve ekonomike në periudhën e ardhshme afatshkurtër, konstatohet që në sektorin e shërbimeve dhe atë të industrisë, pritjet e të anketuarve janë në rënie, ndërsa në sektorin e ndërtimit dhe në atë të konsumatorit treguesit vijnë në rritje. Sidoqoftë, me përjashtim të sektorit të shërbimeve, lëvizjet në sektorët e tjerë nuk janë të konsiderueshme.

Grafik 8. Treguesi i tendencës ekonomike.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 9. Treguesi i besimit të industrisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 10. Treguesi i besimit të shërbimeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 11. Treguesi i besimit të konsumatorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 12. Treguesi i besimit të ndërtimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2. MIRËQENIA E EKONOMIVE FAMILJARE

Për të vlerësuar mirëqenien e ekonomive familjare, analizojmë ecurinë e punësimit dhe të të ardhurave.

Për sa i takon nivelit të punësimit, ndryshimet në numrin e "të punësuarve në sektorin privat bujqësor", kanë kushtëzuar ndryshimet në numrin e "të punësuarve" dhe "të forcave të punës". Numri i "të punësuarve në sektorin privat jobujqësor", paraqitet i qëndrueshëm duke shënuar një rritje të lehtë. Sidoqoftë, numri i "të papunëve" është rritur me rreth 2.8% në krahasim me një vit më parë. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2010, norma e papunësisë rezulton 13.8%. Dinamika e treguesve të punësimit jepet në Tabelën 8 "Tregues të punësimit.

Tabelë 8. Tregues të punësimit.

		IV-07	I-08	II-08	III-08	IV-08	I-09	II-09	III-09	IV-09	I-10
Forcat e punës	nr.	1,082	1,080	1,079	1,110	1,116	1,114	1,114	1,114	1,043	1,045
Të punësuar	nr.	939	939	939	970	974	973	973	972	899	901
Në sektorin shtetëror	nr.	167	167	167	167	167	167	166	166	166	166
Në sektorin privat jobujqësor	nr.	230	231	231	235	239	238	238	237	237	238
Në sektorin privat bujqësia	nr.	542	542	542	569	569	569	569	569	496	496
Të papunë	nr.	143	141	140	140	141	141	141	142	143	145
Shkalla e papunësisë	%	13.2	13.04	12.97	12.62	12.68	12.68	12.7	12.76	13.75	13.83
Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror	lekë	36	36	36	36	38	39	40	42	42	42

Burimi: INSTAT.

Në lidhje me ecurinë e mundshme të punësimit në tremujorin e dytë të vitit 2010, i referohemi të dhënave të vrojtimit të besimit të bizneseve lidhur me nivelin e punësimit. Shifrat përgjithësisht sugjerojnë se në këtë periudhë, punësimi ka mbetur thuajse në nivelet e një tremujori më parë. Përjashtim këtu bën sektori i industrisë ku vihet re një rritje e punësimit. Nga ana tjetër, niveli i pritshëm i punësimit paraqitet më i dobët në sektorin e shërbimeve, siç duket i kushtëzuar nga faktorë sezonalë.

Grafik 13. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm, sektori i industrisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm, sektori i ndërtimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i takon të ardhurave nga puna, sipas INSTAT në tremujorin e parë të vitit 2010 paga mesatare mujore u rrit me një normë vjetore nominale prej 9.6% dhe në terma realë me 5.3%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ritmi i rritjes së pagës mesatare ka qenë lehtësisht më i lartë krahasuar me atë të vitit të kaluar. Ritmi i rritjes së pagës mesatare në sektorin shtetëror ka qenë më i ngadaltë, me 6.6% në terma nominalë dhe 2.4% në terma realë. Në sektorin e prodhimit, paga mesatare mujore u rrit me 5.4%, ndërsa në sektorin e shërbimeve rritja e pagës mesatare mujore arriti në 19.9%.

Grafik 15. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm, sektori i shërbimeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një tjetër burim i rëndësishëm i të ardhurave të familjeve janë dërgesat nga emigrantët. Në tremujorin e parë të vitit 2010, ato rezultuan 391.6 milionë euro, me një rënie rreth 7.3% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2009. Rënia e dërgesave nga emigrantët është ndikuar kryesisht nga kriza ekonomike botërore, që ka shkaktuar rritjen e papunësisë dhe ka detyruar qeveritë të shkurtojnë në mënyrë drastike shpenzimet/investimet publike, për të realizuar konsolidimin e nevojshëm fiskal. Situata nuk pritet të përmirësohet në mënyrë të ndjeshme në të ardhmen e afërt, veçanërisht në Greqi, ndaj të

Grafik 16. Treguesit e kursimit aktual dhe të pritshëm.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ardhurat nga dërgesat e emigrantëve do të jenë të paqëndrueshme.

Pasiguria në lidhje me qëndrueshmërinë e të ardhurave shfaqet edhe nga përgjigjet e vrojtimit të besimit të konsumatorëve, për fundin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2010. Sipas përgjigjeve, rezulton forcimi i prirjes së konsumatorëve për të rritur kursimet e tyre dhe për të shtyrë në kohë shpenzimet jo të domosdoshme. Për më tepër, zhvillimet në situatën e punësimit në gjashtëmujorin e ardhshëm vijojnë të vlerësohen negativisht nga konsumatorët. Megjithatë, balanca e përgjigjeve për këtë pyetje rezulton e përmirësuar me rreth 4.8 pikë përqindjeje në krahasim me tremujorin e parë të vitit.

2.3. ZHVILLIMET E BILANCIT TË PAGESAVE

Krahas informacionit që japin për aftësinë konkurruese të ekonomisë së vendit, zhvillimet në bilancin e pagesave, në një kuptim më të ngushtë, vlerësojnë qëndrueshmërinë e burimeve në valutë të ekonomisë së vendit dhe ndikimin e ecurisë së tyre përgjatë kohës në stabilitetin financiar.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, në terma vjetorë u shënua një korrektim i rëndësishëm i bilancit tregtar. Deficiti tregtar ra me 19%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 17. Eksportet sipas përbërjes.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga grafiku 17, rritja e lartë e eksporteve në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit, ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së eksporteve të "lëndë djegëse dhe energji", por edhe të një ecurie të qëndrueshme të grupeve "mallra të përpunuara", "mallra të tjera të përpunuara" dhe "materiale të papërpunuara", të cilat përfshijnë eksportet e mineraleve dhe ato të artikujve të veshmbathjes. Ecuria e mirë e këtyre eksporteve është favorizuar nga faktorë objektivë por të paqëndrueshëm që lidhen me kushtet e motit dhe koniukturën e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, të cilat kanë favorizuar rritjen e sasive të prodhimit[23] dhe të vlerës së këtyre eksporteve. Pavarësisht varësisë së konsiderueshme të ecurisë së eksporteve nga faktorë të jashtëm të pakontrollueshëm, është e rëndësishme të shfrytëzohet kjo situatë pozitive për të përmirësuar teknologjinë dhe kapacitetet

[23] *Sipas bilancit të energjisë elektrike të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 (INSTAT), eksporti i energjisë për këtë gjashtëmujor u rrit me 2.5 herë, krahasuar me eksportin e energjisë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.*

e prodhimit në sektorët që eksportojnë, duke përmirësuar administrimin e kostove dhe cilësinë e tyre gjatë kohës.

Në fund të gjashtëmujorit, vlera e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve mbuloi rreth 57% të vlerës së importeve. Gjatë vitit 2009, ky tregues luhatej rreth vlerës 48% dhe 57% përkatësisht në gjashtëmujorin e parë dhe të dytë të vitit. Rritja e përshpejtuar e vlerës së eksporteve të mallrave, me rreth 65% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, në kushtet e qëndrueshmërisë relative të vlerës së importeve, si edhe ecuria e mirë e shërbimeve, kanë ndikuar në përmirësimin e tepricës së llogarisë korente. Kjo regjistroi një deficit prej rreth 460 milionë euro, duke qenë rreth 35.5% më e ulët se vlera e regjistruar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009 dhe 28% më e ulët se ajo e gjashtëmujorit të parë të vitit 2009.

Rritja e eksporteve dhe ecuria e mirë e shërbimeve, ka kompensuar rënien e prurjeve neto valutore të llogarisë kapitale dhe asaj financiare. Këto shënuan vlerën 280.3 milionë euro, duke rënë me rreth 61% në krahasim me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rënies së transfertave kapitale dhe e flukseve financiare neto. Teprica pozitive e llogarisë kapitale dhe financiare, ka arritur të financojë vetëm 61% të deficitit të llogarisë korente në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, kundrejt 112% dhe 46% të saj përkatësisht në gjashtëmujorin e parë dhe të dytë të vitit 2009.

Fluksi i huamarrjes private dhe shtetërore nga jorezidentët gjatë këtij gjashtëmujori të vitit 2010 rezultoi 86.2 milionë euro ose rreth 58% më i ulët se e njëjta periudhë e një viti më parë. Me stabilizimin e gjendjes së likuiditetit në sektorin bankar, është pakësuar vlera e linjave të financimit dhe e depozitave të jorezidentëve në bankat vendase. Nga ana tjetër, rënia e ndjeshme e kredisë në valutë për sektorin privat është shoqëruar me rritjen e vendosjeve (hua/depozita afatshkurtra) të bankave tona pranë institucioneve financiare jorezidente. Në përgjithësi, kredia afatgjatë ka patur si destinacion kryesisht sektorin publik dhe sektorë të tjerë në formën e borxhit të garantuar nga qeveria.

Investimet e huaja direkte në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 arritën në 328.9 milionë euro, duke rënë me 23% në terma vjetorë por duke u rritur me 19% në krahasim me një gjashtëmujor më parë.

Dërgesat e emigrantëve kapën vlerën 391.6 milionë euro, duke qenë 7.3% më të ulëta në terma vjetorë. Kontributi i tyre në financimin e deficitit tregtar ka qenë rreth 42%.

2.4. ZHVILLIMET FISKALE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2010

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, politika fiskale ka qenë shumë më pak ekspansioniste në krahasim me të njëjtën periudhe të një viti më parë. Gjatë gjashtëmujorit, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit u rritën me

3.3%, ndërsa shpenzimet e përgjithshme ranë me rreth 4%. Në përgjithësi, të ardhurat dhe shpenzimet në buxhet u realizuan përkatësisht në masën 45% dhe 46% të nivelit vjetor të planifikuar. Prirja ngadalësuese e të ardhurave është reflektuar thuajse në të gjithë zërat hyrës. Të ardhurat nga ndihmat dhe ato tatimore kanë kontribuar pozitivisht në ecurinë e të ardhurave të përgjithshme, ndërsa të ardhurat jotatimore kanë shfaqur rënie. Në kahun e shpenzimeve, shpenzimet korente janë rritur me rreth 7%, ndërsa shpenzimet kapitale kanë shënuar një rënie të konsiderueshme, në masën 33.6%, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit paraardhës.

Ndryshimet në realizimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore, kanë diktuar nivelin e deficitit buxhetor, i cili në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 ishte rreth 21 miliardë lekë ose 36.4% më i ulët se në të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Sidoqoftë, mbështetur në objektivat për realizimin e deficitit buxhetor sipas rishikimit të buxhetit të vitit 2010, deficiti i realizuar në gjashtëmujorin e parë përfaqëson 55.2% të nivelit të planifikuar vjetor. Në këtë mënyrë, është e nevojshme të tregohet kujdes për realizimin e deficitit të planifikuar vjetor për pjesën e mbetur të vitit.

Tabelë 9. Treguesit kryesorë fiskalë.

	Qershor 2008	Qershor 2009	Qershor 2010	Ndryshimi vjetor në përqindje	
				Qershor 2009	Qershor 2010
Totali i të ardhurave	134,889	145,172	150,012	7.62	3.33
-Të ardhura nga ndihmat	521	1,196	1,853	129.56	54.93
-Të ardhura tatimore	124,085	131,795	136,731	6.21	3.75
-Të ardhura jotatimore	10,283	12,180	11,428	18.45	-6.17
Totali i shpenzimeve	138,298	178,243	171,038	28.88	-4.04
-Shpenzimet korente	107,766	129,606	138,778	20.27	7.08
-Shpenzime kapitale	28,016	48,552	32,261	73.30	-33.55
Deficiti buxhetor	-3,410	-33,071	-21,027	869.82	-36.42

Të dhënat në milionë lekë, progresive.
Burimi: Ministria e Financave.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, duke parë ecurinë e paqëndrueshme të të ardhurave, qeveria bëri publik objektivin për rishikimin e buxhetit, duke synuar korrigjimin në ulje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, si edhe një ulje të mëtejshme të deficitit buxhetor.

Tabelë 10. Rishikimi i buxhetit

(në milionë lekë)	Buxheti 2010 (26.11.2009)	Buxheti i rishikuar 2010 (26.07.2010)
Totali i të ardhurave	360,955	333,658
Totali i shpenzimeve	410,722	371,767

Burimi: Ministria e Financave.

Ky proces i nevojshëm i konsolidimit fiskal, do t'i shërbejë përmbushjes së objektivit afatmesëm për uljen e vlerës së borxhit publik deri në 54% të PBB-së në vitin 2013, sipas objektivave të Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal për vitet 2011-2013. Sipas rishikimit, rënia e shpenzimeve do të realizohet kryesisht nëpërmjet uljes së shpenzimeve kapitale, të cilat në vitin 2009 arritën deri në 8.8% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Duket se nevoja për

një konsolidim të shpejtë të pozicionit fiskal, ka kushtëzuar këtë zgjedhje. Në kushte të tjera, do të duhej të zgjidhej një nivel më i lartë i kontributit të shpenzimeve korente në shkurtimin e përgjithshëm të shpenzimeve të buxhetit. Edhe pas rishikimit të vlerave të buxhetit për vitin 2010, realizimi i deficitit buxhetor të planifikuar do të ndikohet ndjeshëm prej aftësisë për realizimin e të ardhurave.

Financimi i deficitit buxhetor në gjashtë muajt e parë të vitit 2010 është mbështetur nga financimi i brendshëm në masën 85% dhe nga ai i huaj në masën 15%, duke sjellë ndryshimet përkatëse në stokun e borxhit. Ndryshe nga vitet e mëparshme, në financimin e brendshëm që përbëhet kryesisht nga emetimi i letrave me vlerë të borxhit në lekë[24] (bono thesari dhe obligacione), të ardhurat nga privatizimi kanë zënë një pjesë mjaft të vogël, vetëm 0.4% duke reflektuar uljen e mundësive për privatizime të mëtejshme përgjatë kohës si edhe hezitimin e investitorëve.

Grafik 18. Përbërësit e borxhit publik.



Burimi: Ministria e Financave.

Stoku i borxhit të përgjithshëm publik përbëhet nga borxhi i brendshëm në masën 60% të totalit dhe pjesa tjetër përfaqëson borxhin e jashtëm.

Në lidhje me afatin e portofolit të borxhit të brendshëm, numri i ditëve mesatare deri në maturim, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ka rënë në 382 ditë nga 406 ditë në fund të vitit 2009. Gjatë kësaj periudhe është konstatuar një pjesëmarrje aktive e investitorëve në ankandet e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë, ku kërkesa ka qenë në nivele më të larta se oferta. Ky fenomen, si edhe përcjellja e efektit të lehtësimit të mëtejshëm të politikës monetare në tetor të vitit 2009, kanë sjellë rënien e normave të kthimit nga investimi në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë, duke ndikuar në uljen e kostos së borxhit dhe duke përmirësuar mundësitë për shërbimin e tij.

Në përcaktimin e objektivave për përbërjen e borxhit publik, krahas objektivit kryesor për të kontrolluar madhësinë dhe koston e shërbimit të borxhit, duhet të mbahen në konsideratë edhe faktorë të tjerë që lidhen me: a) qëndrueshmërinë e financimeve gjatë kohës; b) ruajtjen e hapësirave të financimit për nevojat e sektorit privat; c) rreziqet që rrjedhin nga dinamika e zhvillimeve ekonomike dhe ndikimin e tyre në likuiditetin e tregut, nivelin e normave të interesit dhe në kursin e këmbimit.

Rreziqet që lidhen me procesin e administrimit të borxhit, do të ishin më të kontrolluara nëse do të arrihej të ruhej besimi i publikut dhe i investitorëve për

[24] *Për shkak të vendimit për të shtyrë në kohë emetimin e borxhit në valutë për tregun ndërkombëtar, si edhe për të aksesuar më mirë burimet në valutë në tregun e brendshëm, në muajin qershor qeveria emetoi një bono thesari në valutë për vlerën 25 milionë euro, me maturim 9-mujor.*

një politikë fiskale të qëndrueshme në afat të gjatë. Kjo mund të realizohej nëpërmjet dhënies të garancive më të forta ligjore, më të kontrollueshme dhe më transparente, si pjesë e procesit që ndryshe njihet si "përcaktimi i rregullit fiskal". Një proces i tillë, do të mundësonte edhe një harmonizim më të mirë mes politikës fiskale dhe asaj monetare, me synim ruajtjen e treguesve makroekonomikë dhe sigurimin e stabilitetit financiar. Për këto arsye, Banka e Shqipërisë ka shprehur publikisht mbështetjen e saj lidhur me nevojën për përcaktimin e rregullit fiskal sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, në një kohë sa më të shpejtë.

3. TREGJET E BRENDSHME

3.1. TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Për të vlerësuar ecurinë e tregut të pasurive të paluajtshme, si tregues përafrues merret indeksi i çmimit të banesave, i llogaritur për qytetin e Tiranës. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, ky indeks ka pësuar një rënie të lehtë me rreth 1.4% ndaj gjashtëmujorit paraardhës, pas një rritjeje graduale por të qëndrueshme gjatë vitit 2009. Sidoqoftë, indeksi vijon të jetë rreth 7.7% më i lartë në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Ecuria e indeksit të çmimeve të banesave në qytetin e Tiranës, reflekton një situatë të brishtë me të cilën po ndeshet sektori i ndërtimit, në kushtet e rënies të vëllimeve të aktivitetit dhe të një kërkese më të dobët.

Sipas indeksit të vëllimit të shifrës së afarizmit (INSTAT, koniuktura janar-mars 2010), vlerësohet që aktiviteti në sektorin e ndërtimit ka rënë me rreth 18.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga ana tjetër, kërkesa për pasuri të paluajtshme ka qenë më e dobët, për shkak të tkurrjes së financimit të sektorit bankar si pasojë e politikave më të shtrënguara të kredidhënies në tërësi, luhatshmërisë së kursit të këmbimit dhe pritjeve më pesimiste të individëve për gjendjen e tyre financiare.

Grafik 19. Indeksi i çmimeve të banesave për kryeqytetin.



Burimi : Banka e Shqipërisë.

Grafik 20. Pesha e kredisë për prona të patundshme ndaj tepricës së kredisë, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2. TREGJET FINANCIARE

Tregu financiar shqiptar dominohet nga veprimet e tregut ndërbankar, të tregut të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë dhe të tregut të këmbimeve valutore. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, situata e likuiditetit në këto tregje shfaqet përgjithësisht e përmirësuar në krahasim me vitin 2009.

Grafik 21. Volumi dhe yield-et në tregun ndërbankar në milionë ALL.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Vëllimi i kërkesës dhe i ofertës së bonove në ankande.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 23. Raporti bid-to cover.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2.1. TREGU NDËRBANKAR

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, vëllimi i tregut ndërbankar është rritur me 5.8% në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm, por ka rezultuar rreth 4.7% më i ulët se e njëjta periudhë e vitit 2009. Për të njëjtën periudhë, norma mesatare e ponderuar e interesit ka rënë nga 4.97% nga 5.13%. Kostoja më e ulët e huasë ndërbankare, reflekton uljen e normës bazë të politikës monetare në tremujorin e katërt të vitit 2009, si edhe përmirësimin e likuiditetit strukturor të sektorit bankar në kushtet e rritjes së qëndrueshme të depozitave.

3.2.2. TREGU PARËSOR I TITUJVE

Ky treg përfaqëson veprimet e kryera nga pjesëmarrësit në ankandet e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, kërkesa e pjesëmarrësve në ankandet e bonove të thesarit të qeverisë ka qenë gjithnjë më e lartë se oferta dhe është luhatur në varësi të saj.

Kjo ecuri ka reflektuar kushtet e bollshme të likuiditetit, kryesisht të sektorit bankar, si edhe rënien e ofertës të bonove të thesarit të qeverisë në kushtet e uljes së deficitit buxhetor dhe nevojës më të ulët për financimin e tij me burime të brendshme.

Ecuria e normës së interesit (*yield*-it) të bonove të thesarit në tregun parësor, ka vijuar prirjen rënëse që filloi në muajin nëntor të vitit 2009, si reagim ndaj lehtësimit të politikës monetare. Në grafikun 24 paraqitet ecuria e vëllimit dhe *yield*-it mesatar të ponderuar të bonove të thesarit, që prej muajit janar të vitit 2008.

Rënia më e theksuar në *yield*-et e bonove të thesarit është vërejtur për ato me maturim 12-mujor, duke ndikuar në të njëjtën mënyrë edhe *yield*-et e obligacioneve të parametruar me këtë tregues. Në fund të muajit qershor të vitit 2010, interesi i bonove të thesarit me maturim 12-mujor zbriti në vlerën 7.9%, nga 9.4% që ishte në muajin tetor të vitit 2009. Ecuri në rënie kanë patur edhe *yield*-et për maturitetet e tjera të bonove të thesarit, por masa e ndryshimit ka qenë më e ulët. Rënia e ndjeshme e bonove të thesarit me maturim 12-

mujor, ka reflektuar synimin e pjesëmarrësve të tregut parësor për të "kapur" një kthim më të lartë nga investimi, në kushtet e pritjeve për një rënie të *yield*-it si rezultat i kushteve të mira të likuiditetit dhe rënies së ofertës të emetimeve nga ana e qeverisë.

Grafik 24. Vëllimi dhe *yield*-et e bonove në tregun primar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregu parësor i obligacioneve ka shfaqur të njëjtën prirje me atë të bonove të thesarit. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ka vijuar ulja e *yield*-eve në obligacionet me maturim 2 dhe 5-vjeçar, ndërkohë që ndryshimi i *yield*-it për obligacionet me maturim 3-vjeçar ka qenë i papërfillshëm. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, raporti bid-to-cover në ankandet e obligacioneve ka qenë mesatarisht 1.2. Në këtë analizë, duhet patur në konsideratë fakti që frekuenca dhe sasia e emetimit të obligacioneve me maturim 3 dhe 5-vjeçar është më e ulët se ajo e letrave të tjera me vlerë të borxhit të qeverisë.

Grafik 25. Vëllimet dhe *Yield*-et e obligacioneve në tregun parësor.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Kurba e *Yield*-eve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjerrësia e kurbës se *yield*-eve të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë ka vijuar të jetë normale, ku letrat me afat më të shkurtër maturimi ofrojnë edhe normën më të ulët të kthimit.

3.2.3. TREGU DYTËSOR I TITUJVE

Ky treg përfshin të gjitha transaksionet e shitblerjeve të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë, praktikisht vetëm të bonove të thesarit, që nuk kryhen në tregun parësor. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, në tregun dytësor të titujve janë kryer transaksione në vlerën 5.4 miliardë lekë. Kjo vlerë është më e ulët sesa ajo e gjashtëmujorit të parë dhe të dytë të vitit 2009, kur vëllimi i transaksioneve në tregun dytësor kishte përkatësisht vlerën 6.7 dhe 16.7 miliardë lekë. Ky treg karakterizohet nga vlera përgjithësisht të ulëta dhe të luhatshme të tregtimit. Për këtë arsye, rënia e tregtimeve në gjashtëmujorin e parë përfaqëson një kthim drejt vëllimeve më normale të tregtimit si rezultat i një kërkese më të ulët nga ana e individëve.

Grafik 27. Vëllimi i tregtimit të bonove në tregun sekondar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2.4. TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, euro është nënçmuar me 1% kundrejt lekut, ndërsa dollari amerikan dhe paundi britanik janë mbiçmuar përkatësisht, 16.6 dhe 9.4%. Shkëmbimi i lekut në raport me valutat e mësipërme, ka reflektuar kryesisht ecurinë e tyre në tregjet ndërkombëtare,

ku dollari amerikan dhe paundi britanik janë forcuar në këmbimin me euron. Në fund të muajit qershor, euro u këmbye me 136.5 lekë, nga 137.8 lekë që këmbehej në fillim të muajit janar. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ka pasur rënie të presioneve nënçmuese ndaj lekut, për shkak të ngushtimit të deficitit tregtar e buxhetor.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, është vënë re një qëndrueshmëri më e madhe e kursit të këmbimit të lekut ndaj shportës të valutave kryesore, e përbërë 80% nga vlera e euros dhe 20% nga vlera e dollarit amerikan, në krahasim me të njëjtën periudhë të dy viteve të mëparshme.

Një qëndrueshmëri më e madhe e kursit të këmbimit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 konstatohet edhe në ecurinë e kursit nominal efektiv të këmbimit, i cili ndërtohet duke u mbështetur në peshat e partnerëve kryesorë të vendit tonë në tregtinë e jashtme. Ecuria në rritje e grafikut që prej vjeshtës së vitit 2008, tregon prirjen nënçmuese të lekut. Gjatë kësaj periudhe ka patur edhe një përmirësim të deficitit tregtar të vendit. Që prej fillimit të vitit 2010, ecuria e kursit të këmbimit të lekut paraqitet e stabilizuar.

3.2.5. VEPRIMET E BANKËS SË SHQIPËRISË

Në janar të vitit 2010, në vijim të analizës që konfirmoi përmirësimin e situatës së likuiditetit për sektorin bankar, Banka e Shqipërisë rivendosi formën e ankandeve me shumë të kufizuar dhe normë interesi të konkurrueshme për operacionet e saj të injektimit të likuiditetit në tregun ndërbankar. Që prej nëntorit të vitit 2008, ankandi kishte ofruar injektimin e likuiditetit me shumë të pakufizuar dhe me normë interesi të njëjtë me normën bazë të interesit. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 nuk ka patur lëvizje në normën bazë të interesit, e cila ka vijuar të jetë në nivelin 5.25% që prej fundit të muajit tetor të vitit 2009. Gjithashtu, nuk ka patur lëvizje në madhësinë e ndryshimit nga norma bazë e interesit për normën e interesit të depozitës njëditore dhe atë të kredisë njëditore, duke ruajtur korridorin asimetrik të vendosur në 24 dhjetor të vitit 2008, kur Banka e Shqipërisë vendosi të ngushtojë me 100 pikë bazë ndryshimin

Grafik 28. Kursi i këmbimit të lekut ndaj monedhave kryesore.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 29. Ecuria e shportës së valutave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 30. Indeksi i kursit nominal efektiv.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 31. Ecuria e normave të tregut të parasë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

e normës së interesit të kredisë njëditore, në nivelin "norma bazë e interesit + 0.75%".

Në të njëjtën kohë, me qëllim për të rritur mundësitë e bankave për një administrim sa më të mirë të gjendjes së tyre të likuiditetit, që prej muajit dhjetor të vitit 2008 bankat janë lejuar të përdorin deri në 40% të rezervës së tyre të detyruar në lekë gjatë periudhës së mbajtjes së rezervës së detyrueshme. Vlerësohet që këto veprime të Bankës së Shqipërisë kanë ndihmuar në normalizimin e sasisë dhe të kostos së likuiditetit në sektorin bankar.

3.2.6. NDRYSHIMI MIDIS NORMAVE TË INTERESIT TË KREDIVE DHE DEPOZITAVE TË REJA.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, diferenca midis normës mesatare të kredive dhe normës mesatare të depozitave, është luhatur për të tri monedhat kryesore.[25] Gjatë kësaj periudhe, kjo diferencë është ngushtuar me 0.26 dhe 0.76 pikë përqindje, përkatësisht për veprimet në lekë dhe në euro, por është zgjeruar me 0.51 pikë përqindje për veprimet në dollarë amerikanë. Kontributin kryesor në ngushtimin e kësaj diference për veprimet në lekë, e dha ulja e normave të interesit të kredisë nga 13.2% në 12.7%. Normat e depozitave me afat në lekë janë paraqitur më të qëndrueshme, duke rënë gjatë kësaj periudhe nga 5.37% në 5.18%[26]. Ecuria e diferencës në normat e interesit për veprimet në euro është kushtëzuar kryesisht nga rënia e normave të interesit të depozitave me afat, e cila në fund të muajit qershor të vitit 2010 zbriti në nivelin 2.25%. Normat e interesit për depozitat me afat në dollar amerikan, zbriten në fund të periudhës në nivelin 1.2%, ndërkohë që normat e interesit për kredinë në dollarë, gjatë kësaj periudhe janë luhatur midis 6 dhe 8%.[27]

Grafik 32. *Spread*-i Kredi/ Depozita me afat.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përgjithësi, ecuria e normave të interesit për kreditë dhe depozitat sipas monedhave ka reflektuar ndryshimet në normat bazë të interesit, në gjendjen e likuiditetit si edhe në hezitimin e sektorit bankar për të kredituar me ritme më të larta për shkak të perceptimit të një niveli më të lartë rreziku në këtë veprimtari.

[25] *Në përllogaritjen e spread-eve të normave të interesit është përdorur diferenca midis normës së ponderuar të interesit të depozitave të reja me afat dhe kredive të reja.*

[26] *Normat e depozitave me afat kanë variuar midis niveleve 5 dhe 6% që nga shtatori i vitit 2008.*

[27] *Në qershor të vitit 2010, norma e ponderuar e kredisë për dollarin ishte 7.37%.*

ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE NË GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2010[28]

Për të vlerësuar zhvillimet në sistemet e pagesave, monitorohet funksionimi i infrastrukturës së sistemeve të pagesave që funksionojnë në Bankën e Shqipërisë, si dhe ndiqet ecuria e numrit dhe e vlerave të transaksioneve të pagesave dhe forma e realizimit të tyre në sektorin bankar.

Një ndryshim pozitiv në mënyrën e funksionimit të infrastrukturës së sistemeve të pagesave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, përfaqëson zbatimi i projektit për transferimin e pagesave të Thesarit nëpërmjet ndërfaqes elektronike midis sistemit të Thesarit pranë Ministrisë së Financave dhe sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH pranë Bankës së Shqipërisë. Kështu, duke filluar nga data 1 mars e vitit 2010, procesimi i pagesave në lekë, të iniciuara nga degët e Thesarit në favor të individëve dhe institucioneve të tjera përfituese të fondeve publike, është automatik.

Edhe për këtë arsye, gjashtëmujori i parë i vitit 2010 është karakterizuar nga një rritje e numrit të transaksioneve të procesuara në sistemet e pagesave dhe nga një rënie e vlerës mesatare për çdo transaksion, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009. Për periudhën janar–qershor 2010, çdo ditë në sistemin AIPS janë shlyer mesatarisht rreth 283 transaksione, me një vlerë mesatare ditore të likuiditetit të qarkulluar në sistem prej 17 miliardë lekësh. Ndërkohë, në sistemin AECH janë procesuar mesatarisht rreth 1,010 transaksione në ditë, me një vlerë mesatare ditore 0.13 miliardë lekë. Për sistemin AECH, vlera e përgjithshme e pagesave gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 ka qenë rreth 2.4 herë më e lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për administrimin e nevojave të tyre për likuiditet gjatë veprimtarisë së tyre operacionale, bankat pjesëmarrëse në sistemin AIPS mund të përdorin "kredinë brenda ditës". Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 vërehet rritje në numrin e përdorimit të këtij instrumenti në masën 24%, ndërkohë që ka rënë ndjeshëm vlera e këtyre kredive të disbursuara gjatë kësaj periudhe. Në përgjithësi, kjo reflekton një konceptim më të mirë të këtij instrumenti nga ana e bankave dhe një situatë më të mirë likuiditeti.

Grafik 33. Pesha e pagesave të klientëve në sistemin bankar sipas instrumentit të pagesave (në numër) për periudhën janar – qershor 2010.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me vlerësimin e ecurisë së transaksioneve të pagesave dhe të formës së realizimit të tyre në sektorin bankar, i referohemi statistikave të raportuara nga bankat për periudhën janar – qershor 2010, në përputhje me metodologjinë "Për

[28] *Për përgatitjen e informacionit të mëposhtëm është shfrytëzuar materiali rreth ecurisë së sistemit të pagesave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, përgatitur nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave.*

raportimin e instrumenteve të pagesave". Prej tyre rezulton se gjatë kësaj periudhe, pranë bankave janë kryer rreth 3.5 milionë pagesa për klientët, me një vlerë të përgjithshme 1,570 miliardë lekë.

Nga totali i pagesave të klientëve, rreth 81% janë urdhërpagesa (transferta kreditimi) nga të cilat: rreth 97.3% janë pagesa të instruktuara në formë "letër" (me shkresë ose me pajisje të tjera elektronike, por që domosdoshmërisht kërkojnë ndërhyrjen e punonjësve të bankës për t'u procesuar si pagesa); dhe vetëm 2.7% janë pagesa të ekzekutuara në formë elektronike (home banking).

Deri në fund të muajit qershor të vitit 2010, dhjetë banka ofrojnë produkte nëpërmjet shërbimit "home banking", duke mundësuar përdorimin e llogarisë bankare në distancë, nëpërmjet një linje interneti, linje telefoni ose një programi informatik, që banka i të në dispozicion klientit të saj. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 vërehet një rritje prej 25% e numrit të transaksioneve "home banking", ndërkohë që vlera e transaksioneve rezulton me një rritje rreth 8%.

Pagesat me karta debiti/krediti në pikat e shitjeve (POS) nëpër dyqane ose nëpër vende të tjera ku ofrohen shërbime, përbëjnë rreth 7% të totalit të pagesave për klientët, nga të cilat rreth 4% janë kryer me karta debiti dhe 3% me karta krediti. Nga krahasimi me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vërehet rritje e numrit dhe e vlerës së transaksioneve me karta, përkatësisht me 11 dhe 9%.

Gjatë periudhës janar-qershor 2010, në total u procesuan rreth 5 milionë transaksione me karta (në ATM dhe POS), me një qarkullim total mbi 53 miliardë lekë. Nga totali, rreth 95% përbëjnë tërheqjet e parasë fizike nga ATM-të dhe diferenca janë pagesa klientësh me karta në POS-e, tregues ky i një ekonomie me përdorim të lartë të parasë fizike.

Gjithsesi, numri i kartave të emetuara nga bankat është në rritje. Deri në fund të qershorit 2010, krahasuar me fundin e vitit 2009, është raportuar një shtesë në numrin e kartave të emetuara me rreth 77,572 karta pagesash, që përfaqëson një rritje prej 14 dhe 15%, përkatësisht të numrit të kartave të debitit dhe të numrit të kartave të kreditit, në qarkullim.

4. ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR[29]

Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i vlerësuar si raport i aktiveve të sektorit financiar[30] ndaj Produktit të Brendshëm Bruto[31] (PBB-së), është vlerësuar në nivelin 84.5% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, nga 82% që llogaritej në fund të vitit 2009 dhe rreth 76.3% në të njëjtën periudhë një vit më parë. Vëllimi i aktiveve të institucioneve financiare u rrit me rreth 5.8% krahasuar me fundin e vitit 2009 dhe 13.6% referuar periudhës së një viti më parë. Sektori bankar vijon të mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, ku në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, aktivet e tij përfaqësonin rreth 94.4% të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 79.7% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së).

Tabelë 11. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %).

Autoriteti licencues dhe mbikëqyrës	Sistemi financiar	Vitet					
		2005	2006	2007	2008	2009	2010*
Banka e Shqipërisë	Sistemi bankar	60.4	69.6	75.9	76.7	77.5	79.7
	Institucione jobanka	1.32	1.52	1.48	1.66	2.2	2.54
	SHKK-të dhe Unionet e tyre	0.46	0.52	0.63	0.7	0.77	0.8
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri Sigurimi	1.24	1.29	1.36	1.45	1.5	1.42
	Fondet e pensionit	-	-	-	-	0.01	0.01

** Gjashtëmujori i parë i vitit 2010.*
Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Hapësirë informuese 3. Sektori financiar jobankar

Sektori financiar jobankar përfshin institucionet financiare që mbikëqyr Banka e Shqipërisë dhe ato që mbikëqyr Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Në institucionet që mbikëqyr Banka e Shqipërisë, përfshihen: a) institucionet financiare jobanka (shoqëri që veprojnë në fushën e kreditimit dhe shoqëritë e lizingut), b) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, dhe c) institucione të tjera që ofrojnë shërbime të pagesave dhe të këmbimit valutor. Në institucionet që mbikëqyr AMF-ja, përfshihen: a) shoqëritë e sigurimit dhe b) shoqëritë e pensioneve private suplementare. Shoqëritë e tregtimit të letrave me vlerë, që gjithashtu mbikëqyren nga AMF-ja, kanë një peshë të papërfillshme.

[29] *Analiza mbi zhvillimet në sistemin financiar do të mbështetet në raportimet më të fundit të subjekteve financiare pranë BSH-së. Në këtë mënyrë, të dhënat mbi aktivitetin e sektorit bankar, mbi kontributet e fondeve të pensionit privat suplementar, mbi shoqëritë e kursim-kreditit dhe institucionet financiare jobanka i përkasin gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ndërsa të dhënat mbi aktivet e shoqërive të sigurimit i përkasin tremujorit të parë të vitit 2010.*

[30] *Sistemi financiar përbëhet nga: bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e kursim-kreditit dhe fondet e pensioneve private suplementare.*

[31] *Është shfrytëzuar vlera e PBB-së prej 1,217 miliardë lekësh, vlerësim i FMN-së për vitin 2010 ("IMF-Country Report, No.10/205", Korrik 2010). Për fundin e muajit qershor, vlera e PBB-së është vlerësuar në nivelin 1,173.5 miliardë lekë.*

Grafik 34. Pesha e subjekteve të sistemit financiar në totalin e aktivit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, evidentohet rritje e kontributit të sektorit financiar jobankar, edhe pse vazhdon të pasqyrojë peshë totale relativisht të vogël ndaj tërësisë së sistemit financiar. Në raport me totalin e aktiveve të sistemit financiar, totali i aktiveve të sektorit financiar jobankar zë rreth 5.6%, nga 5.3% dhe 4.6% që ishte përkatësisht në fund të vitit 2009 dhe në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009. Në raport me PBB-në, totali i aktiveve të sektorit financiar jobankar zë rreth 4.8%, nga rreth 4.4% dhe 3.5% që ishte përkatësisht në fund të vitit 2009 dhe në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009.

Në grafikun 34 paraqitet struktura e sistemit financiar për secilin segment që operon në vend.

ANALIZË FINANCIARE MBI AKTIVITETIN E INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKA

Veprimtaria e institucioneve financiare jobanka, që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, me gjithë ngadalësimin e nivelit të kapitalizimit dhe rënien e cilësisë së portofolit të kredisë në terma bruto, paraqet zhvillime pozitive lidhur me rritjen e aktiveve, zgjerimin e portofolit të kredisë, rritjen e rezultatit financiar. Vlera e aktiveve të këtyre institucioneve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 rezultoi rreth 29.8 miliardë lekë, 4.8 miliardë lekë ose 19.4% më shumë se fundi i vitit 2009[32]. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve të këtyre institucioneve, krahasuar me fundin e vitit 2009, e dha aktiviteti kreditues, me rreth 87%. Ndërkohë, kontributin kryesor në rritjen e burimeve (detyrimet) e dha zëri "kredi të marra", me rreth 86%.

Grafik 35. Rritja e nivelit të aktiveve të institucioneve jobanka sipas tremujorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Niveli i kapitalizimit, i matur si raport i "llogarisë së kapitalit" me "totalin e aktiveve", në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 zbriti në nivelin 35% nga 37% që ishte në fund të vitit 2009, duke mbetur sidoqoftë shumë më lart se niveli minimal i kërkuar nga kuadri rregullativ prej 10%.

[32] *Rritja e konsiderueshme e nivelit të aktiveve dhe në vazhdim e disa treguesve të tjerë, si portofoli i kredisë, niveli i kapitalizimit, rezultati financiar etj, ka ardhur edhe si rezultat i raportimit të kryer për herë të parë pranë Bankës së Shqipërisë, të 4 institucioneve të reja financiare jobankare që veprojnë në fushën e leasing-ut.*

Portofoli i kredive zë peshën kryesore në totalin e aktiveve të institucioneve financiare jobanka, me rreth 61.6% në fund të qershorit të vitit 2010. Në vlerë, totali i kredive (bruto) u ngjit në nivelin 18.2 miliardë lekë, rreth 3.9 miliardë lekë më shumë se fundi i vitit 2009.

Raporti i kredive me probleme (në terma bruto) ndaj tepricës së kredisë në tremujorin e dytë të vitit 2010, u ngjit në nivelin 4.85% nga 3.4% që u vlerësua në fund të vitit 2009, edhe si rrjedhojë e përfshirjes së aktiviteteve të shoqërive të *leasing*-ut në llogaritje.

Institucionet financiare jobanka kanë shënuar rritje të përfitueshmërisë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, ku fitimi neto rezultoi rreth 540.8 milionë lekë, nga 318.8 milionë lekë në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për sa i përket nivelit të përgjithshëm të të ardhurave, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ato u ngjitën në 2.9 miliardë lekë, rreth 514.6 milionë lekë më shumë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Në zërat e të ardhurave, peshën kryesore e përbëjnë "të ardhurat nga interesi" me rreth 55% dhe ato nga komisionet me rreth 13%. Ndërkohë, në zërat e shpenzimeve peshën kryesore e zënë "shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë", pesha e të cilave ra në 34.7%, nga 48.6% në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

AKTIVITETI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT (SHKK-TË)

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2010, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, kanë vijuar zgjerimin e aktivitetit, me një ritëm më të shpejtë sesa rritja e kredisë. Cilësia e portofolit të kredisë ka rënë. Por rritja e aktiveve që sjellin të ardhura ka kompensuar rritjen e shpenzimeve dhe rezultati financiar është përmirësuar.

Totali i aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit, bashkë me unionet e tyre për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, u rrit me rreth 7% krahasuar me fundin e vitit 2009, në nivelin e 9.4 miliardë lekëve. Referuar së njëjtës periudhë të një viti

Grafik 36. Llogaria kapitale ndaj totalit të aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 37. Ecuria e kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 38. Kredia me probleme ndaj totalit të kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

më parë, rritja e aktiveve ka qenë rreth 1.1 miliardë lekë ose rreth 13.6%.

Aktiviteti kreditues vijon të zërë peshën kryesore në veprimtarinë financiare të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, ato raportuan rreth 75.9% të totalit të aktiveve të angazhuara në kredidhënie. Cilësia e kredisë për shoqëritë e kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre, ka rënë siç tregohet nga ecuria e raportit "kredi me probleme ndaj tepricës së kredisë (mbi baza bruto)" i cili është rritur me 1.4 pikë përqindjeje, duke u ngjitur në nivelin 3.3%, nga 1.9% që llogaritej në fundin e vitit 2009. Ritmi i rritjes së kredive me probleme ishte rreth 75.3%, ndërsa ai i rritjes së tepricës së kredisë ishte 3.4%. Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e disa treguesve mbi aktivitetin e shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre.

Tabelë 12. Tregues të aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit.

	TIV-08	TI-09	TII-09	TIII-09	TIV-09	TI-10	TII-10
Totali i aktiveve (mln lekë)	7,657	7,866	8,251	8,670	8,765	8,825	9,378
Teprica e kredisë (mln lekë)	6,284	6,419	6,438	6,634	6,893	7,003	7,125
Teprica e kredisë/totalit të aktiveve (%)	82.1	81.6	78.03	76.5	78.6	79.4	75.9
Kredi me probleme (mln lekë)	82.4	103.8	118.6	132.1	135.2	198.8	237,1
Kredi me probleme/tepricës së kredisë (%)	1.31	1.62	1.84	1.99	1.96	2.84	3.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Fitimi neto i realizuar i shoqërive të kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, u ngjit në rreth 62 milionë lekë nga 28 milionë lekë referuar së njëjtës periudhë të një viti më parë.

AKTIVITETI I SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE I FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT SUPLEMENTAR

Për shoqëritë e sigurimit, të ardhurat nga primet e sigurimit, në periudhën janar - qershor 2010 arritën rreth 3,974 milionë lekë ose 2.15% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar[33]. Numri i kontratave të sigurimit gjatë periudhës janar-qershor 2010 arriti në 306,501, duke shënuar një ulje prej rreth 15.4% referuar së njëjtës periudhë të një viti më parë. Shoqëritë e sigurimit kanë paguar rreth 30.5% më shumë dëme gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, referuar së njëjtës periudhë të një viti më parë, ku përqendrimi më i lartë është në veprimtarinë e jojetës. Raporti "dëme ndaj prime (bruto)", edhe pse në një nivel që konsiderohet ende i ulët rezulton rreth 25% nga 22% për vitin 2009. Nga këndvështrimi i peshës së tregut, sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 49.8% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 50.2% të totalit të tregut.

[33] *Referuar raportit të publikuar nga AMF-ja, korrik 2010. Aktualisht, operojnë 9 shoqëri sigurimi të jojetës dhe 3 shoqëri sigurimi të jetës.*

Aktivet e sektorit të sigurimeve për tremujorin e parë të vitit 2010, rezultuan rreth 16.7 miliardë lekë, me një rritje prej 463 milionë lekë ose 2.85%, referuar fundit të vitit 2009. Peshën kryesore në totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit e përbën zëri "depozita, certifikata depozitash dhe llogari në banka" me rreth 49.5%, ndjekur nga zëri "investime në pasuri të paluajtshme" me rreth 9.4% dhe zëri "provigjone teknike" me 7.6%.

Grafik 39. Pesha e zërave të aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit.



Burimi: AMF, Banka e Shqipërisë.

Raporti i kapitalit ndaj totalit të aktiveve, i cili mat nivelin e kapitalizimit të shoqërive të sigurimit, për tremujorin e parë të vitit 2010 u ngjit lehtësisht në nivelin 53.4%, nga 52.6% që llogaritej në fund të vitit 2009, dhe 56.5% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Treguesi që tregon aftësinë për të përballuar humbjet, si rezultat i ekspozimit ndaj rreziqeve të mundshme, është raporti i kapitalit ndaj rezervave teknike, i cili për tremujorin e parë të vitit 2010 rezultoi 72.7%, pa luhatje të qenësishme me fundin e vitit 2009, por ndjeshëm më i ulët se në të njëjtën periudhë të një viti më parë prej rreth 163%. Rënia e raportit ka ardhur si rezultat i rritjes së rezervave teknike me rreth 13.3%, kundrejt rënies së nivelit të kapitalit me rreth 4.3%.

Fitimi i shoqërive të sigurimit për tremujorin e parë të vitit 2010 rezulton rreth 362.4 milionë lekë, rreth 132 milionë lekë ose 27% më i ulët se vlera e së njëjtës periudhë të një viti më parë. Ngadalësimi i rezultatit financiar është reflektuar edhe në ecurinë e dy treguesve të kthimit nga aktivet (RoA) dhe kapitali (RoE[34]), të cilët për tremujorin e parë të vitit 2010 janë llogaritur përkatësisht 2.2% dhe 4%, nga 3.2% dhe 5.8% referuar së njëjtës periudhë të një viti më parë.

Shoqëritë e pensioneve private suplementare, kanë provuar një zgjerim të veprimtarisë gjatë periudhës janar-qershor 2010, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në fund të periudhës, numri i kontribuesve në këto shoqëri është ngjitur në 4,658, krahasuar me 4,288 në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vlera e këtyre kontributeve është rreth 87 milionë lekë, afërsisht 40.8% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

[34] ROA është llogaritur si raport i rezultatit financiar të periudhës (për shembull, tremujori i parë i vitit 2010) ndaj aktiveve mesatare (mesatarja e aktiveve për dy periudha mars 2009 dhe mars 2010). E njëjta formulë është përdorur edhe me llogaritjen e RoE-së, por ndaj kapitalit mesatar.

4.1. ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË SEKTORIN BANKAR[35]

4.1.1. ECURIA E AKTIV-PASIVEVE DHE PËRBËRJA E TYRE

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, sektori bankar kishte aktive që zinin 79.7% të PBB-së[36], kundrejt 77.5% që kishte në fund të vitit 2009. Aktivet e sektorit bankar u ngjitën në nivelin 934.7 miliardë lekë, me një rritje prej 5.5% kundrejt fundit të vitit 2009 dhe prej 12.4% kundrejt një viti më parë[37].

Për sa i takon përbërjes së aktiveve të sektorit bankar, zëri kryesor ishte "veprime me klientët (bruto)", i cili përfaqëson portofolin e kredive të bankave. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, vlera e portofolit të kredive u ngjit në nivelin 469.6 miliardë lekë, duke përbërë 50.2% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Gjatë vitit të fundit, pesha e veprimtarisë kredidhënëse të sektorit bankar ndaj totalit të aktiveve, e ka ndaluar rritjen që vijonte prej disa vitesh. Perceptimi i një rreziku më të lartë në aktivitetin kreditues është shoqëruar me rritjen e preferencës së bankave për të rritur vendosjet në institucionet e tjera financiare, kryesisht të huaja. Megjithatë ky ndalim në prirjen rritëse të kredisë vlerësohet të jetë i përkohshëm. Në afat të mesëm prirja rritëse e veprimtarisë krediduese do të vijojë, ndonëse me një ritëm më të ulët. Zëri i dytë me peshën më të madhe, ndër aktivet e sektorit bankar është "Veprimet me thesarin dhe ndërbankare"[38]. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, ky zë arriti vlerën 275.5 miliardë lekë dhe zinte 29.5% të totalit të aktiveve. Rritja e peshës ka ardhur si pasojë e rritjes së marrëdhënieve me bankat e tjera[39], nga 5% të aktiveve në qershorin e vitit 2009 në 8% në qershorin e vitit 2010. Brenda këtij zëri, "marrëdhëniet me Bankën Qendrore" janë thuajse të pandryshuara si peshë kundrejt një viti më parë, ndërsa veprimet me bonot e thesarit, në vlerën e 109 miliardë lekëve, zënë 11.7% të totalit të aktiveve, duke vazhduar prirjen rënëse të viteve të fundit.

Zëri "Veprimet me letrat me vlerë" përbën 20.7% të totalit të aktiveve e nuk paraqet ndryshim të rëndësishëm kundrejt një viti më parë.

---

[35] *Të dhëna të përmbledhura për gjendjen financiare të sektorit bankar, jepen në Aneksin 1, bashkëlidhur.*

[36] *Është shfrytëzuar vlera e PBB-së prej 1,217 miliardë lekësh, vlerësimi i FMN-së për vitin 2010 ("IMF-Country Report, No.10/205", korrik 2010). Për fundin e muajit qershor, vlera e PBB-së është vlerësuar në nivelin 1,173.5 miliardë leke".*

[37] *Në rast se, për efekt krahasimi, do të hiqej efekti i luhatjes së kursit të këmbimit, aktivet e sektorit bankar paraqesin një rritje me 4.5% kundrejt fundit të vitit 2009 dhe me 8.8% kundrejt qershorit të vitit 2009. Në periudhën 31.12.09 – 30.06.10, vlera nominale e lekut u nënçmua me 16.3% kundrejt dollarit amerikan dhe u mbiçmua me 1.1% kundrejt euros. Në periudhën 30.06.09 – 30.06.10, vlera nominale e lekut u nënçmua me 20.2% kundrejt dollarit amerikan dhe me 4.4% kundrejt euros.*

[38] *Ky zë përfshin: transaksionet që kryejnë bankat me Bankën Qendrore (depozita, rezervë e detyrueshme, operacionet e tregut të hapur) transaksionet me bonot e thesarit, si edhe operacionet midis bankave tregtare - depozita, llogari rrjedhëse, hua etj.*

[39] *Ky zë përmban: llogari rrjedhëse, depozita në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare, kredi etj.*

Në mënyrë më të detajuar, ecuria në vite e zërave përbërës të aktiveve të sektorit bankar, jepet në tabelën më poshtë.

Tabelë 13. Pesha e zërave të aktiveve (qershor '04 – qershor '10).

Pesha ndaj totalit të aktiveve (në %)	Qershor '04	Qershor '05	Qershor '06	Qershor '07	Qershor '08	Qershor '09	Qershor '10	Vlerat në mld lekë (qershor '10)
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto:	76.1	64.6	55.3	45.1	35.6	27.5	29.5	275.5
- Marrëdhënie me Bankën Qendrore	9.1	8.5	9.1	8.4	8.4	7.7	7.6	70.9
- Bono thesari	49.7	40.1	31.8	22.2	14.7	12.6	11.7	109.0
- Marrëdhënie me bankat e tjera	15.3	14.0	12.4	12.5	10.6	5.0	8.0	74.6
2. Veprime me klientët (bruto)	14.5	20.8	28.9	35.9	43.0	50.7	50.2	469.6
3. Veprime me letrat me vlerë	5.6	11.0	13.1	16.7	19.3	21.0	20.7	193.6
4. Mjete të tjera	0.8	0.8	0.7	0.6	0.8	0.8	1.0	8.9
5. Mjete të qëndrueshme	1.5	1.7	1.5	1.5	1.6	1.9	1.5	14.0
Totali i aktiveve	100	100	100	100	100	100	100.0	934.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i takon përbërjes se detyrimeve të sektorit bankar, peshën kryesore e zinte zëri "veprime me klientët" që përfaqëson depozitat pranë bankave. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, ato kapën vlerën 743.1 miliardë lekë[40] dhe përbënin 79.5% të totalit të pasiveve. Pesha e depozitave në totalin e detyrimeve të sektorit bankar ka ardhur në rritje gjatë vitit të fundit, në vijim të rikthimit të ritmit rritës të depozitave në sektorin bankar. Edhe në këtë rast, vlerësojmë se kemi të bëjmë me një ndalim të përkohshëm të prirjes rënëse afatgjatë të peshës së depozitave në totalin e detyrimeve të sektorit bankar. Megjithëse rritja e depozitave në vlerë absolute është një fenomen që do të vazhdojë, objektivat e bankave për kontrollin e kostove dhe zgjerimin e burimeve të financimit për përmirësimin e eficiencës, do të ushtrojnë presion frenues ndaj rritjes së peshës së depozitave në totalin e detyrimeve të sektorit bankar në afat të gjatë. Paralelisht me rritjen e depozitave, bankat kanë ulur detyrimet që rrjedhin nga "Veprimet me thesarin dhe ndërbankare"[41], të cilat kapën vlerën 80.5 miliardë lekë dhe përbënin 8.6% të detyrimeve. Në fund të periudhës, pesha e tyre zbriti me 1.5 pikë përqindje nga fundi i vitit 2009, dhe me 3.2 pikë përqindje nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar. "Burimet e përhershme"[42], kapën vlerën 100.8 miliardë lekë, duke vijuar ecurinë e tyre rritëse. Rritja vjetore e peshës së këtij zëri në totalin e detyrimeve ka qenë vetëm 0.3 pikë përqindje. Elementi kryesor i "Burimeve të përhershme" përbëhet nga "Kapitali i aksionerëve", i cili në fund të periudhës arriti vlerën 89.7 miliardë lekë, me një rritje 12 miliardë lekë ose 15.5% kundrejt një viti më parë. Kapitali i paguar ishte 63.6 miliardë lekë, me një rritje 2.7 miliardë lekë ose 4.5%, nga fundi i vitit të kaluar si rezultat i injektimit të kapitalit të kryer në disa banka gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Në mënyrë më të

[40] *Depozitat e klientëve janë rritur me rreth 49 miliardë lekë kundrejt fundit të vitit të kaluar dhe me rreth 103 miliardë lekë kundrejt një viti më parë.*

[41] *"Veprimet me thesarin dhe veprimet ndërbankare" përfshijnë: veprimet me Bankën Qendrore dhe bonot e thesarit të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes, si edhe marrëdhëniet (huamarrjet) nga bankat e huaja (kryesisht nga grupi bankar të cilit i përkasin).*

[42] *Përfshin llogarinë e kapitalit (kapitali i aksionerëve, fitimi/humbja e mbartur, fitimi/humbja e vitit), të rezervave (të përgjithshme, specifike), të rivlerësimit etj.*

detajuar, ecuria në vite e zërave përbërës të detyrimeve të sektorit bankar, jepet në tabelën më poshtë.

Tabelë 14. Pesha e zërave të detyrimeve/pasiveve (qershor '04 – qershor '10).

Pesha ndaj totalit të pasiveve (në %)	Qershor '04	Qershor '05	Qershor '06	Qershor '07	Qershor '08	Qershor '09	Qershor '10	Vlerat në mld lekë (qershor '10)
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto:	4.1	5.4	6.0	8.0	9.5	11.8	8.6	80.5
- Marrëdhënie me Bankën Qendrore	0.4	0.1	0.2	0.1	0.2	0.2	0.1	1.1
- Bono thesari	0.0	0.0	2.0	1.1	1.0	3.7	2.5	23.4
- Marrëdhënie ndërbankare	3.7	5.3	3.8	5.4	8.2	7.5	5.7	53.7
2. Veprime me klientët (bruto)	88.5	86.8	85.7	82.7	80.6	77.0	79.5	743.1
3. Detyrime të tjera	1.2	0.9	1.0	1.3	0.9	0.7	1.1	10.0
4. Burimet e përhershme, nga këto:	6.2	6.8	7.3	7.9	8.9	10.5	10.8	100.8
- Kapitali i aksionerëve	5.9	6.4	6.7	7.1	7.9	9.3	9.6	89.7
Totali i pasiveve	100	100	100	100	100	100	100	934.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 40. Pesha e grupeve të bankave në totalin e aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, pesha në totalin e aktiveve mesatare të sektorit bankar për vlerën mesatare të aktiveve të bankave në Grupin 3[43], Grupin 2 dhe Grupin 1, ishte përkatësisht 72.0%, 23.1% dhe 4.9% (grafik). Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, pesha e bankave të Grupit 3 ka rënë me 1.7 pikë përqindje, ndërsa peshat e bankave të Grupit 2 dhe të Grupit 1 janë rritur përkatësisht me 1.1 pikë përqindje dhe 0.7 pikë përqindje. Grafiku 40 tregon ecurinë e peshave të aktiveve të bankave sipas grupeve.

4.1.2. PËRBËRJA E BILANCIT SIPAS VALUTAVE DHE POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, aktivet e sektorit bankar në valutë të huaj zinin rreth 51.3% të totalit të aktiveve, 2.9 pikë përqindje më shumë se një vit më parë. Detyrimet e sektorit bankar në valutë të huaj ishin 49.4% të totalit të aktiveve, 1.9 pikë përqindje më shumë se një vit më parë. Diferenca ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve në valutë ka arritur vlerën më të lartë të viteve të fundit me rreth 1.9 pikë përqindje, ndonëse vlerësohet ende në nivele të kufizuara.

[43] *Kriteri për ndarjen e bankave në grupe është madhësia e aktivitetit: konkretisht, G1 është grupi i bankave të vogla (pesha e vlerës mesatare të aktiveve të secilës bankë në këtë grup është nën 2% të totalit të vlerës mesatare të aktiveve të sektorit); G2 është grupi i bankave të mesme (pesha e secilës bankë përbërëse të këtij grupi është midis 2 dhe 7% e totalit të vlerës mesatare të aktiveve të sektorit) dhe G3 është grupi i bankave të mëdha (pesha e secilës bankë në këtë grup është mbi 7% e totalit të vlerës mesatare të aktiveve të sektorit). Për klasifikimin e bankave në sistemin bankar shqiptar shiko sqarimin në faqen 8.*

Periudha	Pesha ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar (në %)		
	Aktive në valutë	Detyrime në valutë	Diferenca (1)-(2)
Dhjetor 2005	41.1	41	0.1
Mars 2006	41.5	41	0.5
Qershor	41.6	41.6	0
Shtator	43.3	43.2	0.1
Dhjetor	44.2	44	0.2
Mars 2007	45.6	45.2	0.4
Qershor	45.7	45.7	0
Shtator	46.6	46.5	0.1
Dhjetor	46.8	46.9	-0.1
Mars 2008	47.9	47.7	0.2
Qershor	48	48.1	-0.1
Shtator	50.6	50.2	0.4
Dhjetor 2008	48.9	48.5	0.4
Mars 2009	50.2	49.7	0.6
Qershor	48.4	47.5	0.9
Shtator	49.5	48.3	1.2
Dhjetor 2009	50.2	48.9	1.3
Mars 2010	50.9	49.3	1.6
Qershor 2010	51.3	49.4	1.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 15. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor '05 – qershor '10).

Në fund të muajit qershor të vitit 2010, pozicioni i hapur neto në valutë zinte rreth 7.6% të kapitalit bazë të sektorit bankar. Ky pozicion mbetet "në blerje" dhe brenda intervalit 0-10% ku është luhatur në vitet e fundit. Madhësia e pozicionit të hapur konsiderohet e kufizuar dhe si rezultat, rreziku i kursit të këmbimit vlerësohet i moderuar.

Grafik 41. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 42. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe i pasiveve në muaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.3. PËRBËRJA SIPAS AFATIT TË MATURIMIT

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, aktivet e sektorit bankar kishin një afat maturimi[44] mesatar të mbetur prej rreth 28.3 muajsh, nga 29 muaj në fund të vitit 2009 dhe 32.8 muaj në të njëjtën periudhë një vit më parë. Në të njëjtën periudhë, maturimi[45] mesatar i mbetur i detyrimeve të sektorit bankar llogaritet rreth 11.4 muaj, nga 11.9 muaj në fund të vitit 2009, duke ruajtur pothuaj të njëjtin maturim mesatar për periudhën ekuivalente të një viti më parë. Ecuria e maturimit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve paraqitet në grafikun 42.

Vërehet se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, diferenca në maturimin midis aktiveve dhe detyrimeve është ngushtuar në 16.6 muaj, nga 17.3 muaj që ishte në fund të vitit 2009 dhe nga 21.4 muaj që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ngushtimi i diferencës ka ardhur kryesisht si rezultat i zvogëlimit të maturimit të mbetur të portofolit të kredisë, i cili që prej muajit tetor të vitit 2008 kur shënoi nivelin më të lartë me rreth 47.7 muaj, ka nisur një rënie të vazhdueshme dhe në fund të periudhës shënoi nivelin më të ulët të 5 viteve të fundit. Konkretisht, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, kredia paraqet një afat maturimi mesatar[46] prej rreth 43.4 muaj, nga 44.7 muaj që ishte në fund të vitit 2009 dhe nga 46.5 muaj në qershor të vitit 2009. Nga ana tjetër, afati i maturimit të depozitave është luhatur brenda limiteve më të qëndrueshme. Në fund të periudhës, depozitat paraqesin një

[44] *Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së aktiveve, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "a priori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin aktivet me maturim të mbetur "0-7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë deri në 1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "1-3 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vite ose 120 muaj (duke qenë se pjesa më e madhe në këtë segment përfaqësohet nga kreditë hipotekare me maturim fillestar 15 vjet).*

[45] *Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së pasiveve, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin pasivet "0-7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë-1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "1-3 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për atë "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 6 vite ose 72 muaj.*

[46] *Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së kredisë sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "a priori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin kreditë "deri në 7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 muaj; për atë "7 ditë -1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vjet ose 120 muaj.*

afat maturimi mesatar[47] prej rreth 4.15 muajsh, nga 4.7 muaj që ishte në fund të vitit 2009 dhe nga 4 muaj që ishte në fund të qershorit të vitit 2009.

Grafik 43. Maturimi mesatar i mbetur i kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.4. ZËRAT JASHTË BILANCIT

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, zërat jashtë bilancit ishin rreth 910.8 miliardë lekë ose 97.4% e totalit të aktiveve të sektorit bankar. Pas arritjes së nivelit më të lartë në muajin qershor të vitit 2009 me rreth 102.4% të totalit të aktiveve, ecuria e zërave jashtë bilancit ka qenë më e qëndrueshme duke mbetur nën nivelin 100%. Në krahasim me fundin e vitit 2009, zërat jashtë bilancit janë rritur me rreth 77.8 miliardë lekë, të ndikuar kryesisht prej rritjes së vlerës së angazhimeve të marra për rreth 57.8 miliardë lekë, në nivelin 821 miliardë lekë. Ndikimin kryesor tek angazhimet e marra, e dhanë garancitë e marra në favor të klientëve me një rritje prej rreth 55.7 miliardë lekë, në nivelin 796.4 miliardë lekë. Këto veprime përfaqësojnë kryesisht masat mbrojtëse që kanë marrë bankat për mbrojtjen nga rreziku i kredisë. Një rritje të rëndësishme kanë shënuar edhe transaksionet e blerjes ose të shitjes së valutës me afat, të cilat gjatë kësaj periudhe u rritën me rreth 19.1 miliardë lekë, duke u ngjitur në nivelin 34.1 miliardë lekë. Veprimet me afat të blerjes dhe ato të shitjes së valutës, kanë vlera pothuaj të njëjta.

Grafik 44. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.5. SHPËRNDARJA E AKTIVEVE/INVESTIMEVE DHE CILËSIA

Gjatë periudhës janar - qershor 2010, veprimtaria e sektorit bankar u zgjerua me rreth 48.4 miliardë lekë.

Në ecurinë e përgjithshme të veprimtarisë së sektorit bankar, pati veprimtari që dhanë një ndikim pozitiv dhe të tjera që dhanë një ndikim negativ.

[47] *Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së depozitave, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "a priori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin depozitat "deri në 7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë-1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 6 vjet ose 72 muaj.*

Grafik 45. Ecuria e zërave të aktivit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 46. Kontributi në rritjen e aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 47. Aktivet me rrezik dhe portofoli i kredisë ndaj totalit të aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndër veprimtaritë me ndikim pozitiv ishin veprimtaria krediduese, investimi në letrat me vlerë si edhe veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare. Konkretisht, zëri "veprime me klientët bruto", që përfaqëson aktivitetin kreditues, shënoi rritje me rreth 19.3 miliardë lekë ose 4.3%, krahasuar me fundin e vitit 2009, duke përfituar rreth 39.9% të rritjes së sektorit bankar. Zëri "veprime me thesarin dhe ndërbankare" për të njëjtën periudhë, është rritur me rreth 21.2 miliardë lekë ose 7.7%, duke përfituar 43.7% të rritjes së aktiveve të sektorit bankar. Zëri "veprime me letrat me vlerë" ka shënuar rritje me rreth 6.7% krahasuar me fundin e vitit 2009, duke përfituar rreth 26.2% të rritjes gjashtëmujore të aktiveve të sektorit bankar. Ndër veprimtaritë me ndikim negativ ishin ato të përfshira në zërat "mjete të qëndrueshme" me rreth 1.5%, "mjete të tjera" me rreth 1.5%, "interesa të përllogaritura" me rreth 3.2%" dhe "rezervat", që përfshijnë edhe provigjonet për rrezikun e kredisë, me rreth 13%.

Ndër zërat e burimeve, kontributin më të lartë në zgjerimin e veprimtarisë gjatë kësaj periudhe e dha zëri "veprimet me klientët", që përfaqëson aktivitetin depozitues, me rreth 95.3%, i ndjekur nga zëri "burime të përhershme" me 9.8% dhe zëri "detyrime të tjera" me 8.9%. Ndërkohë, zëri i vetëm i burimeve që ka kontribuar negativisht në zgjerimin e veprimtarisë është zëri "veprime me thesarin dhe ndërbankare" me rreth 19.5%. Rënia e vlerës së kësaj veprimtarie është rrjedhojë e përmirësimit të situatës së likuiditetit të sektorit bankar, dhe njëherazi reflekton pakësimin e financimeve mbështetëse për bankat që operojnë në vendin tonë, të vëna në dispozicion nga grupet zotëruese bankare për të përballuar situatën e vështirësuar të likuiditetit gjatë fundit të vitit 2008 dhe fillimit të vitit 2009.

AKTIVET ME RREZIK

Për të vlerësuar cilësinë e investimeve të sektorit bankar dhe nivelin e rrezikut të tyre, analizojmë fillimisht ecurinë e aktiveve me rrezik të sektorit bankar.

Aktivet me rrezik të sektorit bankar në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 u rritën me rreth 34.4 miliardë lekë ose 6.8%, duke u ngjitur

në nivelin 537.2 miliardë lekë[48]. Pesha e tyre ndaj totalit të aktiveve të sistemit bankar ka shënuar një rritje të lehtë në 57.5%, nga 56.7% në fund të vitit 2009. Rritja e peshës është shkaktuar kryesisht si rezultat i një norme rritjeje më të lartë të aktiveve të ponderuara me rrezik për rreth 6.8%, ndaj ritmit rritës të totalit të aktiveve të sektorit për rreth 5.2%. Për sa i përket grupeve të bankave sipas madhësisë së aktivitetit, raporti "aktive me rrezik ndaj totalit të aktiveve" ka shënuar rritje për bankat e Grupit 3 me 5.8 pikë përqindje, në nivelin 53.1%, dhe për bankat e Grupit 1 me 3.9 pikë përqindje, në nivelin 62.4%.

Ecuria e aktiveve me rrezik përcaktohet kryesisht nga ecuria e portofolit të kredisë, i cili në qershor të vitit 2010 përfaqësonte 50.2% të totalit të aktiveve, një nivel pothuaj i pandryshuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010. Sipas grupeve të bankave, përqendrimin më të madh të portofolit të kredisë ndaj totalit të aktiveve e kanë bankat e Grupit 2, me rreth 66.7%.

Grafik 48. Aktivet me rrezik dhe portofoli i kredisë ndaj totalit të aktiveve për grupet e bankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KREDITIMI

Ecuria e kredisë përcaktohet nga shtesa që realizohet gjatë periudhës, e vlerësuar si diferencë mes kredisë së re dhe ripagesës së kredisë së dhënë që mblidhet nga sektori bankar.

KREDIA E RE

Në lidhje me ecurinë e kredisë së re në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, vlerësohet se vlera e saj ishte 127.2 miliardë lekë[49], me një rritje prej 24.3 miliardë lekësh ose 23.6%, referuar të njëjtës periudhë një vit më parë.

[48] *Aktivet me rrezik të lartë, të ponderuara me koeficientin e rrezikut 150%, kanë dhënë një kontribut prej 71.7% në rritjen e aktiveve të ponderuara me rrezik për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, krahasuar me fundin e vitit 2009.*

[49] *Vlera e kredisë së re është zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit.*

Sipas monedhave origjinale evidentohet rritje e kredisë së re në monedhën vendase me 1.1 miliardë lekë ose rreth 2.6%, rritje e kredisë së re në valutë përkatësisht me 61.7 milionë dollarë ose 63.6% dhe 128 milionë euro ose 35.1%, si edhe rënie të kredisë së re në monedha të tjera me rreth 96.4 milionë lekë ose 89.7%. Për të njëjtën periudhë, sektori bankar mblodhi kredi në masën 113.8 miliardë lekë, me një rritje prej 33.1 miliardë lekësh ose 41% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, raporti i kredisë së mbledhur me kredinë e dhënë, që përfaqëson treguesin e përdorimit të kredisë, ishte në nivelin 87.3%, nga 82.4% që llogaritej në fund të vitit 2009 dhe 79.4% referuar së njëjtës periudhë të një viti më parë. Grafiku 49 paraqet ecurinë e kredisë së re dhe treguesin e përdorimit të saj me bazë tremujore.

Grafik 49. Kredia e re dhe përdorimi i kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlera e kredisë së re për periudhën, është më e lartë se ajo e dy gjashtëmujorëve të vitit 2009, dhe pranë niveleve më të larta të viteve 2007 dhe 2008. Ndërkohë, treguesi i përdorimit mbetet pranë niveleve më të larta historike. Në përgjithësi, qarkullimi më i shpejtë i kredisë, reflekton shkurtimin e afatit mesatar të maturimit të kredisë dhe dhënien e saj kryesisht për të plotësuar kërkesat afatshkurtra të huamarrësve.

Sipas grupeve të përdoruesve, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, u konstatua se sektori i biznesit përfitoi rreth 84.6% të kredisë së re, nga 79.1% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Si rezultat, pesha e kredisë së re për individët ra në 15.4%, nga 20.9% që llogaritej në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Grafik 50. Shpërndarja e kredisë së re sipas qëllimit të përdorimit për sektorin e biznesit (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, referuar së njëjtës periudhë të një viti më parë, kredia e re për sektorin e biznesit u përdor në këtë mënyrë: rreth 49.5% e kredisë së re u përdor në formën "overdraft", nga 47.1%; rreth 19.3% u përdor për kapital qarkullues, nga 26.1%; rreth 16% është përdorur për investime në blerje pajisjesh, nga 18.6; dhe rreth 15.5% e kredisë së re është akorduar për investime për pasuri të paluajtshme, nga 8.1%. Gjatë kësaj periudhe, të tërheq vëmendjen zhvendosja e kredisë së re nga kategoria për "kapital qarkullues" drejt kategorisë "investime për pasuri të paluajtshme".

Në lidhje me sektorin e individëve shpërndarja e kredisë së re sipas qëllimit të përdorimit, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, evidenton tri zhvillime kryesore: rritjen e peshës së kredisë së

re akorduar në formën "overdraft" në 19.1% nga 15.5% që ishte një vit më parë; rënien e peshës së kredisë së re akorduar për "ushtrim aktiviteti" në 12.5%, nga 19.3% të një viti më parë; si dhe vijimin e mbajtjes së peshës kryesore të kredisë së akorduar "për pasuri të paluajtshme" me rreth 41.9%.

Grafik 51. Shpërndarja e kredisë së re sipas qëllimit të përdorimit për sektorin e individëve (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me përbërjen sipas monedhave, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 u rrit pesha e kredisë së re, të akorduar në euro dhe dollar amerikan, dhe ra pesha e kredisë së re në monedhën vendase, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Konkretisht, pesha e kredisë së re, akorduar në euro, u ngjit në rreth 52.2%, nga rreth 46.9%, pesha e kredisë se re në dollar amerikan u ngjit në rreth 12.8% nga 9.3%, dhe pesha e kredisë së re në lekë ra në 34.9% nga 43.7%.

Për sa i përket afatit të maturimit të kredisë së re, u konstatua që sektori bankar zgjeroi aktivitetin kreditues pothuaj për të gjitha afatet e përdorimit, por rriti më tej përqendrimin e kredisë në afatin e shkurtër. Gjatë kësaj periudhe, kredia e re afatshkurtër rezultoi 82 miliardë lekë, rreth 23.8 miliardë lekë ose 41% më shumë se një vit më parë dhe pesha e saj u ngjit në 63% nga 57.3% e një viti më parë. Kredia e re afatmesme rezultoi 26 miliardë lekë, rreth 3 miliardë ose 12.8% më shumë se një vit më parë, duke zënë 20% të totalit të kredisë së re. Pesha e kredisë së re dhënë në afat të gjatë, ka shënuar rënie në nivelin 17% nga 19.9% e një viti më parë.

Në lidhje me shpërndarjen e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, u konstatua që sektori bankar ka mbështetur kryesisht sektorin e "industrisë përpunuese", ku pesha e kredisë së re për këtë sektor u ngjit në 11.8%, nga 7.7%, referuar periudhës së një viti më parë. Mbështetja me financim e sektorit të "tregtisë, riparimit të automjeteve dhe artikujve shtëpiakë", i cili zë peshën më të madhe të kredisë së re me rreth 37.2%, ka mbetur e qëndrueshme. Pesha në kredinë e re për "sektorin e ndërtimit" ka rënë në 12.1%, nga rreth 15.3% e një viti më parë.

Grafik 52. Shpërndarja e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TEPRICA E KREDISË

Në lidhje me zhvillimet e tepricës së portofolit të kredisë, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, vlera e saj, pa përfshirë interesat e llogaritura[50], u ngjit në 465.4 miliardë lekë, duke u rritur me 4.3% kundrejt fundit të vitit 2009 dhe

[50] *Vlerësohen në rreth 4.3 miliardë lekë.*

me 11.1% ndaj një viti më parë. Së bashku me interesat e llogaritura, vlera e portofolit të kredisë u rrit me rreth 19.8 miliardë lekë ose 4.4%[51], duke u ngjitur në vlerën 469.6 miliardë lekë[52] dhe duke përfaqësuar rreth 40% të PBB-së. Sipas monedhave origjinale dhe krahasuar me fundin e vitit 2009, kredia në lekë u rrit me rreth 8.3 miliardë lekë ose 6.2%, kredia në dollarë amerikanë u rrit me rreth 30.5 milionë dollarë ose 10%, kredia në euro u rrit me 21.5 milionë euro ose 1.1%, kredia në valuta të tjera u rrit me 20 milionë lekë ose 1.7%.

Grafik 53. Shpërndarja e kredisë për sektorin publik dhe atë privat.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në qershor të vitit 2010, ashtu si në muajt paraardhës, është ruajtur pothuaj e pandryshuar pesha e tepricës së kredisë akorduar në valutë dhe në lekë, përkatësisht rreth 70% dhe 30%. Sipas afateve të maturimit, kredia afatshkurtër rezultoi rreth 157.7 miliardë lekë ose 33.6% e tepricës së kredisë, kredia afatmesme rezultoi rreth 94.9 miliardë lekë ose rreth 20% e tepricës së kredisë, dhe kredia afatgjatë rezultoi rreth 216.4 miliardë lekë ose 46.1% e tepricës së kredisë, pa patur luhatje të ndjeshme me fundin e vitit 2009, dhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në të majtë paraqitet grafikisht shpërndarja e tepricës së kredisë sipas sektorëve të përdorimit publik dhe atij privat (biznese dhe individë).

Në fund të periudhës, teprica e kredisë e përfituar nga sektori i biznesit[53] rezultoi rreth 308 miliardë lekë, gati 17 miliardë lekë ose 5.8% më shumë se fundi i vitit 2009. Teprica e kredisë e përfituar nga individët ishte rreth 139 miliardë lekë, duke shënuar një rënie me 646 milionë lekë ose 0.5% krahasuar me fundin e vitit 2009. Pjesa tjetër e tepricës së kredisë shkoi për sektorin publik.

Nga kredia për sektorin e biznesit, rreth 101.4 miliardë lekë ose 32.8% janë dhënë në formën "overdraft", mbi peshën mesatare[54] prej 29.3%[55] për këtë kategori.

[51] *Rritja reale e tepricës së kredisë duke marrë parasysh efektin e kursit të këmbimit, rezulton rreth 3.3% ose rreth 14.5 miliardë lekë më shumë se fundi i vitit 2009.*

[52] *Në vijim, konkluzionet dhe vlerat e raporteve marrin për bazë këtë shifër.*

[53] *Përfshin kreditimin për rezidentët (së bashku me huanë e dhënë institucioneve financiare jobanka), pa përfshirë interesat e përllogaritur.*

[54] *Për periudhën mars 2007-qershor 2010.*

[55] *Rreth 53 miliardë lekë (ose 17.2%) e tepricës së kredisë dhënë bizneseve i përket kredisë për kapital qarkullues, poshtë mesatares së periudhës prej 18.9%. Rreth 79.5 miliardë lekë (ose 25.8%) përfaqësojnë investime në blerje pajisjesh, poshtë mesatares së periudhës prej 29.1%. Rreth 74.3 miliardë lekë (ose 24.1%) përfaqësojnë investime për pasuri të paluajtshme, mbi mesataren e periudhës prej 22.7%.*

Grafik 54. Shpërndarja e tepricës së kredisë për biznesin.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 55. Shpërndarja e tepricës së kredisë për individët.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në shpërndarjen e tepricës së kredisë dhënë individëve, sipas qëllimit të përdorimit, evidentohet kredia e akorduar "për pasuri të paluajtshme" me peshën kryesore prej 69.5%, mbi mesataren e periudhës prej 66.4%[56].

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, kredia që ka shkuar për konsum, e identifikuar si kredi e dhënë për individët në formën "overdraft", për konsum të mallrave jo të qëndrueshme dhe të qëndrueshme, vlerësohet 31 miliardë lekë ose 6.9% e totalit të portofolit të kredisë, rreth 22% e portofolit të kredisë dhënë individëve dhe rreth 2.65% e PBB-së së vendit. Kredia e përdorur për qëllime investimi (blerje pajisjesh dhe ushtrim aktiviteti) vlerësohet 90.8 miliardë lekë ose 20.3% e totalit të portofolit të kredisë dhe 7.74% e PBB-së. Kredia e përdorur për investime në pasuri të paluajtshme (biznese dhe individë) vlerësohet 171 miliardë lekë ose rreth 14.6% e PBB-së.

Grafik 56. Shpërndarja e tepricës së kredisë totale.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket shpërndarjes gjeografike, veprimtaria krediduese e sektorit bankar është përqendruar kryesisht në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë dhe Fier.

[56] *Rreth 6.7 miliardë lekë (ose 4.8%) e tepricës së kredisë dhënë individëve është dhënë në formën "overdraft", lehtësisht mbi mesataren e periudhës. Rreth 15.9 miliardë lekë (ose 11.5%) përfaqëson kredinë për konsum të mallrave jo të qëndrueshëm, konsiderueshëm mbi mesataren e periudhës prej 6.3%. Rreth 8.4 miliardë lekë (ose 6%) përfaqëson kredinë për konsum të mallrave të qëndrueshëm, konsiderueshëm poshtë mesatares së periudhës prej 12.7%. Rreth 11.4 miliardë lekë (ose 8.2%) përfaqëson kredinë akorduar për "ushtrim aktiviteti", poshtë mesatares së periudhës prej 9.7%.*

Në qershor të vitit 2010, pesha e kredisë për këto rrethe ndaj totalit të kredisë, llogaritej 89%. Aktiviteti kreditues, i shtrirë për të gjithë strukturën e maturimit, është kryesisht i përqendruar në rrethin e Tiranës me peshën mesatare[57] më të lartë në tepricën e kredisë, rreth 68%, e ndjekur nga qyteti i Durrësit me rreth 7.7%. Ndër qarqet kryesore ku është përqendruar veprimtaria e kreditimit, pesha mesatare më e ulët evidentohet në qytetin e Shkodrës, me rreth 2.6%.

Grafik 57. Shpërndarja sipas rretheve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 58. Pesha mesatare e kredisë sipas afateve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 59. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve për rrethet kryesore.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me strukturën e kredisë sipas monedhës, kredia në valutë evidentohet me peshën kryesore në qarkun e Tiranës, prej 74.2%, ndërsa në qarqet e tjera mbizotëron kredia e akorduar në monedhën vendase.

Në lidhje me shpërndarjen e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, në secilin prej qarqeve kryesore sektori i tregtisë zë peshën kryesore të tepricës së kredisë. Gjithashtu, qarku i Elbasanit shfaq një përqendrim të konsiderueshëm të tepricës së kredisë ndaj sektorit të industrisë me rreth 21.6% dhe qarku i Shkodrës ndaj sektorit të ndërtimit me rreth 18.1%. Në secilin rreth të vendit, sektorët e bujqësisë dhe të transportit janë mbështetur më pak me financim.

[57] *Pesha mesatare e tepricës së kredisë sipas secilit rreth ndaj totalit është marrë për periudhën dhjetor 2007 deri në qershor 2010.*

CILËSIA E KREDISË

Cilësia e portofolit të kredisë ka vijuar prirjen rënëse edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, ku raporti "kredi me probleme ndaj totalit të kredisë (bruto)" u ngjit në nivelin 12.2%, kundrejt 10.48% që ishte në fund të vitit 2009 dhe 8.7% që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 60. Huatë me probleme ndaj totalit të huave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, kreditë me probleme të sektorit bankar u rritën me rreth 10.2 miliardë lekë ose 21.6% krahasuar me fundin e vitit 2009 dhe me rreth 20.5 miliardë lekë ose rreth 55.5% krahasuar me një vit më parë. Gjatë periudhës, teprica e kredisë u rrit me rreth 4.4%. Duke filluar prej fillimit të vitit 2009, norma e rritjes tremujore të kredive me probleme ka ardhur në rënie pothuaj të vazhdueshme. Në tremujorin e parë të vitit 2009, norma e rritjes së kredisë me probleme ishte 19.7%, ndërsa në tremujorin e dytë të vitit 2010 ky tregues ishte 7%.

Sipas kategorive të klasifikimit të kredisë, rreth 72.7% e portofolit të kredisë konsiderohet "standard". Në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe është konstatuar zhvendosje e kredisë në klasat me cilësi më të ulët, si "kredi nën-standard" ose "kredi të humbura", pesha e të cilave është ngjitur përkatësisht në nivelet 5.4% dhe 3.6%, nga 4.7% dhe 3% në fund të vitit 2009.

Grafik 61. Huatë me probleme ndaj totalit të huave sipas grupeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas grupeve të përdoruesve, cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie si për bizneset ashtu dhe për individët. Raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë për këta përdorues ishte përkatësisht 13.8% dhe 10.3% në qershor të vitit 2010, nga 12.3% dhe 8.2% në fund të vitit 2009, dhe 10% e 7.3% që ishte një vit më parë.

Sipas monedhës, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, raporti i "kredive me probleme në lekë ndaj tepricës së kredisë në lekë" dhe raporti i "kredive me probleme në valutë ndaj tepricës së kredisë në valutë" ishin përkatësisht 12.7% dhe 11.9%, kundrejt 10.1% dhe 10.6% në fund të vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, raporti "hua me probleme në valutë, ndaj tepricës së kredisë në valutë (ku kredimarrësi është i pambuluar nga kursi i këmbimit)", rezultoi rreth 11.5%, kundrejt 9.6% që ishte në fund të vitit 2009, dhe 8.8% referuar së njëjtës periudhë të një viti më parë. Sipas llojit të valutës, ky raport për euron ishte 11.9%, kundrejt 9.8% që ishte në fund të vitit 2009 dhe 8.8% që ishte një vit më parë. Për secilën periudhë, për dollarin

amerikan, ky raport ishte përkatësisht 8.1%, 8.5% dhe 8.9%. Përmirësimi i cilësisë së portofolit në dollarë amerikanë, kur të ardhurat e kredimarrësit nuk janë në këtë monedhë, shpjegohet me ritmin më të lartë rritës të totalit të këtij portofoli, kundrejt rritjes së kategorive të tij me probleme. Kështu, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 teprica e kësaj kredie u rrit me 5.3 miliardë lekë ose 24.7%, ndërsa teprica e kësaj kredie me probleme u rrit me 370 milionë lekë ose 20.7%.

Grafik 62. Cilësia e portofolit sipas sektorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Cilësia e portofolit të kredisë në muajin qershor të vitit 2010, shënoi rënie për disa sektorë të ekonomisë. Raporti më i lartë i huave me probleme ndaj tepricës së kredisë, evidentohet për sektorin "hotele dhe restorante" rreth 17.9%, nga 13.7% në fund të vitit 2009 dhe 11.2% në të njëjtën periudhë një vit më parë. Sektori i ndërtimit ka shënuar rritjen më të madhe me rreth 7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke u ngjitur në 15.9%, si rezultat i rritjes së tepricës së kredisë për këtë sektor me rreth 7.9%, ndërkohë që kreditë me probleme u rritën me rreth 96%. Në të majtë paraqitet grafikisht ecuria e cilësisë së portofolit të kredisë edhe për sektorë të tjerë të ekonomisë.

Grafik 63. Hua me probleme ndaj kapitalit rregullator.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e kredisë me probleme në terma neto, është shoqëruar me rritjen e peshës së tyre ndaj treguesve të kapitalit. Në nivel mesatar, treguesi "hua me probleme neto ndaj kapitalit" u rrit me 3 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2009, duke u ngjitur në nivelin 31.5%. Në mënyrë më të detajuar, raporti "kredi me probleme neto ndaj kapitalit bazë" u ngjit në nivelin 32.8%, nga rreth 30% që llogaritej në fund të vitit 2009 dhe 25.7% të llogaritur një vit më parë. Raportet "kredi me probleme neto ndaj kapitalit rregullator" dhe "kredi me probleme neto ndaj kapitalit aksioner" u llogaritën përkatësisht 31.2% dhe 30%, kundrejt 28.2% dhe 27% në fund të vitit 2009, dhe 24.6% dhe 24% në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sipas grupeve të bankave, bankat e përfshira në Grupin 1 dhe Grupin 3 shfaqin rritjen mesatare më të lartë të përkeqësimit të cilësisë së kredisë në terma neto ndaj kapitalit. Në qershor të vitit 2010, ky tregues për bankat e Grupit 1 u rrit mesatarisht me 7 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2009, duke u ngjitur në nivelin mesatar 11.9%. Ndërkohë i njëjti tregues për bankat e Grupit 3, u rrit mesatarisht me rreth 5.5 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2009, në nivelin mesatar

31.3%. Ndërkohë, Grupi 2 ka shënuar përmirësim[58] të cilësisë së kredisë në terma neto ndaj kapitalit, ku treguesi ra mesatarisht me 9.9 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2009, në nivelin mesatar 37.7%.

Grafik 64. Hua me probleme ndaj kapitalit rregullator sipas grupeve të bankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

FONDET REZERVË PËR HUMBJET NGA KREDITË (PROVIGJONET) DHE MBULIMI ME KOLATERAL

Rënia e cilësisë së portofolit të kredisë, është shoqëruar me rritjen e fondeve rezervë për humbjet nga kreditë (provigjonet) nga sektori bankar. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, fondet rezervë u ngjitën në rreth 30 miliardë lekë, pothuaj 5.9 miliardë lekë ose 24.6% më shumë se vlera e provigjoneve në fund të vitit 2009, dhe rreth 66% më shumë se vlera e provigjoneve të një viti më parë. Në qershor të vitit 2010, raporti "provigjone për kreditë me probleme ndaj huave me probleme" - raporti i mbulimit, është ngjitur në nivelin 52.5%, nga 51.3% që llogaritej në fund të vitit 2009, dhe 49% që ishte një vit më parë.

Grafik 65. Ecuria e raportit të mbulimit të kredive me probleme me provigjone.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 66. Kategoritë e kredisë të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në procesin e kredidhënies, një rol të rëndësishëm luan kolaterali, si instrument i rikuperimit të vlerës së kredisë me probleme në një masë të pjesshme ose të plotë. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, vlera e atyre kredive për të cilat ekziston kolaterali[59] rezultoi rreth 78% e portofolit

[58] *Në muajin qershor 2010, teprica e kredisë me probleme neto për bankat e Grupit 2 ka rënë me rreth 262 milionë lekë ose 3.1% krahasuar me fundin e vitit 2009, ndërkohë që madhësia e kapitalit aksioner është rritur me 1.3 miliardë lekë ose 7.7% për të njëjtën periudhë.*

[59] *Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), cash etj.*

të kredisë, nga 79% që llogaritej në fund të vitit 2009. Gjatë kësaj periudhe, vlera e kredive të mbuluara me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme ka shënuar rënie ndaj totalit të kredisë, duke zbritur në 55.4%, rreth 5.6 pikë përqindje më pak se fundi i vitit 2009. Pjesa e kredive me probleme që janë të mbuluara me këtë kolateral, ka zbritur në 57.8% të totalit të kredisë me probleme, krahasuar me 61% që rezultoi në fund të vitit 2009. Për kredinë në valutë, rezulton që 62.5% e tepricës së kredisë në euro dhe 37.2% e tepricës së kredisë në dollarë amerikanë, janë të mbuluara me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme.

4.1.7. DEPOZITAT DHE ECURIA E TYRE

Depozitat (pa përfshirë interesat[60] e llogaritura) arritën vlerën rreth 730 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 6.8% kundrejt fundit të vitit 2009 dhe me 16.3% kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë. Së bashku me interesat e llogaritura, vlera e depozitave u ngjit në nivelin 743.1 miliardë lekë.

Ecuria e depozitave të sektorit bankar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 ka shfaqur një rritje të qëndrueshme, duke ndjekur rrjedhën e pjesës së dytë të vitit 2009. Depozitat vazhdojnë të mbeten të përqendruara në bankat më të mëdha të sektorit bankar[61], por shkalla e përqendrimit të tyre ka rënë në mënyrë të ndjeshme.

Totali i depozitave në muajin qershor të vitit 2010, ka shënuar rritje prej rreth 7% krahasuar me fundin e vitit 2009, ndërkohë që rritja e gjashtëmujorit të kaluar qëndron rreth nivelit 8.4%.

Tabelë 16. Rritja vjetore e totalit të depozitave për sektorin bankar, gjatë viteve 2004-2009.

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	6m1-2010
Rritja e totalit të depozitave (në %)	13.4	16.4	20.1	19.9	2.4	7.6	7.04

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në analizën e strukturës së depozitave sipas afatit të maturimit, vërehet se në fund të muajit qershor të vitit 2010, rreth 77% e tyre ishin me maturim deri në gjashtë muaj (grafik 67). Gjatë kësaj periudhe, rritja e depozitave është përqendruar në afatet 1-3 muaj dhe 3-6 muaj.

Lidhur me strukturën e depozitave sipas monedhës, vërehet se në qershor të vitit 2010, depozitat në lekë përbënin 53.5% të totalit, në vlerën 398 miliardë lekë. Depozitat në valutë përbënin 46.5% të totalit të depozitave, në vlerën 345 miliardë lekë. Pesha e depozitave në lekë është rritur me 0.3 pikë përqindje kundrejt fundit të muajit dhjetor të vitit 2009 dhe ka rënë me 3.1 pikë përqindje kundrejt muajit qershor të vitit 2009.

[60] *Llogariten në vlerën 13.1 miliardë lekë.*

[61] *Përqendrimi i depozitave në sistemin bankar është matur me anë të indeksit të Herfindahl-it. Vlera për muajin qershor të vitit 2010 ishte 1525, nga 1667 që ishte në qershor 2009. Kjo tregon ende një përqendrim të lartë të depozitave në sistemin bankar, megjithëse në rënie.*

Ecuria e depozitave të reja në monedhën vendase ka treguar rritje gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010. Kështu, deri në muajin qershor të vitit 2010, u pranuan rreth 44% më shumë se depozitat e reja të pranuara në gjashtë muajt e parë të vitit 2009. Vlen të theksohet fakti që kjo rritje ka ardhur në një kohë, kur normat e interesit për depozitat në lekë kanë qenë lehtësisht në rënie. Kështu, norma mesatare e interesit për depozitat e reja në lekë, ka qenë 5.27% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, në krahasim me 5.4% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për sa i takon strukturës së maturimit të depozitave të reja të pranuara në lekë, në qershor të vitit 2010, vërehet rënie e lartë (10.26 pikë përqindjeje) në peshën e depozitave të reja me maturim 6-mujor në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin 2009, ndërsa në të gjitha maturimet e tjera vërehet rritje.

Grafik 67. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Depozitat e reja të pranuara nga sektori bankar në euro, në gjashtë muajt e parë të vitit 2010, ishin 3.1 miliardë euro, duke treguar rënie në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 prej rreth 24.4%. Në lidhje me strukturën e maturimit të depozitave të reja në monedhën evropiane, vërehet zhvendosje nga depozitat 1-mujore në ato me maturime më të gjata. Gjithsesi, depozitat me afat maturimi 1-mujor vazhdojnë të dominojnë depozitat e reja në euro. Norma mesatare e interesit për depozitat e reja në euro ishte 2.32% në gjashtë muajt e parë të vitit 2010, kundrejt 2.64% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Pakësimi i flukseve hyrëse në euro mund të shpjegohet me vështirësitë ekonomike të hasura nga vendet fqinje, duke u transmetuar në rënien e nivelit të remitancave.

Depozitat e reja të pranuara në dollarë nga sektori bankar, në gjashtë muajt e parë të vitit 2010 ishin 526.7 milionë dollarë, duke shfaqur rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, prej 10.9%. Vërehet se depozitat me afat më të gjatë maturimi zënë një peshë më të madhe në totalin e depozitave të reja, krahasuar me gjashtëmujorin e vitit të kaluar. Ndërkohë, depozitat me afat maturimi deri në 3 muaj vazhdojnë të përbëjnë mbi 70% të totalit të depozitave të reja në këtë monedhë. Pranimet e reja të depozitave dhe të llogarive rrjedhëse në lekë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 kanë pasqyruar përgjithësisht ecurinë e normave të interesit. Kështu, vlera më e madhe e depozitave të reja përkon me normën më të lartë të interesit për periudhën.

Grafik 68. Vëllimi total i pranimeve të reja në lekë kundrejt normave mesatare të interesit për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pranimet e depozitave të reja dhe të llogarive rrjedhëse në euro, shfaqën rënie në fillim të vitit 2010 për të treguar një ecuri më të qëndrueshme

në vazhdim. I njëjti zhvillim vërehet edhe në rastin e flukseve të reja hyrëse në dollarë amerikanë; dy muajt e parë të këtij viti tregojnë rënie, për të arritur vlera të larta gjatë muajve në vazhdim.

Grafik 69. Vëllimi total i pranimeve të reja në valutë kundrejt normave mesatare të interesit për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në euro dhe dollarë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGUESIT E KAPITALIT

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, treguesit e kapitalit shfaqën qëndrueshmëri në vlerat e tyre. Në fund të muajit qershor, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit[62] për sektorin bankar ishte 16.2%, në të njëjtin nivel me fundin e vitit 2009 dhe vetëm 0.6 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë (grafik 70.a.).

Për sa i takon grupeve të bankave, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 27% për bankat e Grupit 1, 14.1% për bankat e Grupit 2 dhe 16.3% për bankat e Grupit 3. Gjatë kësaj periudhe, bankat e Grupit 1 shfaqën rënie me rreth 6 pikë të kësaj norme, duke mbetur sidoqoftë në nivele më të larta se mesatarja e sektorit. Bankat e dy grupeve të tjera shfaqin rritje të lehtë të këtij treguesi kundrejt fundit të vitit 2009.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, sektori bankar kishte një kapital rregullator prej rreth 87.1 miliardë lekësh, në rritje me 7.1% nga fundi i vitit 2009 dhe me 14.4% krahasuar me një vit më parë. Kapitali rregullator mbulonte 3.2 herë vlerën e kredive me probleme neto nga 3.5 herë që ishte në fund të vitit 2009 dhe 4 herë krahasuar me një vit më parë.

[62] *Raporti i kapitalit rregullator me aktivet e ponderuara me koeficientët përkatës të rrezikut. Niveli minimal i këtij treguesi, sipas kuadrit rregullativ të mbikëqyrjes është 12%. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, të gjitha bankat individuale respektojnë normën rregullatore.*

Grafik 70. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i levës financiare, i matur si raport i totalit të aktiveve ndaj kapitalit aksioner, në fund të qershorit të vitit 2010 ishte 10.4, praktikisht i pandryshuar kundrejt fundit të vitit 2009. Në përgjithësi, ecuria e këtij treguesi ka ardhur në rënie duke reflektuar përpjekjet e bankave për të ruajtur ritme më të larta të rritjes së kapitalit aksioner, në krahasim me ato të zgjerimit të veprimtarisë.

Grafik 71. Treguesi i levës financiare (totali i aktiveve ndaj kapitalit aksioner).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.6. REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E PËRDORIMIT TË BURIMEVE.

Aktivet mesatare që sjellin të ardhura, në muajin qershor të vitit 2010, u ngjitën në nivelin 833.5 miliardë lekë duke përfaqësuar rreth 91.2% të vlerës së përgjithshme të aktiveve mesatare të sektorit bankar. Ky tregues ka qenë pothuaj në këto nivele në fund të vitit 2009, si edhe një vit më parë.

Raporti "Pasive mesatare që shkaktojnë shpenzime/Aktive mesatare që sjellin të ardhura" është ngjitur në nivelin 93%, duke qenë rreth 1.3 pikë përqindje më i lartë se në fund të vitit 2009 dhe 1.7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Të ardhurat e veprimtarisë[63] së sektorit bankar, rezultuan 21.4 miliardë lekë ose 21.7% më të larta se një vit më parë. Kostot operative[64] të veprimtarisë rezultuan 11.4 miliardë lekë ose 10.9% më të larta se një vit më parë. Si rezultat, raporti i kostove operative ndaj të ardhurave rezultoi në nivelin 53.4%, kundrejt 57.2% në fund të vitit 2009 dhe 58.6% të një viti më parë. Raporti i shpenzimeve të përgjithshme të veprimtarisë[65] ndaj të ardhurave rezultoi 80.9%, krahasuar me 94.5% në fund të vitit 2009 dhe 94% të një viti më parë. Ecuria e raporteve konfirmon përpjekjet e bankave për të kompensuar rritjen e shpenzimeve për provigjone (dhe rezerva të tjera) me pakësimin e kostove operative të veprimtarisë.

Rezultati neto ishte pozitiv, në masën 3.6 miliardë lekë, duke qenë rreth 5 herë më i lartë se fitimi i realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Bankat e Grupit 3 realizuan një vlerë të akumuluar të fitimit në masën 4.8 miliardë lekë. Vlera e akumuluar e humbjeve financiare në fund të gjashtëmujorit të parë ishte në masën 1.8 miliardë lekë.

Grafik 72. Kthimi nga kapitali (RoE).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma vjetore e kthimit mbi kapitalin (RoE)[66] për sektorin bankar ishte 8.3%, në rritje me 3.7 pikë përqindjeje nga fundi i vitit të kaluar dhe me 6.5 pikë përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

[63] Të ardhurat neto nga interesat plus të ardhurat e tjera neto.
[64] Pa përfshirë shpenzimet për provigjone.
[65] Kosto operative plus shpenzime për provigjone dhe rezerva të tjera.
[66] Treguesit e kthimit, si nga kapitali (RoE), ashtu dhe nga aktivet (RoA), janë me bazë vjetore.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, norma vjetore e kthimit nga aktivet mesatare (RoAA) ishte 0.79% për sektorin bankar. Kjo shifër është 0.4 pikë përqindje më e lartë se në fund të vitit të kaluar dhe 0.6 pikë përqindje më e lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe ky tregues, me përjashtim të muajve të parë të vitit, paraqet ecuri të qëndrueshme pozitive (grafik 73.a.).

Grafik 73. Kthimi nga aktivet (RoA).

a. Kthimi nga aktivet për sektorin bankar.



b. Kthimi nga aktivet për grupet e bankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.8. TREGUESIT E LIKUIDITETIT TË SEKTORIT BANKAR

Në fund të muajit qershor të vitit 2010, treguesit e likuiditetit, të matur sipas raporteve "aktive likuide/totalin e aktiveve" dhe "aktive likuide/detyrimet afatshkurtra" shënuan përkatësisht vlerat 27.85 dhe 32.85%, secili me një rritje të lehtë nga vlerat e fundit të vitit 2009. Gjatë këtyre gjashtë muajve, të dy treguesit evidentohen relativisht të qëndrueshëm, duke treguar gjithmonë një vlerë mbi 20%, që është vlera minimale e lejuar sipas rregullores së re "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", të miratuar nga Banka e Shqipërisë. Sipas kriterit të madhësisë së aktivitetit, bankat e grupit 1 shfaqin rënie në të dy treguesit që nga fundi i vitit të kaluar, përkatësisht me 2.4 dhe 3.9%, ndërkohë që dy grupet e tjera pasqyrojnë vlera në rritje.

Raporti "kredi/depozita" ka treguar rënie që prej fillimit të vitit 2009, duke zbritur në vlerën 63.8% në muajin qershor të vitit 2010, 1.4 pikë përqindjeje më i ulët se në dhjetor të vitit 2009 dhe 2.9 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Përgjatë gjithë kësaj periudhe, është dalluar ritmi më i lartë rritës i depozitave në krahasim me atë të kredive. E njëjta ecuri vlen për të njëjtin raport, në valutë. Në fund të muajit qershor të vitit 2010, ky tregues kishte vlerën 95.2%, 4.2 pikë përqindje më i ulët se në fund të vitit 2009, dhe 12.3 pikë përqindje më i ulët sesa një vit më parë.

Grafik 74. Pozicioni ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 75. Aktivet me jorezidentët ndaj pasiveve ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 76. Detyrimet ndaj jorezidentëve ndaj totalit të detyrimeve sipas grupeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pas një rënieje në gjysmën e dytë të vitit 2009, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, detyrimet ndaj jorezidentëve në raport me totalin e detyrimeve, kanë ruajtur të njëjtin nivel, rreth 6.6%. Gjithashtu, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, konstatohet rritje e aktiveve jorezidente në raport me totalin e aktiveve, në nivelin 11.2% nga 7.2%, që shënonte në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009.

Në tremujorin e fundit të vitit 2008 dhe në të parin e vitit 2009, detyrimet ndaj jorezidentëve u rritën si rezultat i ndihmës së dhënë nga bankat mëmë. Në mars të vitit 2009, raporti "Aktive ndaj jorezidentëve" ndaj "Detyrime ndaj jorezidentëve" ra ndjeshëm, duke arritur vlerat më të ulëta që nga dhjetori i vitit 2006, kur sektori bankar u bë "huamarrës neto" për tre tremujorë të njëpasnjëshëm. Në shtator të vitit 2009, sektori bankar iu rikthye "huadhënies neto", duke reflektuar përmirësimin e situatës financiare. Kjo prirje në rritje ka vijuar edhe për tremujorët në vazhdim.

Ndikimi kryesor në raportin "Detyrime ndaj jorezidentëve/totalin e detyrimeve" i atribuohet bankave të Grupit 2, të cilat paraqiten më të ekspozuara ndaj institucioneve jorezidente. Gjithsesi, situata në tremujorët e fundit shfaqet më e normalizuar dhe me prirje rënëse, duke reflektuar stabilizimin e situatës financiare.

Huamarrja nga banka-mëmë është aktualisht, pothuaj gjithmonë në valutë të huaj. Këto fonde konkurrojnë burimet e tjera të financimit të bankave në valutë, kryesisht depozitat në valutë nga klientët. Për këtë arsye, është me interes të njihet pesha e "Detyrimeve ndaj jorezidentëve" ndaj "Totalit të detyrimeve në valutë". Për muajin qershor të vitit 2010, ky tregues ishte në nivelin 13.3%, kundrejt 17.1% në fund të muajit qershor të vitit 2009. Kjo rënie pasqyron aftësitë e bankave për të siguruar financim rezident në valutë, konkretisht depozita në valutë të klientëve.

Treguesi i lartpërmendur "Detyrime ndaj jorezidentëve" ndaj "Totalit të detyrimeve në valutë" paraqitet në grafikun 78, sipas grupeve të bankave. Grupi 2 ka përqendrimin më të madh ndaj jorezidentëve, gjë që konfirmon dhe ekspozimin e

tyre ndaj financimeve të bankave mëmë. Ekspozimi ndaj jorezidentëve ka ardhur duke u reduktuar në tremujorët e fundit, si rrjedhojë e rritjes së depozitave në valutë.

Indeksi i Herfindahl-it është llogaritur në vijim, për të matur nivelin e përqendrimit të ekspozimit ndaj jorezidentëve.[67] Sistemi bankar, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, është vlerësuar me përqendrim të moderuar ndaj detyrimeve jorezidente, në nivelin 0.16 (ose 1,600). Rënia e përqendrimit ka ardhur si rezultat i rënies së detyrimeve jorezidente nga ana e bankave të Grupit 2, të cilat kanë mbështetjen më të madhe në financimet nga bankat mëmë.

Grafik 77. Totali i pasiveve ndaj jorezidentëve ndaj totalit të pasiveve në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregues tjetër matës i administrimit të rrezikut të likuiditetit është dhe GAP-i midis aktiveve dhe pasiveve sipas intervaleve të ndryshme të maturimit. Aktivet dhe pasivet afatshkurtra ndahen në tri shporta sipas maturimit të mbetur: shporta "deri në një javë", shporta "një javë deri në një muaj" dhe shporta me maturim "një deri në tre muaj". GAP negativ do të thotë se detyrimet afatshkurtra – të ndara sipas shportave të mësipërme – tejkalojnë aktivet afatshkurtra. Kjo analizë është e nevojshme për të kuptuar aftësinë e sistemit si dhe të bankave të veçanta, për të paguar detyrimet afatshkurtra nëpërmjet likuidimit të aktiveve afatshkurtra.

Grafik 78. Totali i pasiveve ndaj jorezidentëve ndaj totalit të pasiveve në valutë sipas grupeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 79. Indeksi i Herfindalit për detyrimet ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, gap-i kumulativ negativ i aktiveve dhe pasiveve me afat maturimi deri në tre muaj është zgjeruar në -18.4%,

[67] *Indeksi i Herfindalit interpretohet si: 0.01 (ose 100) = shumë e shpërndarë; 0.1 (ose 1,000) = jo e përqendruar; 0.1 – 0.18 (ose 1,000 deri në 1,800) = përqendrim i moderuar; mbi 0.18 (ose 1,800) = shumë e përqendruar.*

Grafik 80. Gapi i maturimit për "deri në 1 muaj" dhe "deri në 3 muaj".



Burimi: Banka e Shqipërisë.

nga -16.7% në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2009.[68] Pasivet deri në tre muaj, gjatë gjashtëmujorit të parë, janë rritur me rreth 75 miliardë lekë, ndërsa aktivet u rritën me vetëm 50 miliardë lekë, duke ndikuar në zgjerimin e gap-it negativ. Ndikimin më të madh në rritjen e pasiveve deri në tre muaj e dha shporta "një deri në tre muaj", e cila u rrit me rreth 88 miliardë lekë (70%). Shportat "deri në një javë" dhe "një javë deri në një muaj" ndryshuan përkatësisht me rreth 10 miliardë lekë (5.4%) dhe -23 miliardë lekë (-16.9%).

4.2. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS METODOLOGJISË STRESS-TESTING[69]

Analiza stress-test, përfshin dy përqasje: a) analizën e ndjeshmërisë së sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut dhe të kreditit, ku vlerësohet ndjeshmëria e treguesit të mjaftueshmërisë së sektorit bankar ndaj ndryshimeve të veçuara në kursin e këmbimit ose në normën e interesit ose ndaj rritjes së caktuar në vlerën e kredive me probleme; b) analiza e skenarëve, në të cilën vlerësohet mënyra e reagimit të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar, si rezultat i ndikimit të kombinuar të disa faktorëve (tregues makroekonomikë dhe financiarë) që bashkëveprojnë me njëri-tjetrin. Vlerësimi realizohet duke u mbështetur mbi bazën e të dhënave në fund të periudhës, qershor të vitit 2010.

4.2.1 ANALIZA E NDJESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR NDAJ RREZIQEVE

Rreziku i drejtpërdrejtë i kursit të këmbimit. Matja e ndjeshmërisë së sektorit bankar ndaj luhatjeve (nënçmim/mbiçmim) në kursin e këmbimit të lekut, realizohet nëpërmjet ndikimit që shkaktohet për shkak të madhësive të pozicioneve të hapura valutore në bilanc, në dy valutat kryesore: euro dhe dollarë. Madhësia e pozicioneve të hapura valutore në bilanc, merret e pandryshueshme[70] posaçërisht gjatë ushtrimit. Mbi nivelin e kursit të

[68] *Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, GAP-i kumulativ deri në tre muaj ishte në nivelin -25.7%.*

[69] *Theksojmë që "stress-test" nuk është një mënyrë parashikimi. Në mënyrë të qëllimshme skenarët përmbajnë zhvillime negative, për të provuar rezistencën e sektorit bankar ndaj tyre. Skenarët përmbajnë supozime që përfaqësojnë zhvillime ekstreme dhe me një probabilitet të ulët ndodhjeje. Megjithëse bankat nxiten që të vleresojnë kapacitetin e gjendjes së tyre financiare për të përballuar ndikimin e këtyre skenarëve, ato nuk duhet t'i konsiderojnë këto skenarë si ngjarje të pritshme nga ana e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen. Skenarët janë të ndryshueshëm gjatë kohës, në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe financiare.*

[70] *Në fakt, bankat mund të ndryshojnë pozicionin e hapur valutor, në varësi të pritjeve të tyre për lëvizjet e kursit të këmbimit. Në këtë mënyrë, ato mund të zbusin humbjet, madje të tentojnë të rrisin fitimet.*

këmbimit, aplikohen ndryshimet të caktuara, të cilat shkaktojnë një humbje financiare që gërryen vlerën e kapitalit. Nga ushtrimi rezulton që aplikimi i një sërë goditjeve, si nënçmim/mbiçmim i kursit të këmbimit me 5%, 10%, etj., rezulton në një rënie të papërfillshme të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar. Vlerat e kufizuara të pozicionit të hapur valutor, mbrojnë sektorin bankar nga rreziku i drejtpërdrejtë i kursit të këmbimit. Në mënyrë që norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar të zbresë nën 12% vetëm si rezultat i lëvizjeve në kursin e këmbimit, do të duheshin lëvizje të jashtëzakonshme, pothuaj të parealizueshme në praktikë.

Rreziku i normës së interesit. Në këtë rast ushtrimi vlerëson ndjeshmërinë e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit si rezultat i ndryshimit të normave të interesit (norma mesatare e interesit për aktivet dhe detyrimet) për të tri monedhat, lekun, dollarin dhe euron.

Nga një rritje e supozuar e normës mesatare të interesit për lekun me 5 pikë përqindjeje (nga 6.24% në 11.2%), treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar bie me 1.7 pikë përqindje, në nivelin 14.5%. Kontributin më të madh në këtë rënie e japin bankat e Grupit 3, ku treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për këtë grup bankash bie me 2.4 pikë përqindje.

Lidhur me rritjen e supozuar me 5 pikë përqindje të normës mesatare të interesit për monedhën amerikane (nga 1.9% në 6.9%), sektori bankar paraqitet i mbrojtur, pasi luhatja e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit nuk është e qenësishme edhe pas goditjes së supozuar.

Gjithashtu, rritja e normës mesatare të interesit për monedhën evropiane me 5 pikë përqindje (nga 3.1% në 8.1%) shkakton rënie të treguesit të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar me vetëm 0.4 pikë përqindje. Në nivel grupesh sipas madhësisë së aktivitetit, bankat e Grupit 1 paraqiten me ekspozimin më të madh ndaj goditjes së normës së interesit në monedhën evropiane, ku norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për këtë grup bie me 0.7 pikë përqindje, në nivelin 26.3%.

Që treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar të binte nën nivelin minimal të kërkuar, do të duhej rritja e normës mesatare të interesit për monedhën vendase me 15 pikë përqindje[71]. Në rastin e valutave, madhësia e rritjes duhej të ishte shumë më e madhe.

Rreziku i kreditit. Ky rrezik paraqet ndjeshmërinë e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar, bazuar në përkeqësimin e portofolit të kredisë si rezultat i rritjes së kredive me probleme. Për këtë, supozohet rritja e kredive me probleme me 95% dhe 110%. Goditja e parë përfaqëson nivelin kufi ku treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar bie nën normën minimale rregullatore, në nivelin 11.7%. Për goditjen e dytë, rënia e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit është më e ndjeshme duke arritur në 11%. Në nivel grupesh sipas madhësisë së aktivitetit, bankat

[71] *Në lidhje me normat e interesit për euro dhe dollarë, sektori bankar nuk paraqet nivel kritik (normë mjaftueshmërie nën 12 përqind) në asnjë goditje.*

e Grupit 2 paraqiten më të ndjeshme ndaj rrezikut të kreditit pas aplikimit të secilës goditje.

Rreziku i tërthortë i kredisë nëpërmjet kursit të këmbimit. Ky rrezik lidhet kryesisht me kredidhënien në valutë, për klientë që të ardhurat e tyre i kanë në monedhën vendase.

Një nënçmim i monedhës vendase ndaj monedhës euro me 5%, shkakton uljen e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit me 0.7 pikë përqindje, duke arritur në 15.5%. Sektori bankar thyen kërkesën minimale rregullatore dhe paraqitet i nënkapitalizuar, për një nënçmim të lekut ndaj euros me rreth 28%.

Një nënçmim i lekut ndaj monedhës amerikane me 5%, shkakton rënie të lehtë, me vetëm 0.1 pikë përqindje të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar. Që sektori bankar të paraqitej i nënkapitalizuar, do të duhej një nënçmim i jashtëzakonshëm i lekut ndaj monedhës amerikane.

ANALIZA E SKENARËVE

Në këtë rast, ushtrimi vlerëson ndikimin e skenarëve që kombinojnë disa tregues ekonomikë dhe financiarë, mbi gjendjen financiare dhe mjaftueshmërinë e kapitalit të sektorit bankar gjatë këtij viti dhe gjatë vitit të ardhshëm, duke e marrë si të pandryshueshme vlerën e kapitalit. Përcjellja e goditjes realizohet nëpërmjet përkeqësimit të cilësisë së portofolit të kredisë. Ushtrimi përmban dy raste.

Në rastin e parë, përkeqësimi i portofolit të kredisë matet nëpërmjet supozimeve në ecurinë e treguesve makroekonomikë dhe në ato të veprimtarisë së brendshme të sektorit bankar, mbështetur në lidhjet që vlerësohen në mënyrë empirike. Në këtë rast, evidentohen situatat kur gjendja e kapitalit të sektorit bankar, bie nën nivelet e përcaktuara në kërkesat rregullative. Në rastin e dytë, përkeqësimi i portofolit të kredisë, vlerësohet nëpërmjet një modeli i cili përcakton lidhjet midis treguesve makroekonomikë. Në këtë rast, vlerësohet ndryshimi në nivelin e raportit të kredive me probleme, si edhe kërkesat për kapital shtesë të sektorit bankar, në mënyrë që të plotësohet kërkesa minimale rregullative e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Rasti i parë përmban dy skenarë, ku i pari ndërtohet mbi parashikimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë mbështetur kryesisht në ecurinë e tyre historike, ndërsa i dyti supozon një situatë më të "stresuar" dhe me një probabilitet të ulët ndodhjeje.

Ecuria e nivelit të kredisë me probleme sipas skenarëve jepet në tabelën 17.

Tabelë 17. Vlerësimi i rritjes së portofolit të kredisë me probleme sipas secilit skenar.

	Skenari 1		Skenari 2	
	2010	2011	2010	2011
Rritja e tepricës së kredisë me probleme (në %) për periudhën e mbetur	17.02%	25.86%	59.18%	109.19%

Sipas skenarit të parë, rritja ekonomike është supozuar 2.68% dhe 3.2[72]% përkatësisht për vitet 2010 dhe 2011. Norma e interesave në treg është supozuar të rritet me 1 pikë përqindje dhe me 0.5 pikë përqindje përkatësisht për vitet 2010 dhe 2011. Monedha vendase supozohet se nënçmohet në mënyrë të moderuar kundrejt dy monedhave kryesore euro dhe dollar për vitet në vazhdim. Të ardhurat neto nga interesi dhe të ardhurat e tjera të bankave supozohen të vijojnë sipas ecurisë së tyre në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, ndërsa portofoli i kredisë supozohet të rritet 7% dhe 13.8% përkatësisht për vitet 2010 dhe 2011.

Llogaritjet e ndikimit të rritjes së portofolit të kredisë me probleme në madhësinë e kapitalit dhe të aktiveve me rrezik të sektorit bankar, sipas viteve, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 18. Bankat e nënkapitalizuara sipas Skenarit 1.

	Fundi i vitit 2010		Fundi i vitit 2011	
	Banka të veçanta	Sistemi Bankar	Banka të veçanta	Sistemi Bankar
Kapitali rregullator				
Nënkapitalizim modest /1	Po	I mirëkapitalizuar	Po	I mirëkapitalizuar
Nënkapitalizim i rëndë /2	Jo		Po	
Kapital bazë (kapitali bazë/totalin e aktiveve me rrezik)				
Nënkapitalizim modest /3	Jo	I mirëkapitalizuar	Po	I mirëkapitalizuar
Nënkapitalizim i rëndë /4	Jo		Po	

/1 = Nën raportin prej 12%;
/2 = Nën raportin prej 6%;
/3 = Nën raportin prej 6%;
/4 = Nën raportin prej 3%.

Në këtë rast, deri në fund të vitit 2010 banka të veçanta mund të kërkojnë rritje të kapitalit në fund të vitit 2010. Sektori në tërësi, paraqitet i mirëkapitalizuar.

Sipas skenarit të dytë supozohet një situatë më e përkeqësuar ekonomike. Sipas tij, supozohet rënia me 4 pikë përqindje e PBB-së për vitin 2010 nga parashikimi i modelit makroekonomik, dhe 2 pikë përqindje rënieje nga parashikimi më i fundit i FMN-së Shqipërinë, për vitin 2011. Nënçmimi i kursit të këmbimit supozohet më i madh se ai i parashikuar në skenarin e parë. Rritja e normave të interesit në treg supozohet 2 pikë përqindje sipas secilit vit dhe rezultati neto nga interesat për bankat, bashkë me rezultatin neto nga veprimtaritë e tjera, supozohen përkatësisht 80% dhe 90% e nivelit të tyre në vitin 2009, duke e konsideruar këtë të fundit si më të vështirin për gjenerimin e të ardhurave pozitive. Së fundi, skenari i vështirë supozon rritje zero të portofolit të kredisë përkatësisht për secilin nga vitet 2010 dhe 2011.

Llogaritjet e ndikimit të rritjes së portofolit të kredisë me probleme në madhësinë e kapitalit dhe të aktiveve me rrezik të sektorit bankar, sipas viteve, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

[72] *FMN-ja, në korrik të vitit 2010 ka parashikuar një rritje prej 3.2% për Shqipërinë gjatë vitit 2011. Bazuar në publikimin "IMF, Country Report No.10/205".*

Tabelë 19. Bankat e Nënkapitalizuara sipas Skenarit 2.

	Fundi i vitit 2010		Fundi i vitit 2011	
	Banka të veçanta	Sistemi Bankar	Banka të veçanta	Sistemi Bankar
Kapitali rregullator				
Nënkapitalizim modest /1	Po	I mirëkapitalizuar	Po	I kapitalizuar
Nënkapitalizim i rëndë /2	Po		Po	
Kapital bazë (kapitali bazë/totalin e aktiveve me rrezik)				
Nënkapitalizim modest /3	Po	I mirëkapitalizuar	Po	I mirëkapitalizuar
Nënkapitalizim i rëndë /4	Po		Po	

/1 = Nën raportin prej 12%;
/2 = Nën raportin prej 6%;
/3 = Nën raportin prej 6%;
/4 = Nën raportin prej 3%.

Në rastin e këtij skenari ekstrem, kërkesat për kapital të bankave të veçanta do të ishin të mëdha.

Në përgjithësi, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve të forta makroekonomike, të cilat ndikojnë në përkeqësimin e portofolit të kredisë së sektorit bankar, duke sjellë rritjen e shpenzimeve dhe duke gërryer madhësinë e kapitalit. Megjithatë, Banka e Shqipërisë nxit bankat tregtare që të vlerësojnë ndikimin mbi gjendjen e tyre financiare të këtyre skenarëve ose të skenarëve të tjerë të ngjashëm, në përshtatje me kushtet e tyre të biznesit, me qëllim njohjen paraprake të kërkesave të mundshme për kapital shtesë dhe për marrjen e vendimeve në kohën e duhur.

Në rastin e dytë integrohet ndikimi i disa faktorëve makroekonomikë mbi raportin e kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë, për 4 tremujorët e ardhshëm. Në tabelat e mëposhtme jepen supozimet për skenarë hipotetikë që kombinojnë zhvillime të pafavorshme të rritjes ekonomike, të kursit të këmbimit ndaj monedhës euro dhe normës së interesit euribor. Ushtrimi përmban katër skenarë. Llogaritja e masës së përkeqësimit të kredive për çdo skenar bën të mundur llogaritjen e nevojave për kapital shtesë në rast se norma e mjaftueshmërisë së kapitalit do të binte nën nivelin minimal të lejuar prej 12%.

Skenarët 1 dhe 2 (tabelat 20 dhe 21) konsiderohen si skenarë bazë, pasi janë më pranë situatës aktuale.[73] Skenarët 3 dhe 4 (tabelat 22 dhe 23) konsiderohen si situata ekstreme, me një probabilitet të ulët ndodhjeje.

Tabelë 20. Skenar 1 (Bazë).

Skenar 1 (Bazë)	T1_10	T2_10	T3_10	T4_10	T1_11	T2_11	
Kursi euro/lekë	Zhvlerësim i kursit të këmbimit në një periudhë prej 2 tremujorësh dhe pastaj vlerësim i tij mbi periudhën aktuale						Supozime
Norma e Euribor	E pandryshuar						Supozime
Rritja ekonomike	2	1.68	2.43	2.12	3.17	2.62	Supozime
Raporti i kredive me probleme	11.68%	12.20%	13.24%	13.35%	15.71%	14.72%	Llogaritja në bazë të supozimeve
Nevoja për kapital shtesë	-	-	-	-	-	-	Llogaritja në bazë të supozimeve

[73] *Skenarët në fjalë nuk përbëjnë parashikime të NPL-së, pasi ecuria e tyre varet nga një shumëllojshmëri faktorësh si mikro ashtu edhe makroekonomikë, por shërbejnë si referencë për të vlerësuar ndikimin e ndryshimit të situatës makroekonomike në cilësinë e kredisë.*

Tabelë 21. Skenar 2 (Bazë).

Skenar 2 (Bazë)	T1_10	T2_10	T3_10	T4_10	T1_11	T2_11	
Kursi euro/lekë	Zhvlerësim i kursit të këmbimit në një periudhë prej 2 tremujorësh dhe pastaj vlerësim i tij mbi periudhën aktuale (njësoj si skenar 1); rritje më e ulët e tepricës së kredisë, krahasuar me Skenarin 1						Supozime
Norma e Euribor	+ 100 pikë bazë çdo vit						Supozime
Rritja ekonomike	2	1.68	2.43	2.12	3.17	2.62	Supozime
Raporti i kredive me probleme	11.68%	12.20%	13.24%	13.75%	17.16%	16.97%	Llogaritja në bazë të supozimeve
Nevoja për kapital shtesë e sistemit	-	-	-	-	-	-	Llogaritja në bazë të supozimeve

Sipas këtyre skenarëve, sektori bankar i përballon zhvillimet e supozuara në treguesit makroekonomikë dhe financiarë, pa patur nevojë për kapital shtesë.

Nëse do të ndodhte skenari 3, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 raporti i kredive me probleme do të arrinte mesatarisht në rreth 25%. Në këtë rast, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar do të binte nën kufirin e lejuar prej 12%, dhe do të nevojitej kapital shtesë në masën rreth 3 miliardë lekë për t'a rikthyer atë mbi nivelin minimal të kërkuar.

Tabelë 22. Skenar 3.

Skenar 3	T1_10	T2_10	T3_10	T4_10	T1_11	T2_11	
Kursi euro/lekë	Zhvlerësim vjetor prej 10%; rritje më e ngadaltë e kredisë totale						Supozime
Norma e Euribor	+ 400 pikë bazë çdo vit						Supozime
Rritja ekonomike	2.00	1.68	0.08	1.35	3.18	3.31	Supozime
Raporti i kredive me probleme	11.68%	12.20%	13.24%	15.58%	20.86%	25.17%	Llogaritja në bazë të supozimeve
Nevoja për kapital shtesë e sistemit (milionë lekë)	-	-	-	-	-	2,936	Llogaritja në bazë të supozimeve

Nëse do të ndodhte skenari 4, në fund të tremujorit të dytë të vitit 2011 raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë do të ngjitej në rreth 28%. Në këtë rast, sektorit bankar do t'i nevojitej një shtesë kapitali prej rreth 9.6 miliardë lekësh që të ruante normën minimale të kërkuar të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12%.

Tabelë 23. Skenar 4.

Skenar 4	T1_10	T2_10	T3_10	T4_10	T1_11	T2_11	
Kursi euro/lekë	Zhvlerësim vjetor prej 20%, rritje më e ngadaltë e kredisë totale						Supozime
Norma e Euribor	+ 400 pikë bazë çdo vit						Supozime
Rritja ekonomike	2.00	1.68	0.08	1.93	4.11	4.31	Supozime
Raporti i kredive me probleme	11.68%	12.20%	13.24%	16.28%	22.82%	28.53%	Llogaritja në bazë të supozimeve
Nevoja për kapital shtesë e sistemit (milionë lekë)	-	-	-	-	-	9610	Llogaritja në bazë të supozimeve

Në tabelën më poshtë paraqiten dhe devijimet standarde të raportit të kredive me probleme për secilin skenar, si dhe vlerësimet intervalore për nivelet e besueshmërisë 90% dhe 80%.

Tabelë 24. Devijimet standarde të raportit të kredive me probleme për secilin skenar dhe vlerësimet intervalore.

	Skenar 1	Skenar 2	Skenar 3	Skenar 4
Mesatare	14.8%	16.97%	25.17%	28.53%
Vlerësim intervalor me 90 % besueshmëri	12.49%-17.27%	14.47%-19.83%	21.77%-28.93%	24.83%-32.57%
Vlerësim intervalor me 80 % besueshmëri	12.95%-16.66%	14.98%-19.15%	22.48%-28.04%	25.61%-31.63%

Grafik 81. Shpërndarjet probabilitare të treguesit të raportit të kredive me probleme ndaj totalit të kredisë sipas katër skenarëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grafikun 81 jepet shpërndarja e dendurive të vlerave të raportit të huave me probleme për tremujorin e dytë të vitit 2011, të simuluara me metodën Monte-Carlo, për katër skenarët e mësipërm. Siç tregohet nga grafiku, probabiliteti i përballjes me vlera ekstreme (larg mesatares së llogaritur) të raportit të kredive me probleme rritet nga skenari 1 në skenarin 4.

Si konkluzion i kësaj analize del që në total sistemi bankar është i mirëkapitalizuar dhe i aftë të përballojë goditje të ndjeshme të faktorëve ekonomikë të cilët përkeqësojnë cilësinë e kredisë. Megjithatë, për banka të veçanta mund të jenë të nevojshme shtesa të kapitalit në varësi të situatave të paraqitura.

4.3. INDEKSI I FORTËSISË FINANCIARE

Mbështetur në zhvillimet më të fundit të sektorit bankar është ndërtuar treguesi "Indeksi i Fortësisë Financiare"[74], për tërësinë e sektorit bankar vendas dhe për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.

Vlerësohet se në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, vlera e indeksit të fortësisë financiare ka arritur në 85.2, duke shënuar një rënie të lehtë prej 0.3% krahasuar me fundin e vitit 2009. Kjo rënie u shkaktua si rezultat i rënies së mëtejshme të cilësisë së aktiveve, rritjes së ekspozimit ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit dhe të ngadalësimit të nënindeksit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Performancë pozitive në rritje kanë shfaqur nënindeksi i likuiditetit, i përfitueshmërisë dhe i normës së interesit (me një ekspozim më të ulët të rrezikut).

[74] *Metodologjia e ndërtimit të indeksit jepet në aneksin 2 bashkëlidhur. Seritë kohore të vlerave të indeksit dhe të nënindekseve përbërëse të tij jepen në aneksin 3 bashkëlidhur.*

Në nivel grupesh, evidentohen bankat e Grupit 1 me rënien më të madhe të indeksit të fortësisë dhe bankat e Grupit 2 me rritjen më të madhe të vlerës së tij.

Në vijim, pasqyrohen grafikisht në mënyrë individuale, nënindekset e elementeve kryesore matëse të fortësisë financiare të sektorit bankar, për periudhën dhjetor 2005 – qershor 2010.

Grafik 82. Ecuria e IFF-së për sistemin dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje DSF.

Grafik 83. Ecuria e IFF-së për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje DSF.

Grafik 84. Nënindekset e Fortësisë Financiare për sektorin (dhjetor 2005=100).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërsa më poshtë, paraqiten në mënyrë individuale, për të njëjtën periudhë, nënindekset e elementeve kryesore matëse të fortësisë financiare sipas grupeve të bankave në varësi të madhësisë së aktivitetit.

Grafik 85. Nënindekset e fortësisë financiare për grupet (dhjetor 2005=100).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ANEKSE

ANEKS 1 . TREGUES TË SITUATËS FINANCIARE TË SEKTORIT BANKAR

Tabelë 25. Sektori bankar.

(%)	Qershor '09	Shtator '09	Dhjetor '09	Mars '10	Qershor '10
TREGUESIT ME BAZË KAPITALIN					
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.85	16.67	16.17	16.13	16.21
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.10	15.88	15.27	15.19	15.43
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	8.74	8.83	8.66	8.56	8.87
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	9.15	9.27	9.17	9.09	9.32
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	9.34	9.32	9.57	9.58	9.60
HUATË ME PROBLEME NETO NDAJ KAPITALIT					
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	25.72	27.25	29.93	33.57	32.81
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	24.58	25.94	28.24	31.63	31.24
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	24.07	25.80	27.07	29.99	30.32
HUATË ME PROBLEME BRUTO NDAJ HUAVE TOTALE	8.73	9.75	10.48	11.67	12.21
KTHIMI NGA KAPITALI (RoE) (bazë vjetore)	1.78	1.79	4.58	7.33	8.31
KTHIMI NGA AKTIVET (RoA) (bazë vjetore)	0.16	0.16	0.42	0.70	0.79
TREGUES TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE					
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	129.11	131.51	119.55	119.06	116.16
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	201.61	266.99	231.40	202.09	213.05
LIKUIDITETI					
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	40.90	41.34	27.65	27.88	27.85
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra	56.85	63.93	32.58	33.07	32.85
POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË NDAJ KAPITALIT					
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit bazë	4.60	0.63	4.12	5.76	7.64
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator	4.40	0.60	3.89	5.43	7.27
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner	5.06	0.70	4.31	5.97	8.09

Tabelë 26. Grupet sipas madhësisë së aktiveve.

	Qershor '09			Shtator '09			Dhjetor '09			Mars '10			Qershor '10		
Grupet, %	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3
TREGUESIT ME BAZË KAPITALIN															
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	32.06	14.36	16.79	32.98	13.98	16.64	32.73	13.64	16.08	30.52	13.33	16.20	27.03	14.05	16.26
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	30.36	12.44	16.62	33.13	11.63	16.48	32.73	10.91	15.92	30.52	10.46	16.04	27.03	11.64	16.12
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	19.39	8.81	8.11	20.62	8.51	8.21	19.14	8.03	8.17	18.18	7.41	8.26	16.88	8.79	8.31
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	20.48	10.17	8.20	20.62	10.23	8.29	19.14	10.04	8.26	18.18	9.44	8.34	16.88	10.09	8.39
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	20.15	9.27	8.75	21.51	8.92	8.71	19.96	8.44	9.25	18.71	8.00	9.47	17.62	9.09	9.23
HUATË ME PROBLEME NETO NDAJ KAPITALIT															
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	3.98	39.13	24.35	5.15	43.95	25.29	4.91	51.88	26.98	7.54	55.36	31.28	12.14	39.85	32.53
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	3.77	33.89	24.10	5.15	36.57	25.04	4.91	41.49	26.71	7.54	43.45	30.98	12.14	34.72	32.20
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	3.83	37.21	22.58	4.93	41.96	23.84	4.71	49.33	23.84	7.32	51.25	27.29	11.63	38.52	29.27
HUATË ME PROBLEME BRUTO NDAJ HUAVE TOTALE	3.84	10.54	8.23	4.77	11.52	9.24	4.90	13.13	9.61	6.19	13.79	11.07	8.61	11.87	12.77
KTHIMI NGA KAPITALI (RoE) (bazë vjetore)	(5.38)	(25.38)	10.45	(5.23)	(22.06)	9.72	(6.54)	(22.48)	14.07	(14.94)	(8.45)	14.79	(9.09)	(9.40)	19.05
KTHIMI NGA AKTIVET (RoA) (bazë vjetore)	(1.14)	(1.96)	0.89	(1.09)	(1.79)	0.83	(1.36)	(1.85)	1.22	(0.73)	(0.17)	0.34	(0.86)	(0.42)	0.86
TREGUES TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE															
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	84.79	227.23	117.56	85.00	210.67	121.46	89.87	209.59	107.61	155.65	130.07	115.15	98.63	147.61	108.41
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	164.20	244.81	197.82	159.07	228.47	281.67	167.53	255.81	231.62	331.15	209.41	195.72	181.78	771.45	59.26
LIKUIDITETI															
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	37.80	25.14	45.78	41.11	25.93	46.10	29.70	18.41	30.41	32.49	23.43	29.00	27.27	22.35	30.45
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra	59.51	39.28	61.21	74.01	44.68	68.54	38.60	23.18	34.92	41.79	30.18	33.37	34.68	28.48	34.52
POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË NDAJ KAPITALIT															
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit bazë	3.10	9.27	3.29	2.28	0.91	0.29	(1.32)	7.97	3.77	1.20	11.10	4.93	4.54	6.57	8.64
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator	2.94	8.03	3.26	2.28	0.75	0.29	(1.32)	6.38	3.73	1.20	8.71	4.88	4.54	5.72	8.55
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner	2.99	12.10	3.51	2.18	1.17	0.31	(1.26)	9.89	3.80	1.16	13.95	4.90	4.35	11.52	7.77

Tabelë 27. Grupet sipas origjinës së kapitalit.

	Qershor '09				Shtator '09				Dhjetor '09				Mars '10				Qershor '10			
Grupet, %	Italian	Francez	Grek	Shqiptar	Italian	Francez	Grek	Shqiptar	Italian	Francez	Grek	Shqiptar	Italian	Francez	Grek	Shqiptar	Italian	Francez	Grek	Shqiptar
TREGUESIT ME BAZË KAPITALIN																				
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	17.59	14.82	14.76	15.63	18.38	13.50	14.37	15.12	18.80	14.22	14.07	14.22	18.48	13.65	14.54	13.06	19.42	15.38	14.65	13.30
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.73	12.72	14.76	11.23	17.52	11.59	14.37	12.03	17.89	11.26	14.07	11.19	17.57	10.80	14.26	10.25	18.62	12.53	14.38	10.56
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	8.43	8.81	11.10	7.84	8.81	8.61	11.29	8.15	8.54	8.58	11.18	7.80	8.38	7.97	11.13	7.01	9.54	8.71	11.43	7.05
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	8.86	10.26	11.10	10.92	9.24	10.04	11.29	10.32	8.98	10.84	11.18	9.91	8.81	10.07	11.34	8.93	9.95	10.69	11.64	8.88
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	9.31	9.43	11.52	8.43	10.26	9.35	11.76	8.52	10.53	9.48	11.63	8.15	10.64	8.95	11.88	7.21	10.21	9.40	11.90	7.24
HUATË ME PROBLEME NETO NDAJ KAPITALIT																				
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	25.24	57.26	21.10	25.18	20.00	59.65	22.86	22.75	25.00	70.02	22.80	42.43	28.70	83.29	23.89	41.47	29.85	62.49	23.14	50.77
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	24.00	49.14	21.10	18.10	19.06	51.20	22.86	17.97	23.78	55.45	22.80	33.39	27.29	65.93	23.44	32.55	28.62	50.91	22.72	40.33
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	22.85	53.48	20.35	23.43	17.17	54.97	21.96	21.76	20.29	63.37	21.90	40.64	22.60	74.23	22.38	40.34	27.90	57.91	22.22	49.42
HUATË me probleme bruto ndaj huave totale	8.02	16.33	6.54	4.89	7.48	16.78	7.07	5.21	8.83	18.63	8.06	8.13	9.76	20.71	8.19	8.75	11.99	19.64	8.75	10.49
KTHIMI NGA KAPITALI (RoE) (bazë vjetore)	9.54	(38.52)	(5.87)	6.89	14.40	(37.95)	(2.87)	6.80	15.67	(30.83)	(5.72)	4.47	11.35	(25.41)	12.22	(19.81)	5.05	(20.06)	5.03	(10.81)
KTHIMI NGA AKTIVET (RoA) (bazë vjetore)	0.86	(3.40)	(0.58)	0.59	1.33	(3.39)	(0.30)	0.57	1.49	(2.79)	(0.61)	0.37	0.30	(0.58)	0.36	(0.38)	0.26	(0.91)	0.30	(0.40)
TREGUES TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE																				
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	89.04	8,374.91	173.17	103.16	78.37	203,104.30	147.85	106.38	73.27	381.76	171.74	110.79	82.47	337.93	87.61	267.41	101.45	225.88	112.00	180.59
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	98.81	9,156.19	796.43	85.14	79.37	215,872.58	1,045.35	85.73	74.84	537.29	1,125.13	91.02	76.12	716.85	483.17	225.94	103.62	540.79	636.36	144.10
LIKUIDITETI																				
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	47.26	30.26	19.14	26.41	46.53	29.23	17.96	30.32	33.98	26.74	18.65	21.73	32.44	30.83	19.94	23.76	32.66	30.68	20.29	24.15
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra	67.48	56.08	25.14	39.61	73.34	57.60	24.21	52.72	40.12	37.64	22.37	25.69	38.29	44.80	24.61	27.65	38.38	45.60	24.44	28.20
POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË NDAJ KAPITALIT																				
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit bazë	1.60	31.44	(0.14)	8.47	0.58	1.05	0.42	1.17	0.64	15.65	(1.68)	6.76	0.71	10.89	0.72	5.02	2.65	12.83	(0.83)	16.37
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator	1.52	26.98	(0.14)	6.08	0.55	0.90	0.42	0.92	0.61	12.39	(1.68)	5.32	0.68	8.62	0.70	3.94	2.54	10.45	(0.81)	13.00
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner	1.45	29.37	(0.28)	7.88	0.50	0.97	0.85	1.12	0.52	14.16	(3.30)	6.48	0.56	9.71	1.39	4.89	2.48	11.89	(1.60)	15.93

ANEKS 2. METODOLOGJIA E NDËRTIMIT TË INDEKSIT TË FORTËSISË FINANCIARE

Për ndërtimin e indeksit, është marrë si bazë një model i ngjashëm, i përdorur prej Bankës Qendrore të Turqisë, me disa ndryshime. Në tabelën e mëposhtme paraqiten treguesit financiarë, që ndihmojnë në përllogaritjen e indeksit. Këta tregues vlerësojnë fortësinë financiare të sektorit bankar, zhvillimet dhe madhësinë e rreziqeve kryesore, ndaj të cilave ekspozohet ky i fundit. Në tabelën 28 pasqyrohet edhe kahu i ndikimit të treguesve, si dhe peshat e tyre në formulën llogaritëse të secilit nënindeks. Shenja pozitive tregon efektin pozitiv në nënindeks të rritjes së treguesit përkatës, ndërsa shenja negative flet për impaktin negativ të kësaj rritjeje[75] në nënindeks.

Tabelë 28. Treguesit e Fortësisë Financiare.

	Treguesit e Fortësisë Financiare	Shenjat e Raporteve, lidhur me efektin që kanë mbi treguesit	Peshat
Cilësia e Aktiveve	Kreditë me probleme bruto/Kreditë totale	negative	0.33
	Kreditë me probleme neto/Kapitali aksioner	negative	0.33
	Aktive të qëndrueshme/Totali i Aktiveve*	negative	0.33
Likuiditeti	Aktive Likuide/Totali i Aktiveve	pozitive	0.40
	Aktive me maturim deri 3 muaj/Pasive me maturim deri 3 muaj	pozitive	0.60
Rreziku i kursit të këmbimit	Pozicionet në valutë në blerje dhe shitje/Kapitali rregullator	negative	0.50
	Pozicioni i hapur neto për të gjitha valutat/Kapitali rregullator	negative	0.50
Përfitueshmëria	Fitimi neto/Totali i Aktiveve	pozitive	0.50
	Fitimi neto/Kapitali aksioner	pozitive	0.50
Mjaftueshmëria e Kapitalit	Kapitali i Lirë/Totali i Aktiveve**	pozitive	0.50
	Norma e Mjaftueshmërisë së Kapitalit	pozitive	0.50
Rreziku i normës së interesit	(Aktive - Pasive deri në 1 muaj, monedhë vendase)/Kapitali aksioner***	negative	0.50
	(Aktive - Pasive deri në 1 muaj, monedha të huaja)/Kapitali aksioner	negative	0.50

* *Aktivet e qëndrueshme llogariten si shumë e mjeteve të qëndrueshme dhe e kredive me probleme neto.*

** *Kapitali i lirë llogaritet si diferencë midis kapitalit aksioner dhe aktiveve të qëndrueshme.*

*** *Diferenca midis aktiv-pasiveve deri në 1 muaj, si në monedhën vendase, ashtu dhe atë të huaj, tregon mospërputhjen e aktiv-pasiveve afatshkurta të ndjeshme ndaj normës së interesit, e cila mund të shkaktojë humbje në rast luhatjesh të pafavorshme të kësaj norme.*

Për ndërtimin e nënindekseve, standardizohen seritë kohore të treguesve (raporteve), që shfrytëzohen për krijimin e tyre[76]. Procesi i standardizimit realizohet nëpërmjet matjes së distancës së vlerës reale të treguesit (raportit) në një moment kohor nga mesatarja e vlerave gjatë periudhës, në terma të devijimit standard.[77]

Nëpërmjet kësaj llogaritjeje përftohet seria e re Z sipas formulës:

$$Z=X-\mu/\sigma \qquad (1)$$

[75] *Sipas kësaj metodologjie shenja negative nuk do të thotë vlerë negative. Shenja tregon vetëm drejtimin e efektit të secilit tregues (raport) mbi indeksin. Kështu, shenja pozitive do të thotë se indeksi rritet për shkak të një rritjeje të raportit, ndërsa shenja negative do të thotë se indeksi bie për shkak të kësaj rritjeje.*

[76] *Të nënindekseve.*

[77] *Në këtë mënyrë, bëhet diferenca midis vlerës së raportit në secilën periudhë me mesataren e vlerave për të gjithë periudhën e marrë në analizë (në rastin tonë dhjetor 2005 – qershor 2010) dhe kjo diferencë pjesëtohet me devijimin standard të periudhës së përzgjedhur.*

ku: X-et përfaqësojnë vlerën e raportit në secilin moment kohor të analizuar, μ-ja përfaqëson mesataren e vlerave të raportit gjatë periudhës së zgjedhur në analizë dhe σ-ma përfaqëson devijimin standard. Në ndërtimin e nën-indekseve të përshkruara më sipër, vlerat e standardizuara të raporteve sipas formulës (1), shumëzohen me peshat që u janë caktuar raporteve në tabelën e mësipërme dhe përfundimisht mblidhen. Njëkohësisht është kryer dhe një rregullim, me qëllim kthimin në pozitive të të gjitha vlerave të standardizuara të serisë Z. Sipas metodologjisë, përzgjidhet një periudhë bazë, së cilës i jepet vlera 100[78] dhe indekset llogariten duke përdorur përpjesëtime të drejtpërdrejta kur rritja e raporteve që përbëjnë nënindekset është e favorshme; në rast të kundërt përdoren përpjesëtime indirekte[79]. Në përfundim, indeksi i fortësisë financiare (IFF) llogaritet si mesatare aritmetike e nënindekseve të ndërtuara.

[78] *Në rastin tonë bëhet fjalë për periudhën dhjetor të vitit 2005.*

[79] *Rasti tipik i përdorimit të përpjesëtimeve indirekte është në lidhje me nënindeksin e cilësisë së aktiveve, ku rritja e raporteve që përbëjnë këtë nënindeks (si, për shembull, hua me probleme ndaj kredive totale ose hua me probleme neto ndaj kapitalit aksioner) në fakt shkakton rënie të nënindeksit të cilësisë së aktiveve, duke qenë se rritja e tyre është e pafavorshme për sistemin bankar. Realisht shenjat ose drejtimi i efekteve, dhënë në tabelën 28, shërbejnë për të vendosur nëse duhet të përdoren përpjesëtimet e drejtpërdrejta ose indirekte.*

ANEKS 3. REZULTATET PËRMBLEDHËSE TË IFF-SË PËR SISTEMIN BANKAR

Tabelë 29. Përmbledhëse e rezultateve të IFF-së për sistemin bankar.

	Indeksi i Cilësisë së Aktiveve	Indeksi i Rrezikut të Likuiditetit	Indeksi i Rrezikut të Normës së Interesit	Indeksi i Rrezikut të Kursit të Këmbimit	Indeksi i Përfitueshmërisë	Indeksi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	Indeksi i Fortësisë Financiare
Dhjetor 05	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Mars 06	97.25	100.85	100.31	104.68	106.73	100.00	101.64
Qershor 06	94.65	99.99	89.25	129.89	100.81	92.42	101.17
Shtator 06	97.25	97.00	97.21	108.23	100.21	92.42	98.72
Dhjetor 06	97.25	90.18	90.27	111.33	100.60	92.42	97.01
Mars 07	96.69	94.44	97.00	108.28	105.42	84.83	97.77
Qershor 07	96.69	88.46	95.02	125.69	107.07	84.83	99.63
Shtator 07	96.13	90.16	99.23	105.30	106.53	119.19	102.75
Dhjetor 07	95.58	85.47	95.92	121.92	104.83	84.83	98.09
Mars 08	93.06	88.87	100.29	102.60	97.27	84.83	94.49
Qershor 08	87.72	76.51	87.97	125.75	99.59	84.83	93.73
Shtator 08	88.18	82.47	91.73	111.43	98.00	84.83	92.77
Dhjetor 08	77.50	73.51	104.32	114.72	89.10	84.83	90.67
Mars 09	75.84	73.93	108.41	125.75	70.05	84.83	89.80
Qershor 09	74.58	67.54	121.05	100.21	70.64	84.83	86.48
Shtator 09	73.03	74.55	115.79	97.37	70.57	88.27	86.60
Dhjetor 09	71.61	73.52	104.94	98.83	76.45	87.26	85.43
Mars 10	69.28	85.07	102.03	93.47	83.48	82.16	85.91
Qershor 10	68.84	73.63	109.83	89.23	85.44	84.14	85.19

Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje DSF.